

Si merret një Patentë Europiane

Udhëzues për aplikantët

Si merret një Patentë Europiane

Udhëzues për aplikantët

Maj 2016 (Botimi i 16-të)
Përditësuar më 1 Mars 2016

Përmbajtja

Parathënie	7
A. Të përgjithshme	9
I. Hyrje	9
II. Natyra dhe qëllimi i Konventës Europiane të Patentave	10
III. Marrëdhëniet me konventa të tjera ndërkombëtare	10
IV. Zgjedhja e procedurës: kombëtare, Europiane apo ndërkombëtare	11
Faktorët ligjorë	12
Faktorët ekonomikë	12
V. Shtrirja/vlerësimi i patentave europiane edhe për/në shtetet joanëtare të KEP	14
B. Patentueshmëria	15
I. Shpikja	15
II. Risia	16
Parimet bazë	16
Të drejtat për prioritet	17
III. Hapi shpikës	17
C. Përgatitja dhe depozitimi i aplikimit për patentë europiane	19
I. Kërkesat formale	19
E drejta për të depozituar aplikime për patentë europiane	19
Shtetet që mund të depozitojnë aplikime për patentë europiane	19
Gjuhët e aplikimit për patentë europiane	19
Lehtësira gjuhësore për të ndihmuar aplikantët nga shtete të caktuara kontraktuese	20
Elementët përbërës të aplikimit për patentë europiane	21
Kërkesa për dhenien e patentës	21
Emërtimi i shpikësit	21
Pretendimi për prioritet	22
Depozitimi përmes referencës	23
Përfaqësimi	24
II. Prezantimi i shpikjes tuaj	25
Zbulimi i shpikjes	25
Uniteti i shpikjes	26
Hartimi i dokumenteve teknike të aplikimit	26
Përshkrimi	27
Aplikimet bioteknologjike	28
(a) Sekuenca nukleotidike dhe aminoacide	28
(b) Depozitimi i materialit biologjik për të plotësuar përshkrimin	28
Pretendimet	30
Pretendimet që përfshijnë tarifa	31
Skicat	31
Abstrakti (Përmbledhja e shpikjes)	32
Të dhëna të palejuara	32
Karakteristikë unike të aplikimeve për patentë europiane dhe patentave	33

III. Depozitimi i aplikimeve për patentë europiane.....	33
Ku depozitohet.....	33
Si depozitohet.....	34
Letra e konfirmimit.....	34
Data e pranimi.....	35
Njoftimi për pranimin.....	35
Aplikimet që depozitohen te autoritetet kombëtare dhe që përcillen te ZEP.....	35
Tarifat.....	36
Shumat e tarifave dhe mënyrat e pagesës.....	38
Rimbursim i tarifave	40
IV. Depozitimi i dokumenteve të tjera.....	41
Ku dhe si depozitohen.....	41
Nënshkrimi.....	41
Letra e konfirmimit.....	42
Data e pranimi.....	42
Njoftimi për pranimin.....	42
D.Procedura e dhënies së patentës europiane.....	43
I. Vështrim i përgjithshëm.....	43
II. Procedura deri në publikimin e aplikimit.....	44
Ekzaminimi i depozitimit.....	44
Ekzaminimi i formaliteteve.....	45
Raporti i kërkimit europian.....	46
Mungesa e unitetit të shpikjes.....	47
III. Publikimi i aplikimit për patentë europiane.....	47
IV. Procedura e ekzaminimit	49
Kërkesa për ekzaminim	49
Fazat e procedurës.....	50
Ndryshimi i aplikimeve para dhe gjatë procedurës së ekzaminimit	52
Kërkesat kombëtare për përkthimet e patentave europiane	53
V. Procedura e kundërshtimit	53
Periudha e kundërshtimit.....	53
Bazat për kundërshtim.....	54
Forma dhe përmbajtja e njoftimit të kundërshtimit.....	54
Ekzaminimi i pranueshmërisë së njoftimit të kundërshtimit	54
Ekzaminimi thelbësor i kundërshtimit	55
VI. Procedura e kufizimit dhe revokimit.....	56
VII. Procedura e ankimit.....	57
Depozitimi i ankimit.....	57
Rishikimi i ndërmjetëm	58
Fazat e procedimit para bordeve të ankimit	58
Kërkesa për rishikim	59

VIII. Aplikimet e pjesshme	59
IX. Tarifat e rinovimit.....	60
X. Dispozitat e përgjithshme për afatet.....	61
Shkelja e afateve	62
Plotësimi i një akti të munguar.....	62
Shtojca I.....	65
Përmbledhje e procedurës së aplikimit për Grantin për patentën Europiane	65
Shtojca II.....	67
Njoftim i Zyrës Europiane të Patentave i datës 30 Nëntor 2015 në lidhje me programin për ndjekjen e përshpejtuar të aplikimeve për patentë europiane - “PACE”	67
A. Informacione të përgjithshme.....	67
B. Kërkimi.....	68
C. Ekzaminimi.....	69
D. Hyrja në fuqi.....	69
Njoftim i Zyrës Europiane të Patentave i datës 30 Nëntor 2015 në lidhje me Mënyrat për të përshpejtuar procedurën e aplikimit për grantin Europian.	70
Mëyra për të përshpejtuar procedurën e marrjes së grantit Europian përveç programit PACE	
A. Heqja dorë nga ftesa sipas Rregullores 70(2) KEP.....	70
B. Heqja dorë nga komunikimi sipas Rregullores 161 dhe 162 KEP.....	70
C. Heqja dorë nga komunikimet e mëtejshme sipas Rregullores 71(3) KEP.....	71
D. Hyrje e përshpejtuar në fazën Europiane.....	71
Procesim i përshpejtuar i opozitave ku është vënë re thyerje e procedurave, dhe procesim i përshpejtuar përpara apelimit të bordit.....	71
Shtojca III.....	73
Shembuj të aplikimeve për patente Europiane.....	74
Kimia.....	74
Mekanika	88
Kompjutera	103
Shtojca IV	123
Autoritetet ku mund të depozitohen aplikime për patentë europiane	123
I. Zyra Europiane e Patentave.....	123
II. Autoritetet kombëtare	124
Shtojca V	125
Kërkesat e shteteve kontraktuese në lidhje me përkthimet e specifikimeve të patentës europiane.....	125
I. Neni 65 i KEP	125
II. Kërkesat e shteteve kontraktuese	125

Shtojca VI	127
Afatet kohore	127
Tabelat që tregojnë afatet kohore që duhet të ndiqen nga aplikantët.....	127
Shtojca VII	131
Tarifat.....	131
I. Tarifat e parashikuara nga KEP	131
II. Formulari për pagesën e tarifave dhe kostove	131
III. Informacion i mëtejshëm për tarifat	131
IV. Organizimi i llogarive depozitare.....	131
Shtojca VIII	133
Shërbimet informuese për patentën	133
Kontrolli dhe Informimi rreth dosjeve të publikuara	133
Regjistri dhe Buletini i Patentave Europiane	133
Dokumentet e patentës	133
Gazeta Zyrtare dhe Udhëzimet për ekzaminimin	134
Kushtet dhe afatet	134
Pyetje	134
Kontakti.....	134

PARATHËNIE

Udhëzuesi për Aplikantët synon të familjarizojë aplikuesit dhe përfaqësuesit e tyre me një përvijim të procedurës së kërkuar për të aplikuar për një patent europiane.

Ky botim i 16-të (Maj 2016) i kësaj Guide është bazuar në Konventën Europiane të Patentave, të rishikuar (KEP 2000), e cila hyri në fuqi më 13 dhjetor 2007. Referimet për nenet apo rregullat që përmban ky Udhëzues, kanë të bëjnë me KEP në fuqi që nga ajo datë ose të rishikuara duke filluar që nga ajo datë deri në Mars 2016. Ju lutemi te keni prasysh se disa dispozita të Konventës së mëparshme (KEP 1973) janë ende të zbatueshme për disa aplikime që ishin në proces miratimi kur KEP e rishikuar hyri në fuqi.

Ky botim përfshin përditësimin deri më 1 Mars 2016 dhe rrjedhimisht paraqet ndryshimet e procedurave të Zyrës Europiane të Patentave që kanë hyrë në fuqi deri në atë datë. Për këtë arsye, përdoruesit e Udhëzuesit duhet të konsultohen vazhdimisht me faqen e internetit të ZEP (www.epo.org).

Egziston një Guidë e dytë për aplikantët e cila paraqet rrugën rrugën Euro-PCT ("Euro-PCT, Udhëzues për aplikantët: KBP në KEP" (shiko pikën 8)).

A. Të përgjithshme

I. Hyrje

1. Ky Udhëzues përshkruan dispozitat përkatëse për depozitimin e aplikimeve për patentë Europiane, duke ofruar këshilla praktike për të lehtësuar rrugën drejt një patente Europiane. Gjithashtu, përshkruan shkurtimish procedurat pas marrjes së patentës të ndjekura nga KEP. Por, Udhëzuesi nuk ndalet në detaje specifike procedurale gjatë ose pas marrjes së patentës Europiane, dhe as duhet konsideruar si komentari zyrtar për Konventën Europiane të Patentave (KEP).

Për informacione më të hollësishme, ju këshillojmë të konsultoheni me “Udhëzimet e Ekzaminimit në Zyrën Europiane të Patentave”, e cila ju informon gjerësisht për çdo fazë të procedurës për dhënien e patentave dhe për praktikën e ZEP-it.

Tabelat në Shtojcat I dhe VI të Udhëzuesit ilustrojnë qartë procedurën e aplikimit për grant dhe afatet kohore që duhen respektuar nga aplikantët.

2. Në të djathtë të faqeve do të gjeni referencat mbi dispozitat e KEP-it, Rregulloret Zbatuese dhe Rregullat në lidhje me Tarifat, si dhe pjesë nga Udhëzuesi (botim i 2015) dhe të Gazetës Zyrtare (GZ) të ZEP-it. Ju këshillojmë të konsultoheni me sa më lart, para se të merrni vendime në praktikë.

Tekstet autentike të KEP-it dhe Udhëzimet janë dhënë në dy botime të ZEP: **Konventa Europiane e Patentave** dhe **Udhëzimet e Ekzaminimit në Zyrën Europiane të Patentave**. Gjithashtu, duhet të shihni vendimet dhe njoftimet e publikuara nga ZEP në Gazetën e saj Zyrtare dhe në faqen e internetit (www.epo.org). Sigurohuni që po përdorni botimin e fundit të këtyre publikimeve apo të ndonjë prej publikimeve të tjera të përmendura në këtë Udhëzues.

Vendimet më të rëndësishme të bordeve të ankimit të ZEP (shiko pikat 197-207) janë publikuar në GZ dhe në faqen e internetit. Ju rekomandojmë të konsultoheni me vendimet përkatëse kur lind nevoja e interpretimit të dispozitave të veçanta të KEP.

Vendimet e bordeve janë të regjistruara edhe në CD-Romin me ÇËSHTJE LIGJORE. Jurisprudenca e Bordeve të Ankimit të ZEP përmban një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të përzgjedhura për t’ju lehtësuar gjetjen e vendimeve që ju interesojnë.

Burimet më të rëndësishme për ligjin European për Patentat dhe praktikën e ZEP-it, së bashku me shumë të dhëna të tjera të dobishme, gjenden në **internet** në faqen e **ZEP-it** (www.epo.org).

3. Si në çdo procedurë tjetër për marrje patente, ju duhet të njihni mirë çështjet e patentimit, nëse synoni të çani me sukses rrugën drejt Europës.
Nëse ju mungon përvoja e duhur, ju këshillojmë të konsultoheni me një përfaqësues profesional të ZEP (shiko pikat 58-66).
4. Në broshurën e ZEP, “**Ligji kombëtar lidhur me KEP**” gjeni informacion të detajuar mbi rregullat dhe kërkesat për aplikimet për patentë Europiane dhe patentat në shtetet kontraktuese. ZEP ofron falas një shtesë të

vlefshme të këtij Udhëzuesi që mund ta shkarkoni nga faqja e **internetit e ZEP** (www.epo.org).

II. Natyra dhe qëllimi i Konventës Europiane të Patentave

5. Patenta është një titull juridik që i jep zotëruesit të saj të drejtën - në një vend të veçantë dhe për një periudhë të caktuar kohe - të mos lejojë që një shpikje të shfrytëzohet për qëllime tregtare nga palë të treta të paautorizuara. KEP ka përcaktuar një procedurë të vetme Europiane për dhënien e patentave në bazë të një aplikimi të vetëm dhe ka krijuar kuadër ligjor uniform që garanton më lehtë, më lirë dhe më fort mbrojtjen e shpikjeve në shtetet kontraktuese.

Shtetet kontraktuese janë: Shqipëria, Austria, Belgjika, Bullgaria, Qiproja, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lihtenshtejni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Monako, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, San Marino, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Për secilin shtet kontraktues që i jepet një patentë Europiane, çdo zotërues i saj gëzon të njëjtat të drejta që do të gëzonte nëse merr një patentë kombëtare në atë shtet. Nëse objekti i patentës është proces, mbrojtja shtrihet te produktet e përfutuara drejtpërdrejtë nga ky proces. Shkeljet e patentës Europiane i nënshtrohen legjislacionit të brendshëm (por shiko pikën 9).

Neni 64

Aplikimi i publikuar i një patente Europiane gëzon mbrojtje të përkohshme të barasvlershme me mbrojtjen që jep një shtet kontraktues për një aplikim kombëtar të publikuar dhe që duhet të garantojë të paktën të drejtën e kompensimit të arsyeshëm në rast të cënimit apo shkeljeve.

Neni 67

Vlefshmëria kohore standarde për një patentë Europiane është njëzet vjet nga data e depozitimit. Në shumicën e shteteve kontraktuese të KEP patentat mbeten në fuqi për afatin maksimal, me kusht që tarifat vjetore të rinovimit të paguhen sipas rregullit.

Neni 63

Neni 63, pika 2 përcakton rrethanat se si zgjatet afati kohor i një patente apo kur jepet një afat më i gjatë. Opsioni për zgjatjen e afatit nëpërmjet një patente suplementare mbrojtëse synon kryesisht patentat për produkte mjekësore ose produkte për mbrojtjen e bimëve, ku procedura administrative e miratimit merr shumë kohë duke zvogëluar harkun kohor të përdorimit të patentës.

6. Patentat Europiane janë në fuqi edhe në disa vende që nuk janë aderuar në KEP (shtetet jashtë konventës). Për momentin këto janë Bosnja-Hercegovina dhe Mali i Zi (shtete për zgjatjen) dhe Maroku dhe Republika e Moldavisë (shtete për vlersim) (shiko pikën 26).

III. Marrëdhëniet me konventa të tjera ndërkombëtare

7. KEP është marrëveshje e veçantë brenda kuptimit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Në veçanti kjo nënkupton që parimet e Konventës së Parisit për të drejtën për prioritet dhe parimin e trajtimit kombëtar janë të zbatueshme edhe në procedurën Europiane dhe aplikimet Europiane.

Neni 87-89

Meqë pothuaj të tëra shtetet kontraktuese të KEP janë anëtare të OBT, KEP e rishikuar përfshin dispozitat përkatëse të Marrëveshjes TRIPS (Marrëveshja për aspektet tregtare të të drejtave të pronësisë intelektuale).

8. KEP është dhe traktakt rajonal i patentave brenda kuptimit të

nenit 45(1) e PCT-së. Kjo do të thotë se patentat Europiane mund të jepen mbi bazën e një aplikimi ndërkombëtar të depozituar sipas PCT. Udhëzuesi Euro-PCT (Pjesa 2 e këtij Udhëzuesi, "Euro-PCT") merret me mënyrën e depozitimit. Ai merret falas në Zyrrat e informacionit të ZEP ose shkarkohet nga **faqja e internetit e ZEP** (www.epo.org).

*Nenet 150-153
Rr. 157-165
Udhëz. E-VII*

8a Marrëveshja mbi aplikimin e Nenit 65 të KEP – Marrëveshja e Londrës – është një marrëveshje opsionale e cila ka si qëllim për të ulur kostot të lidhura me përkthimin e patentave Europiane. Shtetet kontraktuese të KEP të cilat kanë miratuar ose pranuar këtë Marrëveshje, kanë rënë dakord të heqin, totalisht ose për pjesën më të madhe, kërkesën për përkthimin e patentave Europiane. Për më shumë informacion ju lutem konsultohuni me faqen e internetit (www.epo.org)

9. "Patentat Europiane Komunitare" do të bazohen në një patentë Europiane të lëshuar nga ZEP duke zbatuar rregullat dhe procedurat e specifikuar në KEP. Pas lëshimit të patentës Europiane - por jo më vonë se një muaj pas publikimit zyrtar për marrjen e patentës në Fletoren e Patentave Europiane – mbajtësi i patentës do të ketë mundësinë e re për të aplikuar në KEP nëse ai dëshiron të përfitojë një mbrojtje të Patentës Komunitare në 26 shtetet anëtare të BE. ZEP do të:

- ekzaminojë këto kërkesa dhe do të regjistrojë efektin unifikues,
- krijojë dhe administrojë "Regjistrin e ri të mbrojtjes së Patentave Komunitare dhe
- Mbledhë tarifat e rinovimit për patentat Europiane Komunitare

Këto detyra të reja do të ndiqen nga ZEP sipas rregullave të reja të cilat do të kryejnë implementimin e Rregullores (BE) nr 1257/2012 të Parlamentit Europian si dhe të Këshillit Europian (shiko <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2012:361:0001:0008:en:PDF>). Patenta e re Komunitare do të jetë e mundshme vetëm në momentin që Marrëveshja mbi Gjykatën e Patentave Komunitare hyn në fuqi (shiko <http://register.consilium.europa.eu/pdf/en/12/st16/st16351.en12.pdf>). Trembëdhjetë shtete anëtare, duke përfshirë dhe Francë, Gjermani dhe Mbretërinë e Bashkuar, duhet ta pranojnë këtë marrëveshje në mënyrë që ajo të hyjë në fuqi.

Një listë me Shtetet Anëtare të BE të cilat e kanë pranuar këtë Marrëveshje mund ta gjeni në adresën e internetit:
<http://www.consilium.europa.eu/en/documents-publications/agreements-conventions/agreement/?aid=2013001>

IV. Zgjedhja e procedurës: kombëtare, Europiane apo ndërkombëtare

10. Procedura Europiane nuk ka zëvendësuar procedurat kombëtare të dhënies së patentës. Pra, kur kërkon mbrojtje të patentës në një ose disa shtete

kontraktuese të KEP, mund të ndiqni ose procedurën kombëtare të secilit shtet ku kërkon mbrojtje, ose

procedurën uniforme Europiane që ju garanton mbrojtje në të gjitha shtetet kontraktuese që përcaktoni.

11. Nëse doni patentë Europiane, mund të zgjidhni ose procedurën e drejtpërdrejtë Europiane, ose atë të Euro-PCT (shiko pikën 8 dhe Pjesën 2 të Udhëzuesit). Procedura e drejtpërdrejtë Europiane për dhënie patente Europiane drejtohet nga vetë KEP; me procedurën Euro-PCT, faza e parë e procedurës së dhënies (faza ndërkombëtare) i nënshtrohet PCT-së, ndërsa faza rajonale para ZEP si Zyrë e përcaktuar ose e zgjedhur drejtohet kryesisht nga KEP.
12. Në vijim kemi përmbledhur faktorët kryesorë ligjorë dhe ekonomikë që mund të ndikojnë në zgjedhjen tuaj mes procedurës Europiane dhe asaj kombëtare.

Faktorët ligjorë

13. Patenta Europiane jepet pas një ekzaminimi që përcakton nëse aplikimi për patentë Europiane dhe shpikja përkatëse plotësojnë kërkesat e patentimit të KEP.

Këto kërkesa janë baza jo veç për dhënien e një patente Europiane, por edhe për vlerësimin e vlefshmërisë së saj nga gjykatat vendase. Gjithashtu, mbrojtja që përcakton KEP për patentat Europiane është uniforme për të gjitha shtetet kontraktuese.

Neni 69, 138

14. Procedura e ekzaminimit kryhet në hapin e parë nga departamentet e ZEP (sektori i pranimit dhe sektorët e ekzaminimit); nëse ata vendosin të rrëzojnë aplikimin tuaj, mund të depozitoni një ankimim te bordet e ankimit të ZEP. Gjatë 9 muajve pas dhënies së patentës Europiane, palë të treta gëzojnë të drejtën të depozitojnë një njoftim për kundërshtim; në përfundim të procedimit të kundërshtimit, patentat ose mbahet siç është dhënë, ose ndryshohen kushtet, ose revokohet. Vendimi i i procedimit të kundërshtimit është i ankimueshëm përpara bordit të Ankimit të ZEP.

Neni 16, 17, 18

Ju mund të depozitoni kërkesë për kufizim ose revokim të patentës tuaj pasi ajo është dhënë.

Neni 105a, 105b

15. Patentat Europiane kanë formulim uniform dhe shtrirje uniforme të mbrojtjes për të gjitha shtetet kontraktuese (por shiko pikat 91 dhe 102) dhe ofrojnë fuqi ligjore të lartë.

Ligji i Patentave në shtetet kontraktuese është gjerësisht i harmonizuar me KEP për sa i përket kërkesave të patentimit. Por, meqë procedurat e dhënies vazhdojnë të jenë të strukturuar në mënyra të ndryshme dhe kryhen paralelisht nga disa zyra, procedura kombëtare rezulton në të drejta kombëtare me shkallë të ndryshueshme mbrojtjeje.

Faktorët ekonomikë

16. Tarifat e përpunimit të procedurës për dhënie patente Europiane janë të shkallëzuara; pas çdo faze të përfunduar mund të vendosni nëse ia vlen të paguani tarifën e radhës për të siguruar mbrojtjen e patentës. Sidomos

*Neni 2 Rr.
Tarifave*

ndarja mes fazës kërkimore dhe ekzaminimit thelbësor (shiko pikat 130-131) ju mundëson që, në bazë të raportit të kërkimit europian (shiko pikën 144), të vendosni nëse ia vlen të kërkoni edhe ekzaminim thelbësor.

- 17.** Në rrethana të caktuara, mund të jeni të interesuar që aplikimi juaj të përpunohet më shpejt, qoftë në fazën kërkimore apo në atë

të ekzaminimit thelbësor, ose në të dyja. Në këto raste, ZEP do të bëjë të gjitha përpjekjet që të zvogëlojë afatin e përpunimit, sipas programit për përsheptim të përpunimit të aplikimeve për patentë Europiane. (për hollësi shiko Shtojcën II).

GZ 2015,
A93, A94

- 18** Aplikimi juaj mund të jetë **aplikim i parë** në ZEP.

Në këtë rast, si rregull do t'ju dërgohet raporti i kërkimit brenda **gjashtë** muajve nga data e depozitimit (shiko Shtojcën II, pika 2).

- 19.** Ashtu si aplikimi i parë në një zyrë kombëtare, edhe aplikimi i parë Europian jep të drejtën e prioritetit për një aplikim të dytë për patentë kombëtare, Europiane ose ndërkombëtare të bërë në vitin e prioritetit (shiko pikat 52-56).

- 20.** Duke marrë parasysh tarifat e aplikuara për procedurën e dhënies së patentës Europiane, shpenzimet për përfaqësim me një agjent të vetëm dhe kostot e kryerjes së procedimeve në një gjuhë të vetme, si rregull, patentat Europiane kushton afërsisht sa 3-4 patentat kombëtare.

- 21.** Informacione mbi tarifat dhe kushtet për të përfituar rimbursim të tarifave jepet në faqen 114 ff.

- 22.** Procedura Europiane zhvillohet në një nga tri gjuhët zyrtare të ZEP (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), kryesisht në gjuhën me të cilën depozitoni aplikimin, ose versionin e përkthyer. Përveç kësaj, nëse jeni nga një shtet kontraktues gjuha e të cilit nuk është një nga gjuhët zyrtare të ZEP, ju gëzoni disa lehtësira për sa i përket gjuhëve dhe tarifave kur përdorni një gjuhë zyrtare të shtetit tuaj kontraktues (shiko pikat 44-46).

Neni 14(2), (3)
Rr. 6(3)
Neni 14(1) Rr.
Tarifat
GZ 2014, A4,
A23

- 23.** Gjithsesi, në fazën përfundimtare të procedurës për dhënie patente Europiane, duhet të depozitoni disa materiale të përkthyer. Ju duhet të dorëzoni në ZEP përkthimet e pretendimeve në dy gjuhët e tjera zyrtare. Që patentat Europiane të hyjë në fuqi në disa shtete kontraktuese, këto kërkojnë që pretendimet ose specifikimi i patentës Europiane të përkthehen në një nga gjuhët e tyre zyrtare, kur kjo gjuhë është e ndryshme nga gjuha e procedimit, (shiko pikën 177). Informacion më të hollësishëm mund të gjeni në faqen e internetit të Zyrës Europiane të Patentave (www.epo.org).

Neni 97
Rr. 71
Neni. 65

- 24.** Procedura për dhënien e patentës Europiane zgjat rreth 3-5 vjet nga momenti kur depozitohet aplikimi. Ajo zbërthehet në dy faza kryesore. E para përfshin formalitetet e ekzaminimit, përgatitjen e raportit të kërkimit dhe hartimin e një opinionit nëse aplikimi dhe shpikja përkatëse përmbushin kërkesat e PCT. E dyta përfshin ekzaminimin thelbësor.

Rr. 55-56

- 25.** Faza e parë nuk kërkon angazhim aktiv, përveçse kur Sektori i Pranimit gjen mangësi formale. Në fazën e dytë – ekzaminimi thelbësor - aplikimi juaj i caktohet një sektori ekzaminues që zakonisht komunikon me ju ose përfaqësuesin tuaj përpara se të vendosë të japë patentën apo ta refuzojë

Rr. 71-72
Rr. 62a, 63

aplikimin (shiko pikat 131 dhe 155-176). Përgatitja e duhur e aplikimit për patentë dhe e të gjithë hapave procedurale në ZEP është faktori vendimtar që procedura e ekzaminimit të ecë shpejt dhe në mënyrë të kënaqshme (shiko pikën 3).

V. Shtirja e patentave Europiane edhe në vendet joanëtarë të KEP

- 26.** Gjatë 1993 dhe 2009 Organizata Europiane e Patentave ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shtrirjen e efekteve të patentës Europiane edhe në disa shtetetë cilat nuk janë (ose nuk kanë qenë në momentin e nënshkrimit) palë në KEP.

*GZ1994, 75
GZ 2004, 619
(BA)
GZ 2010,
10 (ME)
Guid. A-III, 12*

Që nga 2010, ka nënshkruar marrëveshje të tjera me shtete të cilat nuk janë anëtare në mënyrë që patentat të ketë efekt edhe në këto shtete. Këto marrëveshje nuk kufizohen vetëm me vëndet e Bashkimit Europian.

*GZ 2015,
A18, A19,
A20, A84, A85*

Si aplikant për patentë Europiane ju keni kështu një mënyrë

të thjeshtë dhe me kosto efektive të fitimit të mbrojtjes së patentës në vende të tilla. Nëse ju kërkon shtrirje/njohje në këto vende dhe paguani tarifën(at) përkatëse në kohë, ju mund të siguron njohjen e aplikimeve për patentat Europiane (aplikimet e drejtpërdrejta dhe ato të Euro-PCT) dhe patentave të shtrira/njohura edhe në këto vende, ku në parim ato do të kenë të njëjtin efekt si aplikimet dhe patentat kombëtare dhe në thelb gëzojnë të njëjtën mbrojtje si patentat që ZEP u jep shteteve kontraktuese të KEP.

Ju mund të kërkon shtrirje në Bosnjë-Hercegovinë, Malin i Zi dhe njohje në Marok dhe Republikën e Moldavisë.

Sistemi i shtrirjes së njohjes është pothuaj i njëjtë me sistemin e ZEP që funksionon në shtetet kontraktuese. Për shembull, periudha për pagesën e tarifës për shtrirjen e njohjes është e njëjtë me periudhën për pagesën e tarifës së përcaktimit.

Megjithatë, sistemi i shtrirjes dhe njohjes nuk është i bazuar në aplikimin e drejtpërdrejtë të KEP, por vetëm në legjislacionin e brendshëm të harmonizuar me KEP. Kështu, shtrirja e njohjes i nënshtrohet dispozitave ligjore përkatëse të shtetit në fjalë.

B. Patentueshmëria

27. Patentat Europiane jepen për shpikje që janë të reja, që përbëjnë hap shpikës dhe me mundësi të gjëra për aplikim industrial. Shpikja mund t'i përkasë çfarëdo fushe të teknologjisë.

Neni 52(1)

I. Shpikja

28. KEP nuk e përkufizon termin “shpikje”, por jep një listë joshteruese të çështjeve dhe aktiviteteve që nuk mund të konsiderohen shpikje, pra që përjashtohen shprehimisht nga mundësia për patentim.

Neni 52(2), (3)
Neni 53
Udhëz. G-II, 3

Katër janë fushat e përjashtuara nga shpikjet:

29. Fusha e parë është **ajo e programeve për kompjutera**, të cilët nuk konsiderohen si shpikje në vetvete. Megjithatë, një program kompjuteri mund të patentohet sipas nenit 52 nëse programi shkakton efekt teknik të mëtejshëm që shkon përtej ndërveprimit fizik “normal” në mes programit (softuer) dhe kompjuterit (harduer). Një shembull i efektit teknik të mëtejshëm është kur programi shërben për të kontrolluar një proces teknik ose drejton funksionimin e një pajisjeje teknike.

Neni 52(2)(c), (3)
Udhëz. G-II, 3.6

Ky efekt mund ta shkaktohet edhe nga funksionimi i brendshëm i vetë kompjuterit nën ndikimin e programit.

Meqë programi kompjuterik nuk përjashtohet nga patentimi, mund të kërkohet patentimi i programit ose më vete, ose si medium që ruan të dhëna, ose si metodë apo pjesë e një sistemi kompjuterik.

Edhe programet kompjuterike mund të patentohen. Më tepër informacion për patentimin e shpikjeve që realizohen nëpërmjet kompjuterit gjeni në faqen e internetit të ZEP: (www.epo.org).

30. Fusha e dytë janë metodat për trajtimin e trupit të njeriut apo të kafshëve përmes kirurgjisë ose terapisë, si dhe metodat diagnostikuese të praktikuara në trupin e njeriut apo kafshëve. Këto shpikje janë përjashtuar shprehimisht nga patentimi. Por lejohen produktet, substancat dhe përbërjet për përdorim në metoda si: barnat ose instrumentet kirurgjikale. Substancat dhe përbërjet trajtohen veçmas në KEP përse i përket kërkesës për risi: Edhe një substancë ose përbërje e njohur mund të patentohet për përdorime të mëtejshme mjekësore ose veterinare, me kusht që ky përdorim të përbëjë risi dhe të jetë krijues.

Neni 53(c)
Udhëz. G-II, 4.2
Neni 54(4)-(5)

Ky përjashtim nuk cenon patentimin e metodave të tjera të trajtimit të njerëzve dhe kafshëve të gjalla; trajtimi i indeve të trupit pasi janë hequr nga trupi i njeriut apo i kafshës, si edhe metodat diagnostikuese që aplikohen në këto inde, janë të patentueshme, me kusht që indet të mos vendosen tek i njëjti trup.

Udhëz. G-II, 4.2.1

31. Fusha e tretë janë **llojet e bimëve dhe të kafshëve** dhe proceset thelbësore biologjike për prodhimin e bimëve ose kafshëve, të cilat janë përjashtuar shprehimisht nga patentimi

Neni 53(b)
Rr. 26, 27
Udhëz. G-II, 5.4

Për llojet e bimëve garantohet një formë e veçantë mbrojtjeje në shumicën e vendeve kontraktuese si dhe nga legjislacioni i BE-së.

Procesi për prodhimin e bimëve ose kafshëve quhet tërësisht biologjik nëse përbëhet tërësisht nga fenomene natyrore të tilla si kryqëzimi ose përzgjedhja, edhe në rast se përfshihen hapa teknik për seleksionim e bimëve ose kafshëve ose trajtimet e mëtejshme përpara ose pas procesit të seleksionimit.

Përfshirja nuk zbatohet për proceset mikrobiologjike ose për produkte të proceseve të tilla. Në përgjithësi, shpikjet bioteknologjike janë gjithashtu të patentueshme kur bëhen me material biologjik që izolohet nga mjedisi i tij natyror ose prodhohet me anë të një procesi teknik, edhe nëse ka ndodhur më parë në natyrë.

Udhëz. G-II, 5.5

- 31a** Fusha e fundit janë shpikjet e përjashtuara nga patentimi për shkak se përdorimi i tyre tregtar është në kundërshtim me **“ordre public”** ose **moralin**. Në veçanti, patentat nuk jepen për procese klonimi të qenieve njerëzore, për procese për modifikimin e identitetit gjenetik embrional të qenieve njerëzore, për përdorimin e embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose tregtare, apo për procese për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve që u shkaktojnë atyre vuajtje pa ndonjë përfitim mjekësor thelbësor për njerëzit ose kafshët, si dhe për kafshët që rezultojnë nga procese të tilla.

*Neni. 53(a)
R. 28
Udhëz. G-II, 4.1*

II. Risia

*Neni. 54, 55
Udhëz. G-IV
to G-VI*

Parimet bazë

- 32.** Shpikja konsiderohet risi nëse nuk përmbahet në arritjet e mëparshme.

Neni. 54(1)

Përcaktimi i njohurisë së mëparshme në KEP pasqyron parimin e risisë absolute: me arritje të mëparshme kuptohet gjithçka që i është bërë e njohur publikut në botë me anë të shkrimit ose në formë gojore nëpërmjet përdorimit ose në çfarëdo mënyre tjetër para datës së depozitimit të aplikimit apo datës së prioritetit. Megjithatë, risia cenohet vetëm kur i zbulohet qartësisht një personi të kualifikuar si një burim i **vetëm** i arritjeve të mëparshme, p.sh. në një aplikim për patentë të publikuar para datës së prioritetit.

*Neni. 54(2), 89
Udhëz. G-IV*

- 33.** Zbulimi i parakohshëm i shpikjes nuk e çënon risinë e saj nëse ka ndodhur jo më herët se **gjashtë muaj** para datës së depozitimit të aplikimit për patentë Europiane **dhe** nëse përbën abuzim të qartë në dëm të aplikantit apo në lidhje me shfaqjen në një ekspozitë brenda kushteve të Konventës së Parisit për ekspozitat ndërkombëtare¹.

Përveç këtyre dy rasteve - i dyti ndodh rrallë në praktikë - çdo zbulim i shpikjes para datës së depozitimit mund të përdoret juridikisht kundër aplikantit si pjesë e arritjeve të mëparshme, edhe nëse vetë aplikanti ka qenë përgjegjës për zbulimin.

¹ Çdo vit në botimin të saj muajit prill të Gazetës Zyrtare të ZEP publikohet një listë e ekspozimeve brenda termave të kësaj Konvente që janë të regjistruara sipas Byrosë Ndërkombëtare të Ekspozimit

Të drejtat për prioritet

- 34.** Në arritjet e mëparshme përfshihet edhe përmbajtja e aplikimeve për patentë Europiane të depozituara para datës së depozitimit ose të prioritetit, por që nuk janë publikuar deri ose pas kësaj date.

Neni. 54(3), 89
Udhëz. B-VI, 4

Një aplikim PCT që depozitohet para datës së depozitimit apo asaj të prioritetit, por që nuk është publikuar deri ose pas asaj date dhe për të cilën ZEP vepron si Zyrë e përcaktuar, konsiderohet pjesë e arritjeve të mëparshme për qëllime të nenit 54 (3) nëse tarifa e depozitimit është paguar në ZEP dhe aplikimi për PCT është publikuar në një nga gjuhët zyrtare të ZEP (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht). Nëse Aplikimi i PCT është botuar në gjuhët arabe, kineze, japoneze, koreane, portugeze, ruse apo spanjolle, një përkthim në një nga gjuhët zyrtare të ZEP duhet të ishte depozituar te ZEP e cila e publikon (shiko pikën 8).

Neni. 153(5)
Rr. 165
Udhëz. G-IV, 5.2

Kështu që aplikimi i mëparshëm siç është depozituar mund ta cënojë risinë.

Pasojat që aplikimet e mëparshme për patentë kombëtare apo patenta kanë për patentueshmërinë e shpikjes në shtete kontraktuese të caktuara, vlerësohen nga gjykata kompetente kombëtare pasi është dhënë patenta Europiane (por shiko pikën 103).

Neni 139(2)
Udhëz. H-III, 4.5

- 35.** Si rregull, konflikti midis dy aplikimeve për patentë Europiane ka vetëm pasoja të kufizuara, pasi zbulimi i përmbajtjes së aplikimit të mëparshëm është relevant vetëm për vlerësimin e risisë së aplikimit të mëvonshëm, por jo me hapin shpikës të tij. Kështu që pretendimet e aplikimit të mëvonshëm mund të hartohen në mënyrë të tillë që aplikimi i mëparshëm të mos cenojë risinë.

Neni 56
Udhëz. G-IV, 5

III. Hapi shpikës

- 36.** Një shpikje konsiderohet se ka hap shpikës nëse për subjektin profesional të fushës përkatëse, nuk buron në mënyrë të dukshme nga arritjet e mëparshme (që nuk përfshin të drejtat për prioritet shiko pikat 34-35). Në vlerësimin e hapit shpikës kundrejt risisë, (shiko pikën 32), mund të aplikohen burimet e **shumta** të arritjeve të mëparshme.

Neni 56

Hapi shpikës është vënë si kriter me qëllim që të mos lejojë që të drejtat ekskluzive të bëhen pengesë për zhvillimin normal dhe rutinë.

- 37.** Zyra synon të bëjë vlerësim realist dhe të balancuar të kriterit të hapit shpikës. Hapi shpikës vlerësohet zakonisht në bazë të qasjes "problem-zgjidhje"; me fjalë të tjera nëse zgjidhja e problemit që propozohet në aplikimin për patentë është e qartë për persona profesionalë me aftësi të zakonshme në fushën e tyre përkatëse.

Udhëz. G-VIII

Kjo gjithmonë varet nga rrethanat specifike të rastit. Në varësi të situatës, merren parasysh faktorë të ndryshëm si efekti teknik i paparashikuar i një kombinimi të ri të elementëve të njohur, zgjedhja e parametrave specifike të procesit brenda një kufiri të njohur, vështirësia që ka personi i kualifikuar në kombinimin e dokumenteve të njohura, indicie dytësore të tilla si shpikja zgjidh një problem teknik shumë të rëndësishëm për të cilin janë bërë shumë përpjekje për ta zgjidhur, ose për të kapërcyer një paragjykim teknik.

Nëse keni nevojë për më shumë informacion të detajuar, referojuni Udhëzimeve dhe vendimeve të bordeve të ankimit (shiko pikën 2).

C. Përgatitja dhe depozitimi i aplikimit për patentë Europiane

I. Kërkesat formale

E drejta për të depozituar aplikime për patentë Europiane

- 38.** Aplikimi për patentë Europiane mund të depozitohet nga çdo person fizik ose juridik apo ndonjë ekuivalent me një person juridik, pavarësisht shtetësisë dhe vendit të banimit apo të biznesit (por shiko pikën 58).

Neni. 58, 59, 118
Udhëz. A-II, 2

Aplikimi për patentë Europiane mund të depozitohet gjithashtu nga aplikantë të përbashkët ose nga dy ose më shumë kandidatë nga shtete të ndryshme kontraktuese; kur ka aplikantë të ndryshëm nga shtete kontraktuese të ndryshme, ata konsiderohen si aplikantë të përbashkët për qëllimet e procedurës para ZEP (shiko edhe pikën 64).

Shtetet që mund të depozitojnë aplikime për patentë Europiane

- 39.** Kur depozitoni një aplikim për patentë Europiane, të gjitha shtetet kontraktuese në të cilat KEP ka hyrë në fuqi deri në datën e dorëzimit, konsiderohen të përcaktuara. (shiko pikën 5 për listën e shteteve kontraktuese).

Neni 79

Zvicra dhe Lihtenshtejini mund të përcaktohen vetëm së bashku.

Neni 79
GZ 1980, 407

- 40.** Veç kësaj, aplikimet për patentë Europiane dhe patenta mund të shtrihen në disa shtete që nuk janë palë në KEP, që për momentin janë Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi (shiko pikën 26).

Referencat në këtë Udhëzues për përcaktimin e shteteve kontraktuese vlejnë edhe për shtrirjen e efekteve në shtetet jo-kontraktuese, përveçse kur shprehimisht përcaktohet ndryshe.

- 41.** Edhe pse të gjitha shtetet kontraktuese janë konsideruar për t'u përcaktuar në depozitimin e aplikimit, ju duhet të konfirmoni më pas përcaktimet duke paguar tarifën përkatëse për përcaktimin e të gjitha shteteve kontraktuese, përveç rasteve kur keni përjashtuar shprehimisht ndonjë përcaktim individual.

Neni 79(2)
Rr. 39
Udhëz. A-III, 11, 12
Neni. 2, pika 3,
Rr. Tarifave

Sa për njohjen e patentës edhe në shtetet e tjera, çdo njohje duhet të kërkohej në formularin "Kërkesë për Dhënie", por ju duhet të konfirmoni kërkesën për shtrirje të njohjes duke paguar tarifën përkatëse për çdo shtet ku dëshironi të shtrini mbrojtjen e patentës.

GZ 2015, A18,
A19 GZ 2015,
A84

Gjuhët e aplikimit për patentë Europiane

- 42.** Gjuhët zyrtare të ZEP janë anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja.

Neni 14(1)

- 43.** Nëse depozitoni aplikimin për patentë Europiane në ndonjë gjuhë tjetër, ju duhet të dorëzoni një përkthim në një nga gjuhët zyrtare të ZEP brenda dy muajsh nga depozitimi i aplikimit. Nëse përkthimi nuk depozitohet në kohë, ju duhet të depozitoni përkthimin brenda dy muajve nga njoftimin i ftesës.

Neni 14(2)
Rr. 6(1), 58
Udhëz. A-III, 14

Nëse përkthimi nuk depozitohet brenda afatit të përcaktuar në ftesë, aplikimi konsiderohet i tërhequr.

Gjuha në të cilën ju depozitoni aplikimin (ose përkthimin e tij, nëse nuk depozitohet në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) bëhet gjuha e procedurës dhe çdo ndryshim në aplikim ose në patentën Europiane duhet të hartohet në atë gjuhë. Në procedurat e shkruara, çdo pjesëmarrës mund të përdorë cilëdo gjuhë zyrtare të ZEP.

*Neni 14(3)
Rr. 3
Udhëz. A-VII, 1.1
Udhëz. A-VII, 2, 3.1*

Në çdo kohë gjatë procedurës para ZEP, përkthimi mund ndryshohet për ta përputhur me tekstin e aplikimit të depozituar.

Neni 14(2)

Në lidhje me aplikimet e pjesshme shiko pikën 211.

Lehtësirat gjuhësore për të ndihmuar aplikantët nga shtete të caktuara kontraktuese

- 44.** Nëse ju (ose një nga bashkaplikantët tuaj) keni vendbanimin tuaj ose vendin kryesor të biznesit në një shtet kontraktues që nuk ka gjuhë zyrtare anglishten, frëngjishten apo gjermanishten, ose nëse ju (ose një nga bashkaplikantët tuaj) jeni shtetas i atij shteti por banoni jashtë shtetit ju mund të depozitoni një aplikim për patentë Europiane dhe kërkonti ekzaminimin në një nga gjuhët zyrtare të shtetit (gjuhët e pranueshme për shtetet e pa kontraktuara në KEP)

*Neni 14(4)
Udhëz. A-VII, 1.1
Udhëz. A-VII, 3.2*

- 44a.** Pra nëse keni të drejtën të aplikoni ose të kërkonti ekzaminimin në një gjuhë të pranueshme por jo zyrtare të EPO dhe zgjidhni ta bëni këtë, ju keni të drejtë të përfitoni 30% zbritje në tarifat për aplikim ose ekzaminimin, si një aplikant, një person fizik, një ndërmarrje e vogël ose e mesme, OJF, universitet ose një organizatë kërkimore. Në mënyrë që të përfitoni nga kjo zbritje, duhet që të dorëzoni një deklaratë përfitimi e cila ka si afat maksimal pagesën e plotë ose të reduktuar të tarifës së aplikimit ose ekzaminimit.

*Rr. 6(3) to (7)
Neni. 14(1) Rr
Tarifave
Udhëz. A-X, 9.2
OJ 2014, A4, A23*

Nëse keni bashkëaplikues, secili prej tyre duhet të jetë një person fizik ose një entitet sipas përcaktimit të mësipërm dhe duhet të deklarohet i tillë nëse dëshironi që të përfitoni nga zbritja 30% mbi pagesën e plotë të tarifës së aplikimit ose ekzaminimit.

- 45.** Në qoftë se pika 44 është e aplikueshme për ju, në çdo kohë gjatë procedurës pas depozitimit të aplikimit mund të depozitoni çdo dokument sipas afatit përkatës në njërën gjuhë zyrtare të shtetit tuaj, por brenda **një muaji** nga data e depozitimit e këtij dokumenti, ju duhet të dorëzoni edhe përkthimin e tij në gjuhën e procedurave.

*Neni 14(4)
Rr. 6(2)
Udhëz A-II, 3.2*

- 46.** Megjithatë, nëse ju përdorni gjuhën zyrtare të shtetit tuaj për depozitimin e një kundërshtimi, ankimi ose kërkesë për rishkim, ju mund të dorëzoni përkthimin në njërën nga gjuhët zyrtare të ZEP **brenda** afatit përkatës të kundërshtimit, ankimit apo kërkesës për rishikim, nëse ky afat përfundon pas periudhës njëmuajore të përmendur në pikën 45. Nëse nuk dorëzoni përkthimin në kohë, dokumenti konsiderohet i padepozituar.

Ulja tarifore e përmendur në pikën 44a nuk vlen për tarifat për kundërshtimin, ankimin, kërkesën për rishkim, kufizimin dhe revokimin.

Elementët përbërës të aplikimit për patentë Europiane

- 47.** Aplikimi për patentë Europiane përbëhet nga një **kërkesë** për dhënien e një patente Europiane, një **përshkrim** të shpikjes, një ose më shumë **pretendime**, **skica** të përmendura në përshkrim ose në pretendime, si dhe një **abstrakt**.

Neni 78(1)
Udhëz. A-II, 4.1

Kërkesa për dhënien e patenës

- 48.** Kërkesa **duhet** të depozitohet në **formën e përshkruar nga ZEP**

(Formulari 1001 i ZEP). Formulari mund të shkarkohet dhe nga faqja e internetit e ZEP ose gjenerohet duke përdorur softuerin e Depozitimit *Online* që, gjithashtu merret falas (www.epo.org).

Rr. 41
Udhëz. A-III, 4
GZ 2014, A41
GZ 2015,
A26, A27

Lexoni me shumë kujdes shënimet përpara se të plotësoni formularin e kërkesës. Me plotësimin e formularit, ju përmbushni të gjitha kërkesat e detyrueshme në lidhje me informacionin që duhet të përmbajë kërkesa për dhënie patente. Kërkesa duhet të **nënshkruhet siç duhet**. Ajo mund të nënshkruhet nga përfaqësuesi juaj nëse keni caktuar një të tillë.

GZ 2014, A98

Kur nënshkruhet në emër të një personi juridik, duhet të tregohet edhe pozicioni që nënshkruesit ka në subjektin juridik. Nëse keni bashkëaplikues dhe nuk keni një përfaqësues European, atëherë aplikimi duhet të firmoset nga të gjithë aplikuesit (shiko pikën 64).

Rr. 2(2)
Udhëz. A-III, 4.2.2
Udhëz. A-VIII, 3.2
Udhëz. A-VIII, 3.4
GZ 2015, A91

Nëse aplikimi juaj bëhet në letër, kërkesa depozitohet në një kopje; dosja e dokumenteve (Faqja 8 e formularit Kërkesë për Dhënie) duhet të depozitohet në tri kopje, ose në kater nëse depozitohet te një autoritet kombëtar. Nëse aplikimi bëhet online atëherë nuk ka nevojë për kopje shtesë.

Emërtimi i shpikësit

- 49.** Në aplikimin tuaj për patentë Europiane ju duhet të emërtoni shpikësin(it).

Neni. 81

Nëse ju nuk jeni vetë shpikësi ose jeni bashkëshpikës, duhet të depozitoni emërtimin e shpikësit në një dokument të veçantë që tregon burimin e të drejtës tuaj mbi patentën Europiane.

Rr. 19
Guid. A-III, 5

Ju mund t'i siguronit falas formularët për emërtimin e shpikësit nga ZEP dhe zyrat kombëtare të pronësisë industriale, ose t'i shkarkoni nga faqja e internetit e ZEP (www.epo.org).

- 50.** Personi i emëruar si shpikës duhet të përmendet në aplikimin e publikuar për patentë Europiane, në specifikimin e patentës Europiane, në Regjistrin e Patentave Europiane dhe në Buletinin e Patentave Europiane, përveç kur heq dorë nga kjo e drejtë në kohën e duhur para publikimit.

Neni. 127, 129(a)
Rr. 20(1), 143(1)(g)
Neni. 128(4)
Rr. 144(c)
Udhëz. A-III, 5.2

- 51.** Nëse nuk emërtoni shpikësin kur depozitoni aplikimin për patentë Europiane, do t'ju kërkohej të korrigjoni këtë mangësi brenda **16 muajve** pas datës së depozitimit ose datës më të hershme të prioritetit, dhe për çdo rast jo më vonë se 5 javë para datës së caktuar për publikimin e aplikimit (shiko pika 149). Nëse nuk dorëzoni emërtimin e shpikësit brenda afatit të caktuar, aplikimi juaj refuzohet (shiko pikën 140).

Neni. 90(3)-(5)
Rr. 60(1)
Neni. 121
Rr. 135
Udhëz. A-III, 5.5

Pretendimi i prioritetit

- 52.** Nëse ju apo pasardhësi juaj i ligjshëm keni depozituar sipas rregullave një aplikim për patentë, një model përdorimi ose një certifikatë përdorimi në apo për ndonjë shtet anëtar të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale apo ndonjë anëtar të OBT, ju mund të pretendoni prioritetin kur depozitoni aplikimin për patentë Europiane në lidhje me të njëjtën shpikje. Ju duhet të depozitoni aplikimin për patentë Europiane jo më vonë se **12 muaj** pasi depozitoni aplikimin e parë (shiko pikat 226-228).

Neni. 87
Udhëz. A-III, 6
Udhëz. F-VI, 1.3

Nëse aplikimi i mëparshëm është depozituar në ose për një shtet kontraktues të KEP, ju mund t'a përcaktoni gjithashtu këtë shtet në aplikimin Europian. Aplikimi i mëparshëm për të cilin pretendoni prioritet, mund të jetë gjithashtu aplikim Europian apo aplikim ndërkombëtar (PCT) (shiko pikën 19).

- 53.** Ju mund të pretendoni disa prioritete në lidhje me një aplikim për patentë Europiane, edhe në qoftë se ato vijnë nga vende të ndryshme. Ju mund të pretendoni gjithashtu disa prioritete për një pretendim. Nëse pretendoni disa prioritete, afatet kohore që ecin nga data e prioritetit llogariten që nga data më e hershme e prioritetit.

Neni 88(2), (3)
Udhëz. F-VI, 1.5
Udhëz. A-III, 6.3

- 54.** Për të pretenduar prioritetin e një aplikimi të mëparshëm ju duhet të tregoni datën, vendin dhe numrin e dosjes së aplikimit të mëparshëm.

Neni. 88(1)
Rr. 52, 53
Udhëz. A-III, 6.5, 6.7
Udhëz. F-VI, 3.1-3.3
OJ 2012, 492

Gjithashtu, duhet të depozitoni dokumentin e prioritetit, dmth. një kopje të aplikimit të mëparshëm të vërtetuar nga autoriteti në të cilin është depozituar, bashkë me vërtetimin nga ky autoritet për datën e depozitimit, brenda 16 muajve nga data kërkuar për prioritet. ZEP shton në dosjen e aplikimit për patentë Europiane një kopje falas të aplikimit të mëparshëm prioritetin e të cilit ju pretendoni, nëse aplikimi i mëparshëm është ose aplikim për patentë Europiane, një aplikim për patentë ndërkombëtare të depozituar në ZEP si Zyre pritëse, një aplikim për patentë japoneze apo koreane apo model përdorimi, një aplikim ndërkombëtar i depozituar në Zyrën Japoneze, Kineze ose Koreane të Patentave si Zyrë pritëse - ose aplikim i përkohshëm ose jo për patentë amerikane.

Nëse doni të depozitoni një aplikim për patentë Europiane duke pretenduar prioritet nga një aplikim i mëparshëm, është e rekomandueshme që të depozitoni gjithashtu edhe një kopje të çdo rezultati kërkimor në lidhje me aplikimin e mëparshëm. Në rastin se rezultatet e kërkimit nuk janë ende gati atëherë ju duhet ti dorëzoni ato menjëherë në momentin që ato janë të gatshme. Detyrimi për të dorëzuar rezultatet kërkimore për aplikimet e mëparshme egziston për sa kohë aplikimi për patentë Europiane është ende në shqyrtim përpara KEP. Nëse KEP, vë re, në momentin e marrjes si detyrë nga divizioni i ekzaminimit, se rezultatet kërkimore nuk janë dorëzuar ende, ju fton ju të dorëzoni rezultatet kërkimore brenda një afati të pashtyeshëm 2 mujor. Nëse ju nuk dorëzoni rezultatet kërkimore ose një deklaratë se nuk i dispononi ato, aplikimi për patentën Europiane do të tërhiqet.

Neni 124
Rr. 141, 70b
Udhëz. A-III, 6.12
GZ 2010, 410, 600
GZ 2011, 62, 64
GZ 2012, 540, 542
GZ 2013, 216, 217

Jeni të liruar nga detyrimi i dorëzimit të rezultateve kërkimore nëse KEP e ka përpiluar vet raportin kërkimor ose nëse aplikimi është bërë në Austri, Danimarkë, Japoni, Kore, Britani e Madhe ose SHBA. Shtete të tjera do ti shtohen kësaj liste në të ardhmen.

GZ 2015, A2, A3

Kur depozitoni aplikim për patentë Europiane, në deklaratë duhet të tregoni datën, vendin dhe numrin e dosjes së aplikimit të mëparshëm.

- 55.** Ju duhet të depozitoni dokumentin e prioritetit dhe deklaratën e plotë të prioritetit jo më vonë se **16 muaj** pas datës më të hershme të prioritetit.
- Nëse nuk tregoni numrin e dosjes, ose nuk depozitoni kopjen e aplikimit të mëparshëm brenda afatit kohor të shprehur më sipër, do t'ju kërkohet ta korrigjoni këtë mangësi.
- Në rast të kundër, do të humbisni të drejtën tuaj për prioritet (por shiko pikën 141).
- 56.** Mes efekteve të një pretendimi të vlefshëm për prioritet është se data e prioritetit përcakton arritjen e mëparshme që mund të sfidojë aplikimin tuaj për patentë Europiane.
- Si rregull, ZEP ekzaminon vetëm kushtet për pretendimin e prioritetit. Normalisht, sektori i ekzaminimit (shiko pikat 155 e në vazhdim) verifikon nëse ekziston një e drejtë për prioritet kur gjen arritje të mëparshme (shiko pikën 32) mes datës së prioritetit dhe datës së depozitimit të aplikimit për patentë Europiane, ose kur gjen një të drejtë të mëparshme sipas të nenit 54 (3) (shiko pikën 34). Objekti për të cilin pretendohet prioriteti duhet të burojë drejtpërdrejtë dhe qartë nga zbulimi i plotë i shpikjes në dokumentin e prioritetit.
- Në rastet kur aplikimi nuk është në Anglisht, Frengjisht dhe Gjermanisht, mund t'ju kërkohet të depozitoni përkthimin e aplikimit për patentë Europiane në një nga gjuhët zyrtare të ZEP. Në këtë rast, i cili mund të ndodh gjatë patentimit ose procedurave opozitare ju duhet të depozitoni përkthimin brenda afatit që përcakton ZEP. Në raste të caktuara mund të dorëzoni një deklaratë ku thuhet se aplikimi për patentë Europiane është përkthim i plotë i një aplikimi të mëparshëm. Nëse nuk arrini të dorëzoni përkthimin e dokumentit të prioritetit ose deklaratën në kohën e duhur, do të humbi të drejtën e prioritetit. Megjithatë, gjatë procedurave për patentim, ju mund të depozitoni një kërkesë për procedim të mëtejshëm nëse nuk e keni dorëzuar përkthimin në kohë.
- Depozitimi përmes referencës**
- 57.** Në vend që të depozitoni dokumentat e aplikimit, ju mund të depozitoni aplikimin për patentë Europiane duke cituar aplikimin e mëparshëm. Kur depozitoni një aplikim për patentë Europiane referuar një aplikimi të mëparshëm, duhet që në formularin Kërkesë për Dhënie (seksioni 26.1) të tregoni datën e depozitimit, numrin e aplikimit dhe shtetin ku është depozituar aplikimi i mëparshëm. Referenca duhet të thotë që zëvendëson përkthimin e shpikjes dhe/ose ndonjë skicë. Më pas duhet të depozitoni një kopje të certifikuar të aplikimit të depozituar më parë, brenda dy muajve nga depozitimi i aplikimit. Nëse aplikimi referencë nuk është në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht, duhet të depozitoni një përkthim brenda të njëjtit afat kohor. Nëse nuk dorëzoni kopjen e certifikuar në këtë afat ose në një afat tjetër të përcaktuar në ftesën e mëpasshme, aplikimi nuk trajtohet si aplikim për patentë Europiane. Nëse nuk dorëzoni përkthimin e aplikimit të mëparshëm brenda afatit kohor të përmendur më sipër ose afatit të përcaktuar në ftesë, atëherë aplikimi konsiderohet si e tërhequr.

Rr. 41(2)(g)
Rr. 52(1)
Udhëz. A-III,
6.5, 6.7
Udhëz. F-VI, 3.2
Rr. 52(2)
Rr. 53(1)
Rr. 59
Udhëz. A-III,
6.10, 6.11
Udhëz. F-VI,
3.5, 3.6

Neni 54(2), (3)
Neni 60(2), 89

Udhëz. F-VI,
2.1, 2.4

Rr. 53(3)
Neni. 121
Rr. 135
Udhëz. A-III, 6.8
Udhëz. F-VI, 3.4

Rr. 40(1)(c),
40(2), (3)
Neni. 90(1), (2)
Rr. 55
Neni 14(2)
Udhëz. A-II,
4.1.3.1
Udhëz. A-III, 14
GZ 2009, 486

Pretendimet mund të depozitohen edhe duke iu referuar atyre në aplikimin e mëparshëm. Megjithatë, ju mund të vendosni që të aplikni për pretendime të reja duke zëvendësuar pretendimet në aplikimin e mëparshëm.

Përfaqësimi

- 58.** Nëse banoni apo ushtroni biznesin në një shtet kontraktues, ju mund të veproni nën emrin tuaj në procedimet para ZEP (por shiko pikën 3).
- Neni 133(1)
Udhëz. A-VIII, 1
Udhëz. A-III, 2*
- Nëse nuk banoni apo nuk ushtroni biznesin në një shtet kontraktues, duhet të emëroni një përfaqësues për të vepruar përmes tij në të gjitha procedimet para ZEP, përveçse për depozitimin e aplikimit tuaj për patentë dhe pagimin e tarifave.
- Neni. 133(2)*
- 59.** Përfaqësimi para ZEP mund të kryhet vetëm nga përfaqësues profesionistë emrat e të cilëve janë në një listë që mbahet nga ZEP, ose praktikues ligjorë të emëruar për të vepruar para ZEP. Në faqen zyrtare të ZEP (www.epo.org) gjeni databazën e përfaqësuesve profesionistë.
- Neni 134(1), (8)
Udhëz. A-VIII, 1.4*
- 60.** Si rregull, përfaqësuesit profesionistë të cilët evidentojnë veten si të tillë nuk kanë nevojë të paraqesin autorizim individual.
- Edicioni Special Nr. 3, GZ 2007, L.1*
- Përfaqësuesit mund të autorizohen me autorizim personal ose, me autorizim të përgjithshëm. Formularët përkatës, ndryshimet e të cilëve janë të lejuara, janë të disponueshme falas nga ZEP dhe zyrat kombëtare të pronësisë industriale. Ato mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit e ZEP (www.epo.org).
- Rr. 152(1), (4)
Udhëz. A-VIII, 1.5, 1.6*
- Autorizimet e përgjithshme janë të regjistruara në ZEP. Ato janë një alternativë praktike për të gjithë të interesuarit.
- GZ 1985, 42
GZ 1986, 327*
- 61.** Nëse autorizimi nuk paraqitet brenda periudhës së përcaktuar nga ZEP, atëherë çfarëdo veprimi i ndërmarrë nga përfaqësuesit i ndryshëm nga depozitimi i aplikimit për patentë Europiane dhe pagimi tarifave, konsiderohet sikur të mos jetë ndërmarrë.
- Rr. 152(2), (6)
Udhëz. A-VIII, 1.7*
- 62.** Nëse janë emëruar disa përfaqësues, ata mund të veprojnë bashkërisht ose veçmas para ZEP, pavarësisht nëse bie ndesh me ndonjë dispozitë në njoftimin për emërimin e tyre ose në autorizim. Kur janë disa përfaqësues, këshilloheni që në Kërkesën për Dhënie të jepni detajet e njërit prej tyre duke i bashkëngjitur “et al” emrit të tij. ZEP do të adresojë korrespondencën e saj përfaqësuesit i cili ka emrin në aplikimin për patentën Europiane, ose diku tjetër vetëm nëse është informuar për këtë gjë.
- Rr. 152(10)
GZ 2013, 535*
- Ju mund të emëroni një shoqatë përfaqësuesisht në konform me Rregullatoren 152(11) EPC. Një shoqatë përfaqësuesish konsiston vetëm në përfaqësues profesionistë që punojnë në firmat e tyre private ose të punësuar në një kompani. Në rast të tillë secili përfaqësues si pjesë e kësaj shoqate duhet të ketë autorizim individual.
- Rr. 152(11)
GZ 2013, 535*
- Nëse ju vendosni të përfaqësoheni nga një shoqatë, atëherë komunikimi do të dërgohet në adresën e regjistruar të shoqatës të përcaktuar në kërkesën për patentë Europiane.

- 63.** Nëse banoni apo ushtroni biznesin në një shtet kontraktues, mund të përfaqësoheni nga punonjësit tuaj të cilët nuk është detyrueshme të jenë përfaqësues profesionalë.

*Neni 133(3)
Udhëz. A-VIII,
1.2*

Punonjësi i cili përfaqëson punëdhënësin e tij dhe që nuk është përfaqësues profesional duhet të ketë një autorizim individual ose të përgjithshëm në përputhje me rregullat e referuara në pikën 60.

- 64.** Nëse aplikimi është depozituar nga më shumë se një person, Kërkesa për Dhënie duhet të emërojë njërin prej tyre ose një përfaqësues profesional si përfaqësues të përbashkët. Përndryshe, aplikanti që ka emrin i pari në Kërkesën për Dhënie konsiderohet përfaqësuesi i përbashkët. Megjithatë, nëse një nga aplikantët është i

*Neni 133(4)
Rr. 41(3)
Rr. 151(1)
Udhëz. A-VIII,
1.3*

detyruar të emërojë një përfaqësues profesionist, ky i fundit konsiderohet të jetë përfaqësues i përbashkët, me kusht që aplikanti që ka emrin i pari në Kërkesë për Dhënie të mos ketë emëruar përfaqësues profesional.

- 65.** Emri i përfaqësuesit dhe adresa e biznesit dhënë në Kërkesën për Dhënie regjistrohen në Regjistrin European të Patentave, botuar në Buletinin e Patentave Europiane dhe shtypur në aplikimin e publikuar për patentë Europiane dhe patentë.

*Rr. 143(1)(h)
Neni. 129(a)
Rr. 68*

- 66.** Njoftimet e dërguara nga ZEP (komunikimet, njoftimet, vendimet dhe fletëthirrjet) i dërgohen:

*Neni 119
Rr. 125–130
Udhëz. E-I, 2.4*

- (a) përfaqësuesit të regjistruar në Regjistrin e Patentave Europiane; ose
- (b) juve si aplikant nëse ju nuk emëroni një përfaqësues, si dhe nëse një punonjës është duke vepruar në emrin tuaj.

Nëse ju po veproni pa një përfaqësues profesional, keni më shumë se një adresë dhe dëshironi që njoftimet mbi procesin përpara ZEP të dërgohen në një adresë, ndërkohë që përdoret një adresë tjetër për publikimet, Regjistrin e Patentave Europiane dhe certifikatën e patentës, ju mund të vendosni një adresë për korrespondencën në aplikimin tuaj për Dhënie (shiko pikën 48), seksioni 9, "Adresa për Korrespondencë". Adresa për Korrespondencë duhet të jetë adresa juaj personale dhe duhet të egzistojë në një nga shtetet kontraktuese KEP. Dokumentacioni nuk mund të dërgohet tek një person fizik (natyral ose ligjor), duke qënë se kjo kërkon një aplikim formal për përfaqësim sipas Nenit 133 dhe 134. Nëse ju jeni duke vepruar nëpërmjet një punonjësi (Neni 133(3)), adresa e korrespondencës duhet përsëri të jetë juaja personale. Për të lehtësuar procedurat postare ose shpërndarjen me postë të brendshme, adresa mund të përmbajë një nën-divizion të kompanise, vetëm në rastet që kjo e fundit nuk ka identitet ligjor të veçantë.

*GZ 2014, A99
Udhëz. A-III,
4.2.1*

II. Prezantimi i shpikjes tuaj

Zbulimi i shpikjes

- 67.** Aplikimi për patentë Europiane duhet të zbulojë shpikjen në mënyrë të qartë dhe të plotë në masë të mjaftueshme për t'u zbatuar nga një specialist i fushës.

*Neni. 83, 84,
69(1)*

Përshkrimi dhe skicat shoqëruese formojnë bazën për pretendimet të cilat përcaktojnë shkallën e mbrojtjes së dhënë nga patentat Europiane. Përshkrimi dhe skicat përdoren edhe për të interpretuar pretendimet.

*Udhëz. F-II, 4.1
Udhëz. F-IV, 6.1*

- 68.** Nga momenti kur aplikimi për patentë Europiane depozitohet, nuk mund të bëni asnjë ndryshim përmbajtjes së tij për sa i përket përshkrimit, pretendimeve ose skicave. Kështu, nuk mund të shtoni shembuj ose karakteristika në dokumentet e aplikimit pas datës së përcaktuar për korrigjimin e mangësive në zbulimin e shpikjes. As nuk ju lejohet të zgjeroni objektin e pretendimeve, p.sh. duke hequr disa karakteristika, përveçse kur aplikimi i depozituar e mbështet qartë këtë zgjerim. Ju duhet të siguroheni që pretendimet e depozituara evidentojnë qartë e saktë shpikjen që doni të mbron (shiko pikën 175).

Neni 123(2)
Udhëz. H-IV, 2.1,
2.2.7, 2.2.8
Udhëz. F-II, 4.3,
F-III, 2

Uniteti i shpikjes

- 69.** Aplikimet për patentë Europiane duhet të kenë objekt vetëm një shpikje, ose një grup shpikjesh të lidhura në mënyrë të tillë që të formojnë një koncept të vetëm të përgjithshëm shpikës. Në rastin e fundit, në të njëjtën kategori lejohet të bëhen disa pretendime të pavarura me kusht që të jenë në pajtim me Rregullin 43(2); por zakonisht bëhen disa pretendime të pavarura në kategori të ndryshme (shiko pikën 85).

Neni 82
Rr. 43(2), 44
Udhëz. F-V
GZ 2002, 112

Hartimi i dokumenteve teknike të aplikimit

- 70.** Kërkesat në lidhje me përmbajtjen e përshkrimit, pretendimeve, skicave dhe abstraktit janë përcaktuar në nenet 83, 84 dhe 85 dhe në Rregullat 42, 43, 47 dhe 48.

Neni 83-85
Rr. 42-50
Udhëz. A-VIII, 2
Udhëz A-IX

Kërkesat formale për këto dokumente janë përcaktuar në Rregullat 46, 47 dhe 49; ato për dokumentet e depozituar më pas janë në Rregullin 50.

- 71.** Në vijim janë dispozitat e përgjithshme që përcaktojnë formën e dokumenteve për aplikim dhe dokumenteve të depozituara më pas:

Neni 78(1)
Rr. 49
Rr. 50
GZ 2013, 603

- (a) Dokumentet që përbëjnë aplikimin për patentë Europiane (përshkrimi, pretendimet, skicat dhe abstrakti) duhet të depozitohen në një kopje të vetme. E njëjta gjë vlen dhe për dokumentet që zëvendësojnë këto dokumente origjinale.
- (b) Dokumentet duhet të jenë letër e bardhë A4 (format portret), e fortë dhe të përkulshme.
- (c) Secili dokument që përbën aplikimin (kërkesa, përshkrimi, pretendimet, skicat dhe abstrakti) fillojnë në faqe të re.
- (d) Të gjitha fletët duhet të numëtohen me numra të njëpasnjëshëm arabë, të cilët duhet të vihen në qendër në krye të fletës, por jo në sipërfaqen anësore të kufirit të kreut.
- (e) Sipërfaqet anësore duhet të jenë të bardha minimalisht me:
kreu: 2 cm
ana e majtë: 2.5 cm
ana e djathtë: 2 cm
fundi: 2 cm
- (f) Rreshtat e secilës flete të përshkrimit dhe të pretendimeve duhet të numëtohen me numra shumëfishë të pesës, që vihen në kufirin majtas fletës, por në të djathtë të këtij kufiri.

- (g) Hapësira mes rreshtave duhet të jetë 1.5.
- (h) Dokumentet duhet të betohen shtypet ose të shtypura, me një lartësi minimale prej karakterit 12:21 cm për shkronja kapitale (Normalisht madhësi font 9 ose 10).
- (i) Në tekst nuk duhet të ketë shtesa me shkrim dore.

Kërkesat në lidhje me skicat trajtohen nga Udhëzimet, Pjesa A, Kapitulli IX.

72. Shtojca III jep tre shembuj se si hartohet një aplikim për patentë Europiane.

Përshkrimi

73. Në përshkrim ju duhet të:

*Rr. 42, Guid.
F-II, 4*

- (a) Specifikon fushën teknike të cilës i përket shpikja. Për shembull, këtë mund ta bëni duke rrëfyer pjesën e parë (arritjen e mëparshme) të pretendimeve të pavarura tërësisht ose në përmbajtje, ose thjesht duke iu referuar.

Rr. 42(1)(a)

- (b) Tregoni sfondin/historikun e arritjes që është e njohur, aq sa mendoni që duhet për të kuptuar shpikjen, mundësisht duke cituar burimin e dokumenteve që pasqyrojnë këtë arritje. Kjo vlen sidomos për sfondin e arritjes që korrespondon me pjesën e arritjeve të mëparshme të pretendimeve të pavarura. Citimet për burimet e dokumenteve duhet të jenë të plota që të mundësojnë verifikimin: specifikimet e patentës sipas shtetit dhe numrit; autorët e librave, titullin, botuesin, numrin e botimit, vendin dhe vitin e botimit dhe numrat e faqeve; për revistat duhet titulli, viti, numri i botimit dhe numri i faqeve.

*Rr. 42(1)(b)
Udhëz. F-II,
4.3-4.4*

- (c) Zbuloni shpikjen siç pretendohet.

*Rr. 42(1)(c)
Udhëz. F-II,
4.5-4.6*

Zbulimi duhet të tregojë problemin teknik që shpikja ka si qëllim të zgjidhë (edhe nëse nuk e përcakton shprehimisht) dhe të përshkruajë zgjidhjen.

Për të sqaruar natyrën e zgjidhjes në bazë të pretendimeve të pavarura ju mund të përsëritni apo t'i referoheni pjesës karakterizuese të pretendimeve të pavarura (shiko shembullin), ose të riprodhoni thelbin e karakteristikave të zgjidhjes në bazë të pretendimeve përkatëse.

Në këtë moment, në përshkrim duhet të jepni vetëm detajet e varianteve të shpikjes sipas pretendimeve të varura, nëse këtë gjë nuk e bëni kur përshkruani mënyrat e realizimit të shpikjes së pretenduar apo kur përshkruani çfarë tregojnë skicat.

Ju duhet të pohoni efektet avantazhuese të shpikjes tuaj në krahasim me arritjen e mëparshme, por pa bërë pohime zhvlerësuese kundër produkteve ose proceseve specifike të mëparshme.

Rr. 48(1)(b)

- (d) Përshkruani shkurtimisht atë që ilustruhet në skica, duke mos harruar të jepni numrat e tyre.

*Rr. 42(1)(d)
Rr. 46(2)(i)
Udhëz. F-II, 4.7*

(e) Përshkruani me hollësi të paktën një mënyrë realizimi të shpikjes së pretenduar, duke përdorur shembuj tipikë dhe duke iu referuar cilësdo skicë dhe shenjave referuese që përmbajnë skicat.

Rr. 42(1)(e)
Udhëz. F-II, 4.8,
F-III,
1-3

(f) Tregoni se si shpikja gjen zbatim industrial sipas kuptimit të nenit 57.

Rr. 42(1)(f)
Udhëz. F-II, 4.9

74. Në raste të jashtëzakonshme mund të organizoni përshkrimin në një mënyrë apo rend tjetër, nëse kjo e bën përshkrimin tuaj më të kapshëm dhe më ekonomik.

Rr. 42(2)
Udhëz. F-II, 4.10

75. Edhe pse ideja duhet të jetë e qartë, drejtpërdrejtë dhe pa zhargon teknik të panevojshëm, përdorimi i termave të njohur teknikë është i pranueshëm dhe shpesh i dëshirueshëm. Termat teknikë pak të njohur ose të formuluar enkas lejohen me kusht që të jenë përkufizuar në mënyrë adekuate dhe kur nuk kanë ekuivalentë të njohur.

Rr. 49(11)
Udhëz. F-II, 4.11-4.14

Ju mund të përdorni emra të përveçëm ose fjalë të ngjashme për t'iu referuar një produkti të vetëm nëse duhen për ta identifikuar atë. Por edhe në këtë rast, produkti duhet të jetë i identifikueshëm mjaftueshëm edhe pa u bazuar plotësisht në këto emërtime, në mënyrë që shpikja të jetë e realizueshme nga specialisti i fushës. Nëse këto emërtime ose fjalë të ngjashme janë të regjistruara si marka tregtare, atëherë duhet ta bëni të ditur këtë fakt.

Udhëz. F-III, 7-8

Aplikimet bioteknologjike

Rr. 49(12)

(a) Sekuencat nukleotide dhe aminoacide

75a. Nëse aplikimi juaj për patentë Europiane ka për objekt sekuenca nukleotide ose aminoacide (sekuenca të padegëzuara prej katër ose më shumë aminoacidesh, ose sekuenca të padegëzuara prej dhjetë ose më shumë nukleotidesh), përshkrimi duhet të përmbajë një sekuencë të renditur (rendi i prezantimit të shembujve) në përputhje me standardin WIPO ST.25 dhe të prezantohet si pjesë e ndarë e përshkrimit. Sekuenca e renditur duhet të dorëzohet si në letër dhe në formë elektronike në formatin tekst (.txt). Ju këshillojmë të përdorni falas softuerin "PatentIn" ose BiSSAP që ofrohet falas nga ZEP dhe që thjeshton prezantimin e sekuencave të standardizuara. Nëse ju dorëzoni aplikimin tuaj në letër ose format PDF, ju duhet të dorëzoni një deklaratë në të cilën specifikoni se sekuencat e listuara në formën elektronike janë identike me ato të dorëzuara në letër ose PDF.

Rr. 30, 57
Udhëz. A-IV, 5
GZ 2011, 372
GZ 2013, 542

Nëse ju depozitoni aplikimin tuaj *online* në formë elektronike, ju duhet të bashkëngjitni sekuencën e renditur të depozitimi *online*. Këshilla të mëtejshme mund të merrni nga ZEP.

Ju duhet të plotësoni seksionin 38 të Kërkesës për Dhënie (shiko shtojcat) për të treguar se aplikimi përmban një sekuencë të renditur.

75b. Prezantimi i standardizuar i sekuencave nukleotide dhe aminoacide të tilla është i detyrueshëm. Nëse ju nuk plotësoni kërkesat dhe nuk paguani tarifën për paraqitje edhe pasi ju është dërguar ftesa, aplikimi juaj për patentë Europiane do të refuzohet (por shiko pikën 225).

Rr. 30

(b) Depozitimi i materialit biologjik për të plotësuar përshkrimin

76. Nëse shpikja juaj përfshin ose bazohet në përdorimin e materialit biologjik që nuk është në dispozicion të publikut dhe nuk mund të përshkruhet në aplikimin tuaj për patentë Europiane në mënyrë të tillë që shpikja të mund të kryhet nga një specialist i fushës, ju duhet të depozitoni një produkt provë të këtij materiali biologjik pranë një institucioni depozitues i njohur jo më vonë se në datën e

Neni 53(b), 83
Rr. 31-34
Udhëz. A-IV, 4
Udhëz. F-III, 6
GZ 2010, 498

- depozitimit. Institucionet depozituese të njohura janë autoritetet ndërkombëtare depozituese sipas Traktatit të Budapestit për Njohjen Ndërkombëtare të Depozitimit të Mikro-organizmave për Qëllime të Procedurës së Patentave dhe një numër institucioneve të tjera të përcaktuara nga Kryetari i ZEP. Një listë e plotë e institucioneve depozituese të njohura botohet një herë në vit në faqen e internetit të ZEP dhe në Gazetën Zyrtare të ZEP; në Gazetën Zyrtare botohen edhe ndryshimet që pëson kjo listë si edhe informacionet të tjera përkatëse. *Rr. 33(6)*
- 77.** Aplikimi i depozituar duhet të përmbajë informacionin e rëndësishëm që dispononi në lidhje me karakteristikat e materialit biologjik. *Rr. 31(1)(b)*
Udhëz. F-III, 6.3
- Nëse materiali biologjik është depozituar nga një person tjetër, duhet të tregoni në aplikimin tuaj emrin dhe adresën e depozituesit si dhe të dorëzoni dokumente që bindin ZEP se depozituesi ju ka autorizuar që materialin biologjik ta referoni në aplikimin tuaj dhe se ju ka dhënë pëlqimin e tij të plotë e të pakthyeshëm që materiali i depozituar të vihet në dispozicion të publikut në përputhje me Rregullin 33. *Rr. 31(1)(d)*
GZ 2010, 498
- 78.** Së fundi, duhet të tregoni institucionin depozitues që keni zgjedhur dhe numrin e pranimit të materialit biologjik të depozituar, si rregull brenda 16 muajve pas datës së depozitimit, ose nëse keni pretenduar prioritet, pas datës më të hershme të prioritetit. Po nu u respektua ndonjë nga këto kërkesa, materiali biologjik në fjalë konsiderohet se nuk është paraqitur sipas nenit 83 për shkak të referencës së materialit të depozituar. Ju lutemi referojuni Udhëzimeve për Ekzaminimin (F-III, 6,3). *Rr. 31(1)(c), (2)*
- 79.** Gjithashtu, mos harroni të plotësoni seksionet 34-37 të Kërkesës për Dhënie ("Materiali biologjik"). Kjo bëhet për të njoftuar ZEP se aplikimi i referohet materialit biologjik të depozituar sipas Rregullit 31 dhe për t'i mundësuar ZEP t'ju njoftojë të korrigjoni ndonjë mangësi para skadimit të afateve kohore të përcaktuara në Rregullin 31 (2). *Udhëz. A-IV,*
4.2
- 80.** Që nga data e publikimit të aplikimit për patentë Europiane (shiko pikën 149), materiali i depozituar mund të vihet në kërkesë të çdo personi që bën kërkesë, por vetëm pasi kërkuesi merr përsipër disa detyrime kundrejt aplikantit ose zotëruesit në lidhje me shpërndarjen dhe përdorimin e materialit. *Rr. 33*
- Deri në përfundimin e përgatitjeve teknike për publikimin e aplikimit tuaj (shiko pikën 149), ju mund të informoni ZEP se për një periudhë të caktuar, e vetmja mënyrë që materiali biologjik mund të jetë i disponueshëm është duke i dhënë një produkt provë një eksperti. Ky mund të jetë një ekspert i emëruar nga një marrëveshje e përbashkët mes jush dhe kërkuetit, apo një person fizik i zgjedhur prej kërkuetit nga një listë ekspertësh të njohur nga Kryetari e cila botohet në faqen e internetit të ZEP. Aplikimi për patentë Europiane e përmban edhe mundësinë e zgjedhjes së një "eksperti".. *Rr. 32*
Udhëz. A-VI,
1.1, 1.3
OJ 2010, 498
- 81.** Kërkesat për dhënien e mostrave të materialit biologjik të depozituar sipas Rregullit 33 duhet të dorëzohen në formularë që merren falas nga ZEP. Këto formularë mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit e ZEP (www.epo.org). Formularët e plotësuar duhet të dërgohet te ZEP që i certifikon ato dhe ia përcjell institucionit kompetent depozitues. *Rr. 33(4), (5)*

Pretendimet

- 82.** Pretendimet duhet të përkufizojnë objektin për të cilin kërkohet mbrojtje në lidhje me karakteristikat teknike të shpikjes. Ato duhet të jenë të qartë dhe të prera dhe të mbështeten nga përshkrimi. *Neni. 84
Rr. 43
Udhëz. F-IV, 1*
- 83.** Sipas rastit, pretendimet duhet të përbëhen nga dy pjesë (shiko shembujt në Shtojcën III), pjesa e arritjeve të mëparshme dhe pjesa karakterizuese. Në pretendimin e parë dhe në të gjithë pretendimet e tjera të pavarura, pjesa e arritjeve të mëparshme duhet të përcaktojë objektin e shpikjes dhe karakteristikat teknike të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar atë, por të cilat, të kombinuara, janë pjesë arritjeve të mëparshme. Pjesa karakterizuese duhet të tregojë karakteristikat teknike për të cilat kërkohet mbrojtje në kombinim me karakteristikat në pjesën e arritjeve të mëparshme. *Rr. 43(1)(a), (b)
Udhëz. F-IV, 2*
- 84.** Një pretendim “i pavarur” duhet të pohojë të gjitha karakteristikat thelbësore të shpikjes. *Rr. 43(3)
Udhëz. F-IV,
3.4, 3.7, 3.8, 4.5*
- 85.** Aplikimi për patentë Europiane nuk mund të përmbajë më shumë se një pretendim të pavarur në të njëjtën kategori (p.sh. produkt dhe/ose proces), përveçse në rastin e një nga përjashtimeve të renditura në Rregullin 43(2). Shikoni pikën 145 për hollësi të mëtejshme. *Rr. 43(2)*
- 86.** Çdo pretendim i pavarur mund të pasohet nga një ose më shumë pretendime “të varura” të lidhura me variante të ndryshme të shpikjes. *Rr. 43(3), (4)
Udhëz. F-IV,
3.4-3.6*
- Pretendimet e varura duhet të përfshijnë të gjitha karakteristikat e pretendimit për të cilët ato lidhen. Ato duhet të kenë, mundësisht në fillim, referencën e pretendimit tjetër që mund të jetë edhe i varur, dhe më pas të pohojnë karakteristikat shtesë për të cilat kërkohet mbrojtje.
- Për sa është e mundur, të gjitha pretendimet e varura që i referohen një ose më shumë pretendimeve të mëparshme, duhet të grupohen në mënyrën më të përshtatshme.
- 87.** Meqë neni 84 kërkon që pretendimet të jenë të prera (ky kriter duhet zbatuar si për pretendimet në tërësi ashtu edhe për çdo pretendim individual), ju duhet të kërkonit një numër të arsyeshëm pretendimesh në varësi të natyrës së shpikjes që dëshironi të mbroni. Shmangni përsëritjet e panevojshme si rezultat i pretendimeve të pavarura në të njëjtën kategori, apo nga riprodhimi i pretendimeve të varura. *Rr. 43(5)
Udhëz. F-V, 5*
- 88.** Ju duhet të numërtoni pretendimet tuaja me numra rendorë arabë të njëpasnjëshëm. *Rr. 43(5)*
- 89.** Është shumë e rëndësishme që të formuloni qartë pretendimet tuaja, pasi ato përcaktojnë objektin që doni të mbrojtur. *Neni 84, 69
Udhëz. F-IV, 4.1*
- Formulimi i pretendimeve nuk duhet të lërë asnjë dyshim në lidhje me kuptimin dhe fushën e tyre, dhe duhet të shmangni çdo mospërpjethje mes përshkrimit dhe pretendimeve. *Udhëz. F-IV,
4.2-4.9*
- Fusha e përcaktuar nga pretendimet duhet të jetë sa më e saktë aq sa e lejon shpikja. Si rregull, nuk lejohen pretendimet që përcaktojnë shpikjen si rezultat që duhet arritur. Kur shpikja përfshin një produkt kimik, mund të përcaktohet nga formula kimike, ose si produkt i një procesi, ose në raste të jashtëzakonshme, nga parametrat. *Udhëz. F-IV,
4.10-4.16*

Për më tepër, nuk lejohen referencat për përshkrimin ose skicat, veçanërisht në formën “siç përshkruhet në pjesën ... e përshkrimit” ose “ siç ilustruhet në figurën ... të vizatimit”, përveçse kur janë absolutisht të domosdoshme.

Rr. 43(6)
Udhz. F-IV,
4.17

90. Megjithatë, në një aplikim për patentë Europiane që përmban skica dhe shenja referimi që lidhin pretendimet me skicat përkatëse, duhet të vendoset në kllapa pas karakteristikave teknike të përmendura në pretendime, nëse kjo i bën pretendimet më të lehta për t'u kuptuar. Ato nuk duhet të interpretohen si kufizuese për pretendimet.

Rr. 43(7)
Udhz. F-IV,
4.19

91. Në rrethana të jashtëzakonshme, një aplikim për patentë Europiane ose patenta mund të përfshijnë grupe të ndara pretendimesh për shtete specifike të përcaktuara (shiko pikën 102).

Pretendimet që pëfshijnë tarifa

92. Nëse aplikimi juaj për patentë Europiane përfshin mbi 15 pretendime, ju duhet të paguani një tarifë pretendimesh në lidhje me çdo pretendim mbi këtë numër. Për pretendimin e 51-të si dhe për pretendimet pasuese tarifa për pretendim është më e lartë. Kjo tarifë paguhet brenda një muaji nga depozitimi i grupit të parë të pretendimeve.

Rr 45(1), (2)
Udhz. A-III, 9
Neni. 2,pika 15,
Rr Tarifore
GZ 2009, 118

Nëse aplikimi juaj përfshin disa grupe pretendimesh (shiko pikën 102), paguhet një tarifë vetëm për çdo pretendim mbi numrin 15 të grupit me numrin më të lartë të pretendimeve.

Rr. 45 (2), (3)
Rr. 112(1)
Udhëz. A-III, 9

Nëse nuk paguani tarifat brenda afatit, mund t'i paguani përsëri ato brenda një muaji nga njoftimi që ju dërgohet për mosrespektim të afatit. Nëse nuk paguani tarifat brenda këtij afati të ri, pretendimet për të cilat ju nuk keni paguar tarifat do të gjykohen të tërhequra dhe do të njoftoheni për këtë (por shiko pikën 225).

93. Nëse aplikimi juaj përmban më shumë se 15 pretendime në kohën e dhënies, tarifat e pretendimeve paguhet në këtë fazë nëse nuk janë paguar më parë. Nëse nuk i paguani ato në afat, kërkesa juaj konsiderohet e tërhequr (shiko pika 165, 168).

Rr. 71
Udhëz. C-V, 1-1.5

Skicat

94. Kërkesat në lidhje me prezantimin e shpikjes tuaj me skica përcaktohen në Rregullat 46, 48 dhe 49. Në skica nuk mund të përdoren shenjat e referencës që nuk përmenden në përshkrim dhe në pretendime, si dhe anasjaletash. Karakteristikat e njëjta, kur përcaktohen me shenja reference, duhet të përcaktohen me të njëjtat shenja reference gjatë gjithë aplikimit.

Rr. 46, 48, 49
Udhz. A-IX
Udhëz. F-II, 5

95. Skicat nuk duhet të përmbajnë tekst, përveç fjalëve kyçe si “ujë”, “avull”, “e hapur”, “e mbyllur”, “prerje mbi AB” që janë absolutisht të domosdoshme, dhe në rastin e qarqeve elektrike dhe blloqeve skematike ose diagramave mund të përdoren tituj që janë të domosdoshëm për të dhënë kuptimin. Çdo fjalë kyçe të tilla duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mund të zëvendësohen me përkthimet e tyre, pa cenuar asnjë vizë të skicave.

Rr. 46(2)(j)
Udhëz. A-IX, 8

96. Kartat e proceseve teknologjike dhe diagramat konsiderohen vizatime.

Rr. 46(3)
Udhëz. A-IX, 1

- 96a.** Është e rëndësishme që vizatimet të jenë e një kualiteti të lartë për shpjegimin e saktë të shpikjes. Nëse vizatimet nuk janë të lexueshme, për shembull nëse janë totalisht të zeza, egziston mundësia që ju nuk do të lejoheni të dorëzoni vizatime të një cilësie më të mirë të cilat japim më shumë detaje se sa ato të dorëzuara herën e parë.

Neni. 123 (2)
Udhëz. A-III, 3.2,
A-V, 2.1

ZEP nuk ka direktiva konkrete për fotografitë, megjithatë ato janë të lejuara. Fotografitë me ngjyra skanohen dhe kthehen në formatin elektronik bardh e zi.

Udhëz. A-IX, 1.2

Nëse ju dorëzoni dosjen në formë elektronike, keni avantazhin që do të ruani cilësinë origjinale të fotografive të dorëzuara në ZEP dhe nuk do të ketë komunikim për mungesë cilësie, i cili mund të lëshohet në rastin e dorëzimit në letër, dhe ZEP zotëron vetëm dokumentat e skanuar.

Abstrakti (Përmbledhja e shpikjes)

- 97.** Abstrakti thjesht shërben si informacion teknik. Abstrakti nuk mund të merret parasysh për qëllime të tjera si interpretimi i fushës së mbrojtjes së kërkuar ose aplikimi i neni 54 (3). Abstrakti duhet të hartohet në mënyrë që të jetë instrument efikas kërkimi në fushën përkatëse teknike, si dhe që të mundësojë vlerësimin nëse vetë aplikimi për patentë Europiane ka nevojë për konsultim.
- 98.** Abstrakti, që duhet të paraprihet nga titulli i shpikjes, duhet të përmbajë një përmbledhje koncize (mundësisht jo mbi 150 fjalë) të zbulimit që përmban përshkrimi, pretendimet dhe skicat. Ai duhet të përcaktojë fushën teknike të cilës i përket shpikja, nëse nuk është tashmë e qartë nga titulli, dhe duhet të hartohet në mënyrë që të kuptohet qartë problemit teknik, thelbi i zgjidhjes së problemit që ofron shpikja dhe aplikimet kryesore të shpikjes.
- 99.** Nëse aplikimi juaj përmban skica, ju duhet të tregoni figurën ose në raste të jashtëzakonshme figurat që mendoni se duhet të shoqërojnë abstraktin e publikuar. Në këtë rast çdo tipar kryesor i përmendur në përmbledhje dhe ilustruar në vizatim duhet të pasohet nga shenja përkatëse e referencës në kllapa.
- 100.** Përmbajtja përfundimtare e abstraktit përcaktohet nga ekzaminuesi (shiko pikën 148). Kur abstrakti publikohet si pjesë e aplikimit për patentë Europiane (shiko pikën 149), nuk mund të ndryshohet më.

Neni. 85
Rr. 47(5)
Udhëz. F-II,
2.1, 2.2

Rr. 47(1)-(3)
Udhëz. F-II, 2.3

Rr. 47(4)
Udhëz. A-III,
10.3

Rr. 66

Të dhëna të palejuara

- 101.** Aplikimi juaj nuk duhet të ketë deklarata ose skica që bien ndesh me “ordre public” ose moralin. As nuk duhet të përmbajë pohime denigruese ndaj produkteve ose proceseve të palëve të treta, apo avantazheve ose vlefshmërisë së aplikimeve ose patentave të këtyre palëve. Thjesht krahasimet me arritjet e mëparshme nuk konsiderohen denigruese në vetvete. Për më tepër, nuk lejohen deklaratat që nuk kanë lidhje apo janë të panevojshme për rrethanat.

Rr. 48
Udhëz. A-III, 8
Udhëz. F-II, 7

Karakteri unik i aplikimeve për patentë Europiane dhe patentave

- 102.** Aplikimet për patentë Europiane dhe patentat Europiane kanë karakter unik, domethënë teksti dhe skicat janë uniforme për të gjitha shtetet kontraktuese të përcaktuara.

Neni 118
Udhëz. H-III, 4

Përfshirjet nga ky parim janë si më poshtë:

- (a) Nëse ZEP informohet për ekzistencën e një të drejte të mëparshme sipas nenit 139 (2), aplikimi për patentë Europiane ose patenta për këtë shtet ose shtete mund të përmbajë pretendime të ndryshme, dhe nëse sektori i ekzaminimit e konsideron të nevojshme, edhe përshkrime dhe skica të ndryshme.
- (b) Nëse një vendim i prerë i jep një pale të tretë të drejtën për të marrë një patentë Europiane në lidhje me vetëm një pjesë të objektit të zbuluar në aplikimin për patentë Europiane, atëherë për shtete të përcaktuara në të cilën vendimi është marrë ose është njohur, aplikimi i parë për patentë Europiane duhet të përmbajë pretendime, përshkrime dhe skica që, kur është e nevojshme, janë të ndryshme nga ato për shtetet e tjera kontraktuese të përcaktuara.

Rr. 138
Udhëz. H-III,
4.1, 4.2

Rr. 18(1), (2)
Udhëz. H-III,
4.3, 4.3.1

- 103.** Të drejtat kombëtare të një date më të hershme nuk përbëjnë pjesë të arritjes së mëparshme për qëllimet e ekzaminimit të ZEP për patentim (shiko pikën 34, paragrafi i fundit).

Udhëz. H-III, 4.5

Megjithatë, gjatë ekzaminimit thelbësor (shiko pikën 173) ose procedurave të kundërshtimit (shiko pikën 182), me nismën tuaj mund të paraqitni pretendime të ndara për secilin shtet kontraktues të caktuar në të cilin ekziston një e drejtë kombëtare e mëparshme, me kusht që t'i dorëzoni sektorit të ekzaminimit apo kundërshtimit prova për ekzistencën e saj. Në raste të tilla sektori i ekzaminimit ose kundërshtimit vlerëson vetëm pranueshmërinë e pretendimeve të ndara; nuk gjykon nëse keni kufizuar mjaftueshëm shtrirjen e aplikimit tuaj në lidhje me të drejtën kombëtare më të hershme. Por ama, ekzaminon nëse shpikja e evidentuar në pretendimet e ndara përmbush kërkesat e patentimit të ZEP.

III Depozitimi i aplikimeve për patentë Europiane

Ku depozitohet

- 104.** Ju mund të depozitoni aplikime për patentë Europiane pranë:

Neni 75(1), (2)
Rr. 35
Udhëz. A-II, 1.1
Udhëz. A-II, 3.2

- (a) ZEP në Mynih, dega e saj në Hagë ose në zyrën e saj të shërbimit në Berlin, por jo tek zyra e shërbimit në Vjenë.
- (b) zyra qendrore e pronësisë industriale ose autoritet tjetër kompetent të një shteti kontraktues, nëse ligji i atij shteti e lejon ose e parashikon.

Aplikimet e pjesshme duhet të depozitohen drejtpërdrejt tek ZEP.

Neni 76(1)

- 105.** Mënyra më e zakonshme për të aplikuar për patentën Europiane është në faqen e internetit (shiko pikën 106). Më shumë se 90% e të gjitha aplikimeve për patentë Europiane janë të kryera në këtë mënyrë.

Nëse vendosni se aplikimin nuk do ta bëni nëpërmjet adresës së internetit, adresat e ZEP-së janë dhënë në Shtojcën IV. Adresat e autoriteteve kombëtare të patentave dhe dispozitat kombëtare të shteteve kontraktuese që rregullojnë depozitimin e detyrueshëm apo fakultativ të aplikimeve për patentë Europiane tek këto autoritete jepen në «Ligji i Kombëtar lidhur me KEP « (shiko pikën 4 më lart).

Si depozitohet

- 106.** Ju duhet të depozitoni aplikimet në **formë të shkruar**, pra në formë elektronike, dorazi, me postë ose me faks.

Rr. 1, 2, 35(1)
Udhëz. A-II, 1

Nëse zgjidhni të depozitoni aplikimin tuaj për patentë Europiane në mënyrë elektronike, mund ta bëni këtë online duke përdorur programin e krijuar enkas për aplikime në faqen e internetit të ZEP, të cilin mund ta merrni falas nga ZEP (shikoni www.epo.org)

Udhëz A-II, 1.3
GZ 2015, A91
GZ 2015, A26
GZ 2007, Edicioni Special. 3, A.3

Si alternativë, ju mund të përdorni programin e ri CMS për aplikim ose shërbimin për aplikimin online në faqen e internetit të ZEP, të cilat janë gjithashtu falas nëpërmjet faqes së internetit të ZEP. (www.epo.org)

GZ 2014, A98
GZ 2015, A27

Një nga benefitet e aplikimit nëpërmjet faqes së internetit është ruajtja e cilësisë origjinale të dokumentave. Nëse depozitoni me postë ose me faks, cilësia e dokumentave të dorëzuar mund të jetë më e ulët. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e aplikimit, dhe ju mund të ftoheni të zëvendësoni aplikimin me dokumenta të një cilësie më të lartë.

Për aplikimet të cilat bëhen online ose nëpërmjet ZEP-it tek njëri nga autoritetet kombëtare kompetente (shiko pikën 107), ju do të paguani tarifa të reduktuara aplikimi.

Në faqen e internetit të ZEP mund të gjeni më shumë informacion në lidhje me shërbime të tjera online të ofruara nga ZEP dhe avantazhet e tyre, si për shembull pagesat Online të Tarifave, seksioni i dokumentave personale, Kontrolli i Sigurtë për Dokumentat dhe shërbimin Mailbox.

Ju nuk mund të aplikoni për patentë Europiane pranë ZEP me email ose në ndonjë mënyrë tjetër e cila nuk është përcaktuar më lartë.

GZ 2000, 458
GZ 2015, A28
Udhëz... A-II, 1.4

- 107.** Ju mund të aplikoni për patentë Europiane në formë elektronike me autoritetet kombëtare kompetente të shteteve kontraktuese të cilat e lejojnë këtë gjë.

Ju mund ta depozitoni me faks te ZEP, si dhe te autoritetet kompetente kombëtare të atyre shteteve kontraktuese që e lejojnë. Për më shumë detaje mund ti referoheni versionit më të fundit të "Ligjit Kombëtar lidhur me KEP " në faqen e internetit të ZEP (www.epo.org)

- 108.** Meqë ZEP përdor një sistem automatik skanimit për të evidentimin e aplikimeve për patentë Europiane që duhen printuar, këshilloheni që për aplikimet tuaja të përdorni shkrim dhe font të lexueshëm. (shiko pikën 71)

Rr. 46, 49
GZ 1993, 59

Letra e konfirmimit

- 109.** Nëse keni depozituar aplikimin tuaj elektronikisht ju nuk keni nevojë të dorëzoni letër konfirmimi, e cila kërkohet nga ZEP vetëm kur dokumentet e dërguara me faks kanë cilësi të dobët.

GZ 2015, A91
GZ 2014, A98
GZ 2015, A27

Kur depozitoni letrën e konfirmimit, ju duhet të tregoni qartësisht se kërkonti “konfirmimin e dokumentit të dorëzuar më datë ...me faks”.

GZ 2007,
Edicioni Special
Nr. 3, A.3
Udhëzim.
A-II, 1.2

Data e Depozitimit

- 110.** Data e depozitimit për aplikimet e depozituara në mënyrë elektronike (duke përdorur software të depozitimit online të ZEP, CMS e re online të ZEP ose sistemin e aplikimit në faqen ZEP) ose dorazi të ZEP quhet data kur dorëzohen ose postohen në një nga kutitë e automatizuara të ZEP, nëse dokumentat janë në përputhje me kërkesat e Nenit 80 dhe Rregullit 40 (shiko pikën 136)

GZ 2014, A98
GZ 2015, A27
GZ 2015, A91
GZ 2007, Edicioni
Special Nr. 3, A.3

Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për aplikimet e depozituara te autoritetet kompetente kombëtare të shteteve kontraktuese.

Neni 80, R. 40
GZ 1992, 306,
5.4, 5.6

Njoftimi për pranimin

- 111.** Autoriteti ku depozitoni aplikimit tuaj njofton marrjen pa vonesë duke ju dërguar faqen 8 të Kërkesës për Dhënie, në të cilën shënon datën e pranimit të dokumenteve të aplikimit dhe numrin aplikimit.

Rr. 35(2)
Udhëz. A-II, 3.1
GZ 2015, A91
GZ 2007, Edicioni
Special Nr. 3 A.3

Nëse depozitoni *online*, njoftimi i pranimit ju dërgohet elektronikisht gjatë sesionit të dorëzimit. Nëse e depozitoni në CD-R, DVD-R ose DVD + R, njoftimi ju dërgohet me postë.

GZ 1992, 6, 306

Në kërkesë, ZEP gjithashtu do të nxjerrë faksin e pranimit që tregon se ka marrë dokumentet tuaja, me kushtin që:

- ju e fusni kërkesën për njoftim me faks me dokumentet tuaja
- ju tregoni adresën postare ose të faksit ku njoftimi i pranimit duhet t'ju dërgohet, dhe
- ofroni evidencë që keni paguar tarifën administrative përkatëse (shiko Shtojcën VII), ose bashkëngjitni një faturë debiti.

Dorëzimi i dokumentave nëpërmjet aplikimit online ZEP (CMS) njihet elektronikisht nga ZEP nëpërmjet njohjes së dokumentit marrës nga sistemi CMS.

GZ 2015, A27

Dorëzimi i dokumentave nëpërmjet plotësimit nga faqja e internetit njihet elektronikisht nëpërmjet njohjes së dokumentit të marrës i cili jepet nga faqja e internetit pasi të jenë transferuar dokumentat. Ju mund të kërkonti të merrni njohjen e dokumentit marrës nëpërmjet emailit.

GZ 2014, A98

Aplikimet që depozitohen te autoritetet kombëtare dhe që përcillen te ZEP

- 112.** Nëse një aplikim që depozitoni te një autoritet kombëtar i përcillet ZEP, ajo ju njofton për datën e marrjes duke ju dërguar një kopje evidence për dokumentet e marra

Rr. 35(3), (4)
Udhëzim. A-II, 3.2
GZ 1990, 306

(faqe 8 e Kërkesës për Dhënie). Autoritetet kombëtare informojnë ZEP pa vonesë sapo marrin aplikimet.

Gjithashtu, ju dërgohet një njoftim pranimi, nënshkruar nga autoriteti kombëtar në fjalë, nëse ju depozitoni aplikimet për patentë Europiane elektronikisht te ndonjë nga autoritetet kombëtare. Nëse nuk e merrni këtë njoftim, lutemi kontaktoni autoritetin kombëtar.

- 113.** Në raste shumë të rralla kur aplikimi juaj nuk arrin tek ZEP brenda 14 muajsh pas depozitimit ose pas datës më të hershme të prioritetit, aplikimi konsiderohet i tërhequr dhe çdo tarifë që keni paguar ju kthehet. ZEP ju njofton në lidhje me këtë dhe pastaj mund të konvertoni aplikimin tuaj për patentë Europiane në aplikimet kombëtare.

*Neni. 77
Rr. 37
R. 112(1)
Neni 135(1)(a)
Udhëz. A-II,
1.7, 3.2*

Duhet të depozitoni kërkesën për konvertim te zyra qendrore e pronësisë industriale e shtetit kontraktues ku keni depozituar kërkesën, brenda 3 muajve nga marrja e njoftimit të ZEP. Për hollësi, shikoni “Ligji Kombëtar lidhur me ZEP” (shiko pikën 4).

*Neni 135(2)
Rr. 155(1)
Udhëz. A-IV, 6*

Tarifat

- 114.** Tarifat që paguhen për një aplikim për patentë Europiane janë:

*Neni 2 RFees
Udhëz. A-X*

- (a) Tarifa e depozitimit dhe çdo tarifë shtesë për faqen e 36-të dhe çdo faqe vijuese të aplikimit (shiko pikën 118)
- (b) Tarifa e kërkimit
- (c) Tarifat e pretendimit në lidhje me pretendimin e 15-të dhe çdo pretendim pasues (kur është e përshtatshme) (shiko pika 92, 93)
- (d) Tarifa e përcaktimit (shiko pikat 119, 152)
- (e) Tarifat e shtrirjes së njohjes (një për çdo shtet ku kërkoni shtrirjen e njohjes, shiko pikën 26)
- (f) Tarifa e miratimit
- (g) Tarifat e ekzaminimit (shiko pikat 119, 152, 156)
- (h) Tarifat për dhënie dhe publikim (shiko pikën 165)
- (i) Tarifat e rinovimit për vitin e tretë dhe çdo vit pasues (shiko pikat 213-218)

Tarifa shtesë mund të jenë të pranishme në varësi të vazhdimësisë së procedurave.

- 115.** Pas depozitimit të aplikimit, duhet të paguani tarifën e depozitimit (dhe tarifa të tjera shtesë që mund të ndodhin) dhe kërkimit (dhe tarifën e pretendimit kur pretendimet depozitohen bashkë me aplikimin) brenda një muaji nga data e depozitimit. Nëse depozitoni pretendimet mbas datës së dorëzimit, secila nga tarifën për pretendimet duhet të paguhet brenda një muaji nga dorëzimi i setit të parë të pretendimeve. (shiko pikën 137)

*Neni 79(2), 94(1)
Rr. 39
Udhëz. A-X, 5.2.2
Udhëz. A-III, 11.3.1
Udhëz. A-III, 12.2
R. 70(1)
Udhëz. C-II, 1*

Duhet të paguani tarifën e përcaktimit (dhe çdo tarifë shtrirjeje) brenda 6 muajsh nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit Europian.

Tarifa e ekzaminimit paguhet brenda të njëjtës periudhë.

Një listë të afateve të rëndësishme për depozitimin e aplikimit për patentë Europiane, si dhe afatet për pagimin e tarifave, i gjeni në Shtojcën VI të këtij Udhëzuesi dhe në Formularin 1034 që mund ta merrni te ZEP ose nga faqja e internetit e ZEP: www.epo.org.

GZ 2007,
Edicioni Special
Nr. 3, A.3
Udhëz. A-II, 1.2
Ligji Kombëtar
në lidhje me KEP,
edicioni 16

- 116.** ZEP nuk ju dërgon fatura-pagese apo njoftime për të paguar këto tarifa në afat.

- 117.** Nëse nuk paguani tarifën e përcaktimit në afat, aplikimi konsiderohet i tërhequr (por shiko pikën 120 dhe 225).

Neni 78(2)
Udhëz. A-III, 13

Nëse nuk paguani tarifën e shtrirjes në afat, kërkesa për shtrirjen në këtë shtet konsiderohet e tërhequr (por shiko pikën 120). Kushtet janë të njëjtja për pagesën e tarifës së ekzaminimit dhe të tarifës për kërkesë për ekzaminim.

Rr. 39(2)
Udhëz. A-III, 11.2.3,
12.2

- 118.** Për aplikimet për patentë Europiane me mbi 35 faqe, paguhet tarifë shtesë. Shuma e saj varet nga numri i faqeve mbi 35 dhe llogaritet mbi bazën e faqeve të përshkrimit, pretendimeve, skicave dhe një faqe për abstraktin e shpikjes, në gjuhën e depozitimit. Në këtë rast aplikohet tarifa e ulur për gjuhën sipas Rregullit 6(3). Nuk

Neni 2(1), item 1a,
Rr Tarifore
GZ 2009, 118
GZ 2009, 338
Udhëz. A-III, 13.2

llogariten faqet e kërkesës për dhënien e patentës (Formulari 1001 i ZEP), si dhe as faqet që i përkasin shembujve të përshkrimit (*sequence listing*) në rastin se ato janë në përputhje me standardin WIPO ST.25 dhe prezantohen si një pjesë e veçantë e përshkrimit. Tarifë shtesë paguhet brenda një muaji nga data e depozitimit të aplikimit. Nëse aplikimi depozitohet pa pretendime ose referuar një aplikimi të depozituar më parë, tarifa shtesë paguhet brenda një muaji nga depozitimi i grupit të parë të pretendimeve apo të kopjes së certifikuar (shih pikat 57 dhe 137).

- 119.** Në rastin e aplikimeve Europiane të pjesshme (shiko pikat 208-212), duhet të paguani tarifën e depozitimit, tarif shtesë dhe tarifat e kërimit (si dhe tarifat e pretendimit) brenda një muaji nga depozitimi. Paguhet një tarifë shtesë si pjesë e tarifës së depozitimit për aplikimet të mëtejshme si nën pjesë e aplikimit kryesor të cilat konsiderohen të gjeneratës së dytë ose të mëtejshme. Shuma e tarifës varet nga gjenerata e cilës i përket aplikimi i ri divizional.

Rr. 36(3), (4) R.
Rr. 38(4)
Neni 2(1),
pika 1b,
Rr Tarifor
Udhëz. A-IV,
1.1.2
GZ 2014, A22

Tarifat e rinovimit që janë paguar në aplikimin kryesor duhet të paguhen përsëri për të gjitha nën aplikimet e mëpasme. Periudha e pagesës për këto tarifa është 4 muaj nga marrja e faturës për dorëzimin e aplikimit divizional, me kusht që të paguhet një shtesë prej 50% të tarifës së rinovimit.

Neni. 86(1)
Rr. 51(3)
Udhëz. A-IV,
1.4.3

Ju duhet të paguani tarifën e ekzaminimit, ato, të përcaktimit dhe të shtrirjes, brenda 6 muajsh nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit Europian për aplikimin e pjesshëm.

Rr. 70(1)
Rr. 39(1)

- 120.** Kini parasysh se po nuk rrespektuat afatet e mësipërme për pagimin e tarifës së depozitimit, tarifës shtesë, tarifës së kërkimit ose tarifës së përcaktimit, përpunimi i mëtejshëm është i mundur brenda dy muajve nga njoftimi i ZEP për humbjen e të drejtave në lidhje me pagimin e tarifës (Rregullore 112(1)) së papaguar dhe tarifën e parashikuar për përpunim të mëtejshëm (shiko pikën 225).

R. 112(1)
Neni. 121
R. 135(1)
Udhëz. E-VII,
1.9, 2.1
Udhëz. A-III,
12.2
GZ 2015, A19
GZ 2015, A85

Nëse ju nuk paguani tarifën e shtrirjes ose të ekzaminimit sipas afateve të përcaktuara, kërkesa për shtrirje apo ekzaminim në varësi të shtetit që i përket do të quhet e tërhequr. ZEP nuk do t'ju dërgojë komunikim për t'ju kujtuar për pagesat e prapambetura. Megjithatë, ju mund të paguani tarifën e shtrirjes ose të ekzaminimit përsëri deri në dy muaj nga kalimi afatit nëse pranoni të paguani një shtesë prej 50% nga tarifa fillestare.

Nëse ju keni humbur të drejtën për shkak të mos pagesës, ju do të informoheni duke theksuar humbjen e të Drejtave sipas Rregullores 112(1). Së bashku me tarifën përcaktimit dhe tarifën e procedimit të mëtejshëm ju do të keni mundësinë që të paguani tarifat e përcaktimit dhe ekzaminimit brenda dy muajve nga marrja e lajmërimit si më sipër së bashku me një shtesë 50% të tarifave respektive të ekzaminimit dhe shtrirjes.

Shumat e tarifave dhe mënyrat e pagesës

- 121.** Shumat e tarifave, mënyrat e pagesës dhe datat e sakta të pagesave janë të zgjidhura sipas Rregullores në lidhje me Tarifat (Rfees) dhe nga masat e marra nga presidenti i ZEP mbi zbatimin e disa dispozitave të këtyre Rregullave.

Neni 2, 5,
7 Rr Tarifat
Marrëveshjet
për depozitat
(ADA2)
Udhëz. A-X

Udhëzimet për pagimin e tarifave publikohen në çdo numër botimi të Gazetës Zyrtare të ZEP dhe në faqen e saj të internetit: www.epo.org, kështu që duhet të konsultoheni gjithnjë me numrin e fundit të botuar.

- 122.** Mbani parasysh këshillat dhe rekomandimet në vijim në lidhje me pagimin e tarifave për ZEP:

- (a) Tarifat për ZEP duhet të paguhen në euro.

Udhëz. A-X, 3
GZ 2014, A75
GZ 2015, A65

Tarifat, përfshi ato për aplikim për patentë Europiane te një autoritet kombëtar, duhet të paguhen direkt te ZEP Mund të paguani direkt ose me transfertë te një llogari bankare të ZEP, ose përmes debitimit të një llogarie që ju keni hapur me ZEP.

- (b) Në varësi të mënyrës si paguani, data e pagesës konsiderohet dita në të cilën:

Neni. 7 R
Udhëz. A-X, 4

- shuma e pagesës ose transferimi kalohet te një llogari bankare e Zyrës, ose
- ZEP merr mandatin e debitit që konfirmon pagesën..

Është e këshillueshme ti paguani tarifat e sa më shpejt, mundësisht në kohën kur depozitoni aplikimin.

- (c) Nëse pagesa merret pas skadimit të afatit përkatës, afati konsiderohet i respektuar nëse mund t'i vërtetoni Zyrës se në një shtet kontraktues, jo më vonë se 10 ditë përpara afatit të fundit të pagesës:

Neni 7(3)
Rr. Tarifat,
Pika 6.8 ADA
Udhëz. A-XI, 6.2

- ju e keni kryer pagesën përmes një institucioni bankar, ose
- ju keni urdhëruar një institucion bankar të transferojë shumën përkatëse, ose
- ju keni dërguar në një zyrë postare një letër adresuar Zyrës e cila përmban një urdhër për pagimin të një llogari debiti e hapur me ZEP, me kusht që të ketë fonde të mjaftueshme në llogari në ditën e fundit të afatit.

dhe ju keni paguar një shtesë prej 10% mbi tarifën ose tarifat përkatëse, por që nuk i kalon 150 euro; nuk paguhen shtesa nëse kryeni një nga veprimet e përmendura më sipër jo më vonë se 10 ditë para skadimit të afatit.

Neni 7(3)(b) Rr
Tarifor

Zyra mund të kërkojë që të dorëzoni evidenca për datën në të cilën keni kryer një nga veprimet më sipër, dhe kur është e nevojshme të paguani shtesë, brenda një periudhe të cilën ajo e përcakton. Nëse nuk e zbatoni këtë kërkesë, nëse dorëzoni prova të pamjaftueshme, ose nëse nuk paguani shtesat në afat, afati për pagesën konsiderohet i shkelur.

Neni 7(4)
RFees

- (d) Nëse paguani tarifat përmes një institucioni bankar, bankën mund ta zgjidhni ju. Pagesat dhe transfertat duhet të bëhen te një nga llogaritë e ZEP në gjermani Commerzbank:

IBAN DE20 7008 0000 0333 8800 00
BIC DRESDEFF700
Commerzbank AG
Promenadeplatz 7
80273 München
Gjermani

- (e) Nëse depozitoni një aplikim për patentë Europiane te ZEP ose pranë një autoriteti kombëtar dhe keni një llogari bankare me ZEP, mund të paguani tarifat për depozitimin thjesht përmes llogarisë tuaj; mjafton të plotësoni seksionin e duhur të formularit të pagesës së tarifës (Formulari 1010 ZEP) që i bashkangjitni aplikimit.

Neni 7(2) Rr
Tarifor,
Pika 4, 6 ADA
Udhëz. A-X, 4.2
GZ 2015, A65

ZEP gjithashtu pranon urdhër-debitet e dërguara me faks apo elektronikisht. Për më tepër informacione për pagimin e tarifave online, shkoni tek Shërbimet Online të ZEP te faqja e internetit e ZEP (www.epo.org).

Nëse keni depozituar aplikimin tuaj te një autoritet kombëtar dhe ZEP nuk merr udhër debinë e mbyllur deri në ditën kur skadon afati, ju konsideroni se keni respektuar afatin nëse keni fonde të mjaftueshme në llogarinë tuaj në datën kur skadon afati.

- (f) Nëse jeni mbajtësi i një llogarie debitit me ZEP, keni mundësinë të dërgoni urdhër debitimi automatik (duke përdorur seksionin 42 të Kërkesës për Dhenie, Formulari 1001, shiko Shtojcën VII).

Pika 6.2 ADA
ADA, Shtojca B
ADA, Shtojca A.1
dhe A.2
Udhëz. A-X, 4.3
Pika 6.2 ADA
Pika 6.6, 6.7 ADA

Nëse lëshohet një urdhër debitimi automatik, të gjitha tarifat të cilat duhet të paguhet brënda një afati të caktuar do të debitojnë në ditën e fundit të këtij afati, ose sipas dispozitave speciale të aplikueshme. Për më shumë informacion, referohuni tel OJ 2015, Publikim i tretë suplementar. Pagesa nëpërmjet llogarisë bankare depozituese, duke përdorur një urdhër debitimi individual ose automatik, zvogëlon riskun e pagesave të vonuara dhe kostove shtesë të mundshme të krijuara nga vonesat.

- (g) ZEP pranon urdhër pagesa të plotësuar elektronikisht ose të dërguara me faks. Për më shumë informacion mbi pagesat elektronike të tarifave, shkoni tel shërbimet Online në faqen e internetit të ZEP (www.epo.org)

Pika 6.3 ADA

Për pagesat e kryera nëpërmjet Aplikimi elektronik ZEP ose Pagesat e Tarifave Elektronike, mbajtësi i llogarisë depozituese mund të përcaktojë që pagesa do të bëhet pas datës së aplikimit. Kjo pagesë mund të kryhet deri në 40 ditë nga data e aplikimit.

- (h) Pavarësisht se si vendosni të paguani, është e këshillueshme që të përdorni formularin e pagesës së tarifës (Formulari 1010, shiko Shtojcën VII)

Pika 6.2 ADA

Mos përdorimi i Formularit ZEP 1010 do të shkaktojë vonesa të konsiderueshme, edhe nëse ju do të bëni pagesën ditën e aplikimit. Megjithatë, ju do t'ju kërkohet të ri dorëzoni urdhërin e debitit në Formularin ZEP 1010.

Ju mund ta merrni formularin falas nga ZEP, ose mund ta shkarkoni nga faqja e internetit ZEP (www.epo.org).

Rimbursimi i Tarifave

- 122a.** Si rregull, tarifat e paguara nuk kthehen përveç rasteve kur është parashikuar në mënyrë specifike (shih gjithashtu pikat 113, 156, 168). Ka dy kushte që një pagesë tarife të jetë plotësisht e vlefshme:

Udhëz. A-X,
10.1.1

- (I) pagesa duhet të lidhet me procedurat që janë në pritje; dhe
(II) data e pagesës duhet të jetë në ose pas datës së caktuar.

Tarifa e ekzaminimit kompensohet në masën 100% nëse aplikimi për patentë Europiane është tërhequr, refuzuar ose konsiderohet si i tërhequr para se komisioni i ekzaminimit ta marrë si përgjegjësi.

Neni 11(a) Rr
Tarifore
Neni. 11(b) Rr
Tarifore
Udhëz. A-X,
10.2.4
GZ 2013, 153

Tarifa e ekzaminimit kompensohet deri në 75% nëse aplikimi për patentë Europiane është tërhequr, refuzuar ose konsiderohet si i tërhequr pasi komisioni i ekzaminimit e ka marrë si përgjegjësi por nuk ka filluar ende ekzaminimi thelbësor (shih pikën 156).

Në mënyrë të ngjashme, tarifa e paguar për kërkimin European ose Kërkim European shtesë rimbursohet e plotë nëse aplikimi për patentë Europiane është tërhequr, refuzuar ose konsiderohet të jetë tërhequr para se Zyra të ketë filluar hartimin e raportit të kërkimit.

Neni 9(1)
Rr Tarifore
Udhëz. A-X, 10.2.1
GZ 2013, 153

Tarifa për Kërkimin Evropian kthehet në tërësi ose pjesërisht nëse Raporti i Kërkimit Evropian mund të bazohet në një raport kërkimi egzistues tashmë i përgatitur nga ZEP në nivel kombëtar, Evropian ose për një aplikim ndërkombëtar për të cilin cilën pretendohet tashmë për prioritet, ose, në rastin e aplikimeve si nën aplikime ndaj atij mëmë, ku raporti i kërkimit është i bazuar në një kërkim të më parshëm i përgatitur nga ZEP në aplikimin mëmë. Rimbursimi i tarifës së kërkimit mund të kërkohet duke shënuar kutinë në seksionin 40 të formularit për kërkesë për Dhënie (shih gjithashtu pikën 212).

Neni. 9(2)
Rr Tarifore
Udhëz. A-X,
10.2.1,
GZ 2014, A29

Tarifa e përcaktimit duhet të paguhet pas publikimit të miratimit të Raportit të Kërkimit Evropian. Ajo mund të kthehet vetëm nëse aplikimi për patentë Europiane është tërhequr, refuzuar ose konsiderohet si i tërhequr para datës së atij publikimi. Pas kësaj date tarifa e përcaktimi konsiderohet si e paguar në mënyrë të vlefshme dhe nuk mund, pra, të kthehet.

Rr. 39(3)
Udhëz. A-III,
11.2.4
Udhëz. A-X,
5.2.2

IV. Depozitimi i dokumenteve të tjera

Ku dhe si depozitohen

- 123.** Pasi ta keni depozituar një aplikim për patentë Europiane, mund të dorëzoni dokumente të tjera të përmendura në Rregullin 50 të KEP pranë ZEP në Mynih, në Hagë apo në Berlin, ose në mënyrë elektronike duke përdorur softuerin *Online* për depozitimet, ose dorazi apo me postë. ZEP ofron formularë që shërbejnë ose si njoftim i parapërgatitur i pranimit (Formulari 1037), apo si letër që shoqëron dokumentet e depozituar më pas (Formulari 1038).

Rr. 50
Udhëz. A-VIII, 2.5
GZ 2000, 458

Ju mund të depozitoni dokumente me faks (përveç autorizimeve dhe dokumenteve të prioritetit). Dokumentet nuk mund të depozitohen me e-mail, disketa, teletekst, telegram, teleks apo mjete të ngjashme.

GZ 2012, 348

- 124.** Nëse keni depozituar aplikimin te një autoritet kombëtar, në të njëjtën mënyrë mund të depozitoni të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me aplikimin, duke iu nënshtruar ndonjë kufizimi sipas ligjit kombëtar, por vetëm deri në datën kur merrni njoftimin se ZEP ka pranuar kërkesën tuaj. Sapo merrni këtë njoftim, duhet të dorëzoni këto dokumente të tillë drejtpërdrejtë te ZEP.

Rr. 35(4)
Udhëz. A-II, 3.2

Dokumenta të dorëzuar më pas me qëllimin për të zëvendësuar pjesë të aplikimit për patentë Europiane, pra përshkrimi, pretendimet, vizatimet dhe abstrakte, duhet të të përmbushin kërkesat formale të rregullores 49; pra rregullime të shkruara me dorë konsiderohen formalisht të cinguara dhe duhet të dorëzohen në formë të shtypur.

Rr. 49, 50(1)
Udhëz. A-VIII, 2.1
GZ 2013, 603

Nënshkrimi

- 125.** Me përjashtim të shtojcave, çdo dokument i depozituar pas depozitimit të aplikimit për patentë Europiane duhet të nënshkruhet. Nënshkrimi mund të marrë formën e një nënshkrimi të shkruar me dorë, riprodhim i nënshkrimit të depozituesit (në faks) ose me faksimile apo nënshkrim elektronik në rastin e depozitimeve *online*. Emri dhe pozicioni i atij personi duhet të jetë i qartë nga nënshkrimi. Si pasojë e vendimit të marrë nga Presidenti i ZEP i cili hyri në fuqi në 16 Nëntor 2015, përdorimi i një nënshkrimi elektronik të avancuar

Rr. 50(3)
Rr. 2(2)
Udhëz. A-VIII, 3.3
GZ 2015, A91

nuk është më i detyrueshëm në procedurat për apelim. Neni 8(2) i vendimit të marrë në Shkurt 2009 në lidhje me dorëzimin online të dokumentave (OJ 2009, 12) është fshirë në versionin e rishikuar.

Nënshkrimi në dokumentat e dorëzuar elektronikisht me anë të CMS ose version elektronik në faqen e ZEP mund të pranoj një faksimile ose një nënshkrimi elektronik të kodifikuar.

GZ 2014,
A97, A98

Nëse nënshkrimi i dokumentit është harruar, ZEP fton palën e interesuar ta nënshkruajë brenda një afati të caktuar. Nëse nënshkruani në këtë afat, dokumenti mban datën e parë të pranimi të saj; në të kundërt, konsiderohet i papranuar.

Udhëz. A-VIII,
3.1

Letra e konfirmimit

- 126.** Nëse ju depozitoni dokumentet elektronikisht, nuk është e nevojshme të dërgoni letër për konfirmim. Nëse ju kërkohet një konfirmim me shkrim i një dokumenti të dorëzuar me faks, ju duhet ta bëni këtë brenda një afati jo përtej dy muajsh. Nëse e shkelni këtë afat, dokumenti konsiderohet i papranuar (shiko pikën 109).

Rr. 2(1)
GZ 2007,
Edicioni Special
Nr. 3, A.3
GZ 2015, A91
GZ 2014, A97,
A98
Udhëz. A-VIII,
2.5

Data e pranimi

- 127.** Rregullat për depozitimin e aplikimit për patentë Europiane që përcakton pika 110, zbatohen *mutatis mutandis* edhe për depozitimin e dokumenteve të tjera.

GZ2015, A91
GZ 2007,
Edicioni Special
N3. 3, A.3
GZ 2014,
A97, A98

Njoftimi i pranimi

- 128.** ZEP njofton pranimin e materialeve të depozituara më pas përmes formularëve për këtë qëllim që plotësohen nga aplikanti (Formularët 1037 dhe 1038 të ZEP). Në rast të depozitimit elektronik (shiko pikën 111) duke përdorur softuerin *Online* të depozitimit të ZEP, gjenerohet menjëherë një njoftim pranimi.

GZ 2015, A91
GZ 2007, *Edicioni*
Special Nr. 3, A.3
GZ 2014, A97,
A98

Për mundësinë e marrjes së një njoftimi pranimi me faks, shikoni paragrafin e dytë të pikës 111.

Udhëz. A-II, 3.1

D. Procedura e dhënies së patentës Europiane

I. Vështrim i përgjithshëm

- 129.** Procedura e dhënies së patentës Europiane është një procedurë ekzaminimi që fillon me ekzaminim formal dhe një kërkim të detyrueshëm.

Faza e parë përfundon me publikimin e aplikimit për patentë Europiane dhe raportin e kërkimit.

Me kërkesën e të interesuarit, kjo pasohet nga faza e dytë: ekzaminimi thelbësor.

Pasi jepet patenta, mund të ketë një procedurë të mëtejshme në formën e procedurave të kundërshtimit, ose, sipas kërkesës së mbajtësit të patentës, procedurave të kufizimit apo revokimit.

- 130. Faza e parë e procedurës** përfshin një ekzaminim për depozitimin, ekzaminimin e formaliteteve, përgatitjen e raportit të kërkimit European dhe një opinion paraprak për patentueshmërinë, dhe publikimin e aplikimit dhe raportit të kërkimit. Përgjegjësia për këtë fazë i takon Sektorit të Pranimi dhe Sektorit të Kërkimeve.

*Neni 16, 17,
90-93
Rr. 55-69
Udhëz. A, B*

- 131. Faza e dytë** përfshin ekzaminimin thelbësor dhe dhënien. Një Sektor Ekzaminimi përbëhet nga tre ekzaminues të kualifikuar teknikisht, të cilëve kur është e nevojshme u shtohet një ekzaminues ligjor i kualifikuar. Si rregull deri në marrjen e vendimit për aplikimin, ekzaminimi i besohet një prej ekzaminuesve ligjore të kualifikuar. Ky ekzaminues është përgjegjës për komunikimin dhe diskutimin e aplikimit me aplikantin, me shkrim, personalisht ose përmes telefonit.

*Neni 18, 94-98
Rr. 71-74
Udhëz. C*

Nëse aplikanti kërkon procedim gojor, ose (në raste të veçanta) organizohet me nismën e Zyrës, procedimi mbahet para sektorëve të Ekzaminimit. Vendimi përfundimtar për dhënien e patentës ose refuzimin e aplikimit i takon gjithashtu Departamentit të Ekzaminimit.

*Neni 116
Udhëz. E-II*

- 132.** Pas dhënies së patentës mund të ketë procedime kundërshtimi që si kundërshtarë janë palë të treta të tilla si konkurrentët. Përgjegjësia për ekzaminimin e kundërshtimeve i takon sektorit të kundërshtimit që janë të përbërë njësoj si sektorët e ekzaminimit, përveçse vetëm një anëtar i sektorit të kundërshtimit mund të ketë qenë i përfshirë në procedurat e mëparshme të dhënies, dhe ky anëtar nuk lejohet të kryesojë sektorin.

*Neni. 19, 99-105
Rr. 75, 89
Udhëz. D*

- 133.** Pas dhënies së patentës mund të ketë procedura revokimi ose kufizimi të iniciuara nga vetë zotëruesi i patentës. Në çdo kohë pas dhënies së patentës, zotëruesi i patentës mund të kërkojë revokimin ose kufizimin e patentës së tij. Vendimet për revokimin ose kufizimin e patentave Europiane merren nga sektorët e ekzaminimit. Më shumë detaje në lidhje me procedurat e revokimit dhe kufizimit mund të gjeni në pikat 189-196.

*Neni. 105a-105c
R. 90-96*

- 134.** Procedurat e ankimit përbëjnë një procedurë të veçantë³ (ZEP publikon informacion nga bordet e apelit në një suplement vjetor të Gazetës zyrtare.) Mund të depozitohen ankime kundër vendimeve të marra nga Sektori i Pranimit, sektorët e ekzaminimit, sektorët e kundërshtimit apo nga Sektori Juridik. Një vendim që nuk pushon procedimin lidhur me një nga palët, mund të ankimohet vetëm së bashku me vendimin përfundimtar, përveçse nëse vendimi lejon ankimin të veçantë.

*Neni 106-112a
Rr. 99-103
Udhëz. E-X
Publikim Suple-
mentar 1, GZ
2015*

Vendimet mbi ankimet merren nga Bordet e Ankimit.

Neni. 21

- 135.** Në disa raste mund të depozitoni kërkesë për riekzaminim nga Bordi i Zgjeruar i Ankimit. Për më shumë detaje, shiko pikën 207.

*Neni. 22, 112a
Rr. 104-110*

II. Procedura deri në publikimin e aplikimit

Ekzaminimi i depozitimit

- 136.** Me marrjen e një aplikimi, Sektori i Pranimit ekzaminon nëse mund t'i akordohet një datë depozitimi. Kjo ndodh nëse dokumentet e aplikimit përmbajnë:

*Neni 80, 90(1)
Rr. 40
Udhëz. A-II, 4.1*

- kërkesë për patentë Europiane
- informacion që identifikon aplikantin
- përshkrimin ose referencën e një aplikimi të depozituar më herët

- 137.** Nuk është e nevojshme të depozitoni ndonjë pretendim për të marrë një datë depozitimi. Ju mund të depozitoni pretendimet brenda dy muajve nga data e depozitimit ose nga një ftesë që ju kërkon të bëni këtë. Megjithatë, duhet të kujdeseni që të mos e zgjeroni sferën e objektit në aplikim nëse pretendimet depozitohen më vonë.

*Neni 90 (3)
Neni 123(2)
Rr. 57(c)
Rr. 58
Udhëz. A-III, 15*

- 138.** Nëse data e depozitimit nuk jepet pasi është konstatuar ndonjë mangësi dhe nëse ndonjëri nga kushtet e përmendura në pikën 135 nuk është i plotësuar atëherë ju nuk mund t'ju jepet një datë për depozitimin. Sektori i Pranimit do t'ju informojë në kohë dhe do t'ju ftojë që ju të bëni rregullimet e duhura brenda një afati kohor të pa zgjerueshëm prej dy muajsh. Nëse ju ktheni përgjigje në kohën e duhur dhe të gjitha korrigjimet janë bërë, data e marrjes në dorëzim do të quhet data në të cilën keni dorëzuar aplikimin. Nëse nuk ktheni përgjigje në kohë, aplikimi juaj nuk do të procesohet si një aplikim për patentë Europiane.

*Neni 80, 90(1)
Rr. 55
Udhëz. A-II,
4.1.4, 4.1.5*

Që të akordohet data e depozitimit, nuk ka kritere të veçanta në lidhje me formën apo prezantimin e dokumenteve. Por është thelbësore që të lexohen qartë në mënyrë që të kuptohet informacioni që përmbajnë.

Ekzaminimi i formaliteteve

- 139.** Pasi akordohet data e depozitimit, Sektori i Pranimiit ekzaminon nëse janë paguar në afat tarifat e depozitimit dhe kërkimit si dhe nëse është dorëzuar në afat përkthimi i aplikimit në gjuhën e procedurave, nëse kërkohet (shiko pikat 114, 115 dhe 42-46). Nëse tarifa e depozitimit apo kërkimit nuk është paguar në afat, aplikimi për patentë Europiane konsiderohet i tërhequr (shiko pikën 117). Megjithatë, shikoni pikën 225 për mundësinë e përpunimit të mëtejshëm.
- Neni 14(2), 78(2), 90(3)
Rr. 38, 57(a), 58
Udhëz. A-III, 13-14*
- 140.** Nëse aplikimit i është akorduar një datë depozitimi dhe nuk konsiderohet i tërhequr, Sektori i Pranimiit verifikon nëse përmbush dispozitat përkatëse për përkthimet, përmbajtjen e Kërkesës për Dhënie (shiko pikën 48), praninë e pretendimeve (shiko pikat 82-92, 137), depozitimin e abstraktit (shiko pika 47 dhe 97-100), përfaqësimin (shiko pikat 58-66), kërkesat fizike të dokumentave të aplikimit duke përfshirë dhe sekuencat e listuara dhe zbulimin e materialit biologjik (shiko pikën 70-71, 75a – 75b dhe 76), ndonjë prioritet të pretenduar (shiko pikat 52-56), emërtimin e shpikësit (shiko pikat 49-51) dhe depozitimin e ndonjë skice. Nëse Sektori i Pranimiit gjen mangësi të korigjueshme, ju fton t'i ndreqni ato sipas Rregullores së Zbatimit; nëse nuk i ndreqni, hyjnë në fuqi pasojat juridike që përcakton KEP, dmth aplikimi konsiderohet i tërhequr ose i refuzuar.
- Neni 90(3)-(5)
Rr. 57-60
Rr. 30
Udhëz. A-III, 16
Udhëz. A-IV, 4, 5
Udhëz. A-V, 1, 2.2*
- 141.** Nëse mangësitë lidhen me një pretendim për prioritet dhe nuk janë të korigjueshme, apo nëse ju nuk i ndreqni edhe pasi ftoheni për ta bërë këtë gjë, ju e humbni të drejtën tuaj për prioritet.
- Rr. 59
Neni 90(5)
Udhëz. A-III, 6.5.3*
- Duhet bërë një dallim mes mospërcaktimit të datës apo vendit të aplikimit(eve) të mëparshëm brenda afatit kohor 16-mujor, si dhe mospërmbushjes së kërkesave të tjera. Të korigjueshme janë vetëm kërkesat që kanë të bëjnë me mospërmbushjen e kërkesave të tjera.
- 142.** Nëse mungojnë pjesë të përshkrimit ose skicave të referuara në përshkrim, Sektori i Ekzaminimit do t'ju ftojë sipas Rregullores 56(1) KEP për të dorëzuar dhe pjesën munguese brenda një limiti kohor të pa zgjatshëm prej dy muajsh. Ju keni të drejtë që individualisht të dorëzoni materiale të mungojnë brenda dy muajsh nga data e dorëzimit të dokumentave. Në të dyja rastet data e dorëzimit do të rivendoset me datën në të cilën u plotësuan dokumentat që mungonin në ZEP. Duhet të vini re, se ndryshimi i datës së dorëzimit mund të bëjë që ju të humbisni të drejtën për prioritet, nëse data e re e akorduar është jashtë periudhës 12 mujore të prioritetit (shiko pikën 52)
- Rr. 56(1), (2)
Udhëz. A-II, 5
Udhëz. C-III, 1.1.1*
- Nëse ju nuk dorëzoni një kthim përgjigje sipas Rregullores 56(1), të gjitha referencat që mungojnë do të fshihen dhe do të ruhet data e parë e depozitimit.
- Data e parë e depozitimit do të mbahet nëse ju deklaroni dhe dëshmoni brenda një afati kohor se pjesët të cilat mungojnë në përshkrim ose skica përfshihen tërësisht në aplikimin fillestar për të cilën pretendohet për prioritet. Për këtë qëllim, një kopje e aplikimit për prioritetit, përveç rastit kur është e disponuar nga ZEP, dhe, nëse është e nevojshme, duhet të dorëzohet e përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të ZEP. Ju duhet të specifikoni ku ndodhen pjesët që pretendohet se mungojnë në aplikimin për prioritet.
- Rr. 56(3)*
- ZEP do t'ju njoftojë për datën e akorduar të dorëzimit mbasi ky vendim të merret nga Sektori i Pranimiit.
- Sektori i ekzaminimit mund të rishikojë vendimin e marrë nga Sektori i Pranimiit.

- 143.** Për kërkesat në lidhje me dokumentet e paraqitura pas depozitimit të aplikimit për patentë Europiane, shikoni pikat 123-128 dhe 171-176.

Raporti i kërimit Europian

- 144.** Kërkimi Europian kryhet paralelisht me ekzaminimin e formaliteteve. Siç e përmendëm (pika 17), ZEP do të bëjë çdo përpjekje për të përshpejtuar kërkimin, nëse ju e kërkon këtë kur depozitoni aplikimin (shiko Shtojcën II, pika 3). Për aplikimet e para Europiane shikoni pikën 18.

Neni 92
Rr. 61
Udhëz. B
GZ 2015, A93

Raporti i kërimit hartohet në bazë të pretendimeve, duke mbajtur parasysh përshkrimin dhe skicat. Kur hartohet, raporti përmend dokumentet e ZEP që mund të merren parasysh për vlerësimin e rrisë dhe hapit shpikës .

Rr. 68(1)

Raporti i kërimit shoqërohet me një opinion që shpreh nëse aplikimi dhe shpikja përkatëse plotësojnë kërkesat e KEP. Raporti i kërimit shërben për të dhënë informacion aplikantit mbi qënësinë e shpikjes dhe publikut duke e publikuar këtë raport.

Udhëz. B-X

Raporti i Kërimit përpilohet mbi bazat e pretendimeve, dhe duke u mbështetur tek përshkrimi dhe skicat. Ky raport evidenton nëse kjo shpikje është përmendur më parë duke treguar dhe dokumentat përkatëse tek ZEP gjatë kohës së përpilimit të cilat mund të përdoren për të vendosur nëse aplikimi është diçka e re apo një hap inovativ.

Rr. 62, 65
Udhëz. B-XI

Raporti i kërimit shoqërohet me një opinion mbi faktin nëse aplikimi dhe shpikja të cilës ky aplikim i përket përmbushin kushtet e vendosura nga KEP.

Opinionin nuk jepet nëse ju nuk keni paguar tarifën e ekzaminimit ose keni hequr dorë nga e drejta tuaj për të marrë komunikimin sipas Rregullit 70(2) të KEP (shiko pikën 158) përpara se t'ju komunikohet raporti i kërimit. Në këtë rast, ju do të merrni vetëm një komunikim të parë nga sektori i ekzaminimit.

Udhëz. B-XI, 7

Opinionin jodetyrues nuk botohet bashkë me raportin e kërimit, por vihet në dispozicion të publikut pas publikimit të aplikimit.

Neni 128
Rr. 62(2)

- 145.** Nëse aplikimi përmban më shumë se një pretendim të pavarur në të njëjtën kategori (shiko pikën 85) dhe nëse nuk gjen zbatim asnjë nga përjashtimet e shënuara në Rregullin 43(2), atëherë ju do të ftoheni që brenda dy muajsh të tregoni bazat mbi të cilat do të kryhet kërkimi. Nëse nuk e jepni këtë sqarim, kërkimi do të bëhet në bazë të pretendimit të parë të pavarur që jepet në secilën kategori.

Rr. 62a
Rr. 137(5)
Udhëz. B-VIII, 4

Po kështu, nëse është e pamundur të kryhet një kërkim i qenësishëm në bazë të të gjithë ose të një pjese të objektit të pretenduar, ju do të ftoheni sërish që brenda dy muajsh të dorëzoni një deklaratë ku përcaktoni objektin ku do të bazohet kërkimi. Nëse deklarata juaj nuk është e mjaftueshme për ta ndrequr këtë mangësi, ZEP do t'ju vërë në dispozicion një raport kërkimi të pjesshëm ose një deklaratë ku thuhet se nuk mund të realizohet kërkim i qenësishëm.

Rr. 63
Udhëz. B-VIII, 3

Duhet të vini re se gjatë përgjigjes ndaj kësaj ftese për qartësim, ju mund të mos bëni asnjë rregullim tek dokumentat e aplikimit.

Rr. 137(1)

Kur sektori i ekzaminimit merr përsipër përgjegjësinë, do t'ju ftojë të fshini nga aplikimi atë pjesë të objektit për të cilën nuk është bërë kërkim, përveç rastit kur konstaton se realizimi i pjesshëm i kërimit është i pajustifikuar.

Rr. 137(5)

- 146.** Menjëherë sapo hartohet, raporti i kërimit European ju përcillet së bashku me kopjen e ndonjë dokumenti të cituar. Nëse ju nevojitet edhe një kopje tjetër e dokumenteve, duhet ta kërkonit duke mbushur kutinë përkatëse të formularit Kërkesë për Dhënie (referojuni pikës 39 të Kërkesës për Dhënie) kur depozitoni aplikimin dhe pasi paguani tarifën përkatëse administrative.

Neni 92
Rr. 65
Udhëz. B-X, 12

Pasi merrni raportin e kërimit, ju mund të tërhiqni aplikimin nëse mendoni se nuk ka asnjë mundësi për sukses. Nëse vendosni t'i hyni procedurës për dhënien e patentës (shiko pikën 155), ju do të ftoheni, nëse ende nuk e keni bërë diçka të tillë, që të paguani tarifën për Egzaminim, ose të deklaroni se dëshironi të vazhdoni me aplikimin. Në të njëjtën kohë, ju mund të ftoheni për të depozituar një kundërpërgjigje ndaj të gjitha kundështive të ngritura nga opinioni kërkimor gjatë të njëjtës periudhë kohore.

Rr. 70, 70a
Rr. 137
Udhëz. C-II
Udhëz. A-VI, 2

Mospërputhje me kërkesat e unitetit

- 147.** Nëse sektori i kërimit konsideron se aplikimi nuk përputhet me kërkesat e unitetit të shpikjes (shiko pikën 69), ai harton një raport kërkitimi European për ato pjesë që kanë të bëjnë me shpikjen e përmendur fillimisht në pretendime. Sektori ju informon se nëse raporti i kërimit kërkohej për shpikje të tjera, ju duhet të paguani një tarifë kërkitimi për secilën prej tyre brenda një periudhe që e përcakton vetë.

Neni 82
Rr. 64
Udhëz. B-VII
Udhëz. F-V, 10

Nëse nuk i përgjigjeni kësaj ftese, dhe nëse sektori i ekzaminimit e gjykon kundërshtimin e sektorit të kërimit të justifikuar, konsiderohet apriori se dëshironi të vazhdoni procedurën e aplikimit në lidhje me shpikjen për të cilën është hartuar raporti i kërimit. Nëse paguani tarifa shtesë për kërkimin, raporti kërkimor European do të përpilohet për ato shpikje për të cilat janë paguar tarifa shtesë.

Aplikimi nuk duhet të përfshijë pretendime me objekte për të cilat nuk është paguar tarifë kërkitimi shtesë. Megjithatë, ju mund të depozitoni një aplikim të pjesshëm për këto objekte (shiko pikat 208-212).

Me kërkesën tuaj, çdo tarifë kërkitimi shtesë e paguar prej jush do t'ju kthehet nëse gjatë procedurës së ekzaminimit konstatohet se kërkesa për pagesë nga ana e sektorit të kërimit ka qenë e pajustifikuar.

Udhëz. B-VII,
1.2.1
Udhëz. C-III,
3.1-3.3

- 148.** Me hartimin e raportit të kërimit European, sektori i kërimit përcakton përmbajtjen përfundimtare të abstraktit dhe jua përcjell bashkë me raportin e kërimit

Rr. 66
Udhëz. B-X, 7
Udhëz. F-II,
2.1-2.6

III. Publikimi i aplikimit për patentë Europiane

- 149.** Aplikimi për patentë Europiane botohet pa vonesë sapo mbushen tetëmbëdhjetë muaj nga data e depozitimit ose data më e hershme e prioritetit. Megjithatë, mund të kërkonit që ajo të publikohet më herët.

Neni 93(1)
Udhëz. A-VI, 1

Publikimi përmban përshkrimin, pretendimet dhe skicat, të gjitha siç janë depozituar, plus abstraktin. Nëse raporti i kërimit European vihet në dispozicion në kohë, ai bashkëlidhet (botim A1); nëse jo, ai botohet veçmas (botim A3). Aplikimet për patentë Europiane që nuk janë depozituar në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht, publikohen në gjuhën e procedimit.

Rr. 68(1)
Udhëz. A-VI, 1.3
Udhëz. A-VI, 1.5

Në të gjitha aplikimet për patentë Europiane, raportet e kërkimit Europian dhe specifikimet e patentës Europiane publikohen vetëm në formë elektronike, në serverin e publikimeve të ZEP. Qasja në këtë server ofrohet nëpërmjet faqes së internetit të ZEP (www.epo.org).

Udhëz. A-VI,
1.4
GZ 2007,
Edicioni Special
Nr. 3, D.3

- 150.** Nëse ju ndryshoni pretendimet pas marrjes së raportit të kërkimit Europian por para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikim (shiko pikën 172), pretendimet e ndryshuara do të publikohen bashkë me pretendimet siç janë depozituar fillimisht. Përgatitjet teknike konsiderohen të përfunduara pesë javë para skadimit të periudhës 18-mujore pas datës së depozitimit, ose pas datës së prioritetit nëse pretendohet prioritet.

Rr. 68(4)
Udhëz. A-VI, 1.1,
1.3
GZ 2007, Edicioni
Special. 3, D.1

- 151.** Aplikimi për patentë Europiane nuk botohet nëse është refuzuar përfundimisht, nëse është tërhequr apo konsiderohet i tërhequr para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikim.

Rr. 67(2)
Udhëz. A-VI, 1.2

- 152.** ZEP informon për datën kur Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërkimit Europian, si dhe ju sjell në vëmendje periudhën e depozitimit të kërkesës për ekzaminim (pagimin e tarifës për ekzaminim), e cila fillon në atë datë (shiko pikën 146 dhe 155). ZEP gjithashtu ju informon se tarifat e përcaktimit paguhen brenda gjashtë muajve nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërkimit Europian dhe në të njëjtën periudhë aplikon pagesat për tarifat për shtrirje ose ekzaminim.

Rr. 69
Udhëz. A-VI, 2.1

- 153.** Për mbrojtjen e përkohshme që garanton aplikimi pas publikimit, shikoni paragrafin e tretë të pikës 5.

Neni 67

Çdo shtet kontraktues ku gjuha e procedimit nuk është gjuhë zyrtare mund të parashikojë që mbrojtja e përkohshme të hyjë në fuqi vetëm në momentin kur përkthimi i pretendimeve në njërën nga gjuhët zyrtare të tij sipas dëshirës suaj, ose në gjuhën specifike zyrtare që parashikon shteti në fjalë:

Neni 67(3)

(a) i ofrohet publikut në mënyrën e parashikuar nga ligji i brendshëm, ose

(b) i komunikohet personit që përdor shpikjen në atë Shtet.

Të gjitha shtetet kontraktuese për dhënien e mbrojtjes së përkohshme vënë si kusht përkthimin e pretendimeve. E njëjta gjë vlen edhe për shtetet joanëtare të KEP ku shtrihen efektet e patentës evropiane (shiko pikën 26). Për më shumë informacion, referojuni “Ligji kombëtar lidhur me KEP” (Tabela III).

- 154.** Pas botimit të aplikimit për patentë Europiane, dosjet që lidhen me të vihen në dispozicion për inspektim nëpërmjet Regjistrisë të Patentave Europiane ku mund të hyni përmes faqes së internetit të ZEP.

Neni 128(1)-(4)
Rr. 143, 144

Që nga ky moment, publiku ka qasje edhe në të dhënat bibliografike të aplikimit dhe në informacionin në lidhje me gjendjen e procedimeve nëpërmjet Regjistrisë të Patentave Europiane ku mund të hyni përmes faqes së internetit të ZEP (shiko Shtojcën VIII).

Neni. 127
Rr. 143
Udhëz. A-XI
GZ 2014, A86

Regjistri i Patentave Europiane gjithashtu lejon që ju të monitoroni aplikimin për përditësime të mundshme duke përdorur Shërbimin e Njoftimeve të Regjistrisë.

Informacion shtesë rreth formës në të cilën Aplikimet për patente dhe Patentat Europiane , janë publikuar dhe rreth publikimeve periodike te EPO, janë dhënë në Shtojcën VIII.

Neni 129

IV. Procedura e ekzaminimit

Kërkesa për ekzaminim

- 155.** Ju duhet të paraqitni kërkesën për ekzaminim brenda gjashtë muajsh nga data kur Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit Europian (shiko pikën 152). Kërkesa që duhet paraqitur me shkrim gjendet në formularin Kërkesë për Dhënie (shiko pikën 48), por duhet të depozitohet vetëm pasi të keni paguar tarifën e ekzaminimit. Ajo nuk mund të tërhiqet pas depozitimit.

Neni 94-98
Rr. 70-74
Udhëz. A-VI, 2.2
Udhëz. C-II, 1.1
Neni 2 No. 6
RFees

Nëse nuk depozitoni kërkesën për ekzaminim brenda afatit, aplikimi konsiderohet i tërhequr. Megjithatë, ekziston mundësia për të kërkuar përpunim të mëtejshëm. (shiko pikën 225).

Neni 94(2)
Udhëz. A-VI, 2.3
Udhëz. C-II, 1.1

- 156.** Ju gjithmonë keni mundësinë të paguani tarifën e ekzaminimit kur depozitoni aplikimin. Nuk keni asnjë disavantazh në këtë aspekt, pasi tarifa e ekzaminimit ju kthehet plotësisht nëse aplikimi tërhiqet, refuzohet ose konsiderohet i tërhequr para se sektorët e ekzaminimit të marrin përsipër përgjegjësinë, ose në masën 75% pas kësaj date, por para fillimit të ekzaminimit thelbësor.

Neni 11 Rr Tarifor
Udhëz. A-VI, 2.2,
2.5
Udhëz. C-II, 1.1
GZ 2013, 153

- 157.** Nëse depozitoni siç duhet kërkesën për ekzaminim para marrjes së raportit të kërimit Europian, Sektori i Pranimi në bazë të Rregullit 70(2) ju fton të tregoni brenda gjashtë muajve nga data kur Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit nëse dëshironi të vazhdoni më tej me aplikimin. Nëse nuk ktheni përgjigje brenda afatit, aplikimi konsiderohet i tërhequr.

Rr 70
Udhëz. A-VI, 2.3
Udhëz. C-II, 1.1

Në këtë rast është i mundur procedimi i mëtejshëm (shiko pikën 225).

- 158.** Për të shpejtuar procedurat, për shembull në formularin Kërkesë për Dhenie, ju mund të hiqni dorë nga e drejta për marrjen e ftesës për konfirmimin e kërkesës për ekzaminim. Në këtë rast, kur t'ju dërgohet raporti i kërimit, ju konsideroheni apriori se dëshironi të vazhdoni më tej me aplikimin, dhe më pas Sektori i Ekzaminimit merr përsipër përgjegjësinë e procedimit (shiko pikën 144 dhe Shtojcën II, datuar 30 Nentor 2015 Programi për ndjekjen e përshtatshme, pika 5).

Neni 18(1)
Rr. 70(2)
Udhëz. C-VI, 3
GZ 2015, A94

- 159.** Brenda afatit për depozitim ose konfirmimin e kërkesës për ekzaminim, ju do të ftoheni që të komentoni dhe të korrigjoni çdo mangësi të vërejtur në opinionin që shoqëron raportin e kërimit Europian, dhe të ndryshoni në mënyrë të përshtatshme përshtatshme, pretendimet dhe skicat. Nëse nuk i ktheni përgjigje ftesës në kohën e duhur, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr (për përpunim të mëtejshëm, shiko pikën 225).

Rr. 70a
Rr 137

Megjithatë, nuk do t'ju dërgohet asnjë ftesë në rast se nuk ka pasur ndonjë kundërshtim në opinionin shoqërues të raportit të kërimit Europian. Por ju do të viheni në dijeni menjëherë rreth mundësisë për të kryer ndryshime brenda një periudhë të caktuar (shiko pikën 172).

Fazat e procedurës

- 160.** Pas depozitimit të kërkesës për ekzaminim, mbi bazën e raportit të kërkimit dhe reagimit tuaj ndaj tij, ZEP ekzaminon nëse aplikimi dhe shpikja përkatëse përmbushin kërkesat e Konventës, dhe në veçanti nëse shpikja është e patentueshme (shiko pikat 27-37).
- Pas marrjes së raportit të kërkimit dhe para komunikimit të parë të ekzaminuesit, ju duhet të depozitoni vërejtje thelbësore për çdo kundërshtim të ngritur në raportin e kërkimit; ju gjithashtu mund të ndryshoni përshkrimin, pretendimet dhe skicat (shiko pikën 159 dhe 172).
- 161.** Nëse ekzaminuesi përgjigjës ka kundërshtime për aplikimin, ai ju dërgon një komunikim të parë të argumentuar ku ju fton të paraqitni vërejtjet dhe, nëse nevojitet, të dorëzoni ndryshimet që i duhen bërë përshkrimit, pretendimeve dhe skicave (shiko pikat 171-176).
- Nëse nuk i përgjigjeni në kohë komunikimit të parë apo komunikimeve pasuese, aplikimi konsiderohet i tërhequr (por shiko pikën 225).
- Nëse veprimet tuaja tregojnë qartë se jeni i interesuar për një ekzaminim thelbësor të përshpejtuar, ekzaminuesi do të bëjë çdo përpjekje për të realizuar komunikimin e parë brenda tre muajve nga momenti kur sektori i ekzaminimit pranon aplikimin apo kërkesën për ekzaminim të përshpejtuar (shiko Shtojcën II Njoftim nga ZEP i datuar 30 Nentor 2015 lidhur me programin për ekzaminim të përshpejtuar të aplikimit për patentë Europiane).
- Ju gjithashtu mund të ftoheni për të dhënë informacione mbi arritjet e mëparshme që merren parasysh gjatë ekzaminimit të aplikimeve kombëtare apo rajonale për patentë, si edhe në lidhje me shpikjen me të cilën ka të bëjë aplikimi për patentë Europiane. Nëse ju nuk e jepni këtë informacion brenda një afati të caktuar, aplikimi konsiderohet i tërhequr (por shiko pikën 225). Rekomandohet të dorëzoni sa më shpejt rezultatet e kërkimit lidhur me një aplikim të mëparshëm për të cilin pretendohet prioritet (shiko pikën 54).
- 162.** Ju duhet të trajtoni të gjitha kundërshtimet e ekzaminuesit. Parimi bazë i procedurës së ekzaminimit është që vendimi për dhënien e patentës apo refuzimi i aplikimit të arrihet me sa më pak hapa.
- Nëse pas ekzaminimit të përgjigjes tuaj, ekzaminuesi konstaton se aplikimi ende nuk është i patentueshëm, ai do të vazhdojë procedurën e ekzaminimit nëpërmjet komunikimit të mëtejshëm me ju me shkrim, me gojë apo telefon.
- Ju mund të kërkonti në çdo kohë procedim gojor.
- 163.** Ekzaminuesi mund të kërkojë këshilla nga anëtarët e tjerë të sektorit të ekzaminimit sa herë që e sheh të arsyeshme. Në fund, kur duhet të merret vendimi, ai ua referon aplikimin atyre.
- Nëse sektori i ekzaminimit është i mendimit se patenta Europiane nuk mund të jepet, atëherë e refuzon aplikimin. Vendimi merret nga sektori i ekzaminimit në tërësi dhe duhet të deklarohen arsyet e refuzimit. Refuzimet duhet të bazohen vetëm mbi çështje për të cilat ju është dhënë mundësia të jepni komentet tuaja.

Neni 94(1)
Udhëz. C-II

Rr. 70a, 137(2), (3)
Udhëz. C-III 2

Rr. 71(1), 137(3)
Udhëz. C-IV, 3,
C-V, 14
Udhëz. C-II dhe
C-III
Udhëz. E-I, H-III

Neni 94(4)

GZ 2015, A93

Neni 124(2)
Rr. 141
Udhëz. C-III, 5

Udhëz. C-V, 1

Udhëz C-IV
Udhëz. C-VII

Neni 116
Udhëz. E-II

Udhëz. C-IV, 4
Udhëz. C-VIII

Neni. 97(2)
Udhëz. C-V,
14,
C-VIII, 6
Neni 113(1)

- 164.** Nëse aplikimi dhe shpikja përkatëse përmbushin kërkesat e Konventës, sektori i ekzaminimit vendos për dhënien e patentës Europiane, me kusht që tarifat e kërkuara të jenë paguar brenda afatit si dhe përkthimi i pretendimeve në dy gjuhët e tjera zyrtare të ZEP të jenë dorëzuar në kohën e duhur.
- Neni 97(1)
Rr. 71(3)-(7)
Udhëz. C-V*
- 165.** Sektori i ekzaminimit ju informon për tekstin në bazë të të cilit mendon ta jape patentën Europiane dhe ju fton të paguani tarifën për dhënien e patentës dhe publikimin, si edhe tarifat për çdo pretendim mbi limitin e prej 15 pretendimesh, si dhe ju kërkon që brenda afatit të pashtyeshëm prej 4 muajsh të dorëzoni përkthimin e pretendimeve në dy gjuhë zyrtare të ZEP të ndryshme nga gjuha e procedimit. Në këtë fazë ju rekomandojmë të kontrolloni të dhënat bibliografike.
- Neni 97
Rr. 71(3)
Udhëz. C-V, 1, 3*
- Nëse paguani tarifat përkatëse dhe depozitoni përkthimet e nevojshme të pretendimeve brenda afatit, ju konsideroheni se keni miratuar tekstin e caktuar për dhënien e patentës. Nëse ju nuk depozitoni përkthimet dhe/ose nuk paguani tarifat për dhënien dhe publikimin dhe/ose tarifat për pretendimet, atëherë aplikimi konsiderohet i tërhequr (por shiko pikën 225). Në këtë fazë ju rekomandojmë të kontrolloni të dhënat bibliografike.
- Rr. 71(3), (7)*
- 166.** Pas rishikimit të tekstit të propozuar për dhënien e patentës, ju mund të dëshironi të bëni ndryshime të vogla dhe/ose mund të zbuloni gabime. Në këtë rast ju keni mundësinë të depozitoni ndryshime apo korrigjime brenda afatit të caktuar nga Rregulli 71(3) (shiko pikën 165). Nëse sektori i ekzaminimit jep pëlqimin për ndryshimet apo korrigjimet do të lëshoj një komunikim sipas Rregulli 71(3). Ai mund të procedojë me dhënien e patentës, me kusht që të keni depozituar përkthimet e pretendimeve dhe të keni paguar tarifat për dhënien e patentës dhe publikimin brenda afatit të përcaktuar. Nëse depozitoni ndryshimet apo korrigjimet dhe përkthimet e pretendimeve brenda afatit, por nuk paguani tarifat apo nuk depozitoni përkthimin, aplikimi konsiderohet i tërhequr (por shiko pikën 225).
- Rr. 71(4), 137(3), 139
Udhëz. H-II
Udhëz. C-V, 4
GZ 2010, 637
GZ 2012, 52
GZ 2015, A52
Udhëz. C-V, 4.11*
- 167.** Nëse sektori i ekzaminimit nuk i pranon ndryshimet ose korrigjimet e bëra ai do të vazhdojë me procedurat normale të ekzaminimit. Në varësi të rrethanave për çdo rast individualisht sektori i ekzaminimit mund të lëshojë një komunikim sipas Nentir 94 (3) dhe Rregulli 71(1),(2) për t'ju thërritur juve në një procedurë orale ose të refuzojë aplikimin.
- Rr. 71(6)
Udhëz. C-V, 4,
H-II*
- 168.** Nëse nuk trajtoni siç duhet kundërshtimet e ngritura, sektori i ekzaminimit do ta refuzojë aplikimin në bazë të nenit 97(2), sepse nuk i plotëson kërkesat e Konventës. Nëse ju nuk keni paguar tarifat e publikimit dhe dhënies atëherë aplikimi do të quhet i tërhequr (por shiko pikën 225). Tarifat e paguara për dhënien e patentës dhe publikimin si dhe për pretendimet, do t'ju kthehen nëse patentat nuk ju jepet.
- Neni 97(1)
Rr. 71
GZ 2012, 52*
- Para se patentat të mund të jepet, ju duhet gjithashtu të paguani çdo tarifë rinovimi dhe tarifa shtesë (shiko pikën 213 e në vijim). Ju do të viheni në dijeni nëse një tarifë rinovimi i bie të paguhet përpara datës së parashikuar të publikimit që përmend dhënien e patentës Europiane. Publikimi që përmend dhënien e patentës bëhet vetëm pasi të paguani tarifën e rinovimit. Nëse nuk paguani tarifën e rinovimit dhe çdo tarifë shtesë në kohën e duhur, aplikimi konsiderohet i tërhequr.
- Neni 121
Rr. 135
Udhëz. C-V, 8-9*
- 169.** Nëse ju e shkelni afatin e caktuar nga Rregulli 71, ju mund të kërkonit përpunim të mëtejshëm në bazë të nenit 121 (shiko pikën 225).

- 170.** Dhënia e patentës i fiton efektet që nga data kur përmendet në Buletinin e Patentave Europiane. Në të njëjtën kohë që Buletini publikon këtë përmendje, ZEP publikon një specifikim të patentës Europiane që përmban përshkrimin, pretendimet dhe skicat. Buletini i Patentave Europiane publikohet në mënyrë elektronike në serverin e publikimit të ZEP (www.epo.org). *Neni 97(3), 98
Udhëz. C-V, 10-13*
- Çertifikata për patentë Europiane me specifikimin bashkangjitur, lëshohet sipas kërkesës. Kopje të noterizuara të çertifikatës së bashku me anekset përkatëse do të lëshohen sipas kërkesës nga mbajtësi i patentës pas pagesës së kostove administrative. *Rr. 74
GZ 2013, 418*
- Ndryshimi i aplikimeve para dhe gjatë procedurës së ekzaminimit**
- 171.** Nuk lejohet të ndryshoni përshkrimin, pretendimet ose skicat para se të merrni raportin e kërimit Europian. Ju gjithmonë duhet të tregoni çdo ndryshim të bërë dhe të identifikoni bazën e tyre në aplikimin e depozituar. *Rr. 137(1)
Udhëz. A-V, 2
Udhëz. H-IV, 2.1, 3
Udhëz. H-II, H-III*
- 172.** Brenda afatit kohor të kërkesës për ekzaminim ose konfirmimit të kësaj kërkesë (dmth. kur i përgjigjeni ftesës për komentim mbi kundërshtimet e ngritura në opinionin e kërimit), ju mund të ndryshoni sipas dëshirës suaj përshkrimin, pretendimet dhe skicat (shiko pika 150, 159, 160 dhe 175). *Rr. 137(2)
Udhëz. C-II, 3.1,
C-III, 2*
- 173.** Asnjë ndryshim i mëtejshëm nuk mund të bëhet pa pëlqimin e sektorit të ekzaminimit. Pretendimet e ndryshuara nuk mund t'i referohen objektit të pakërkuar që nuk lidhet me shpikjen e pretenduar fillimisht për të formuar një koncept të vetëm të përgjithshëm shpikës. Kur fshini pjesë të objektit nga aplikimi, ju duhet të shmangni pohimet që mund të interpretohen si braktisje e objektit. Përndryshe, objekti nuk mund të rivendoset. *Rr. 137(3), (5)
Udhëz. C-IV, 6
Udhëz. H-II
Udhëz. H-IV, 2.1, 4.2*
- 174.** Udhëzimet sigurojnë informacion në lidhje me kufizimet që aplikohen për ndryshimet që mund t'i bëni përshkrimit, pretendimeve dhe skicave pas marrjes së komunikimit sipas Rregullit 71(3). Pasi merrni tekstin që ju komunikohet sipas Rregullit 71(3) (duke përfshirë ndryshime dhe/ose korrigjime të vogla të gabimeve, shiko pikën 165), ju mund të bëni ndryshime të mëtejshme vetëm nëse e lejon sektori i ekzaminimit sepse kjo fuqi i është dhënë nga Rregulli 137(3). *Rr. 137(3)
Udhëz. C-V, 4-5
Udhëz. H-II, 2.5, 2.6
GZ 2010, 637*
- 175.** Është absolutisht e ndaluar që të ndryshoni aplikimin duke shtuar një objekt që shkon përtej përmbajtjes së aplikimit siç është depozituar (që nuk përfshin dokumentin e prioritetit). Megjithatë, shembujt e depozituar më pas ose deklaratat për avantazhet mund të konsiderohen nga ekzaminuesi si dëshmi në mbështetje të patentueshmërisë së shpikjes. *Neni 123(2)
Udhëz. F-II, 4.3
Udhëz. H-IV, 2.1, 2.2*
- Ky informacion teknik përgjithësisht i shtohet dosjes që është e hapur për inspektim publik (shiko pikën 154). Nga data kur shtohet, informacioni bëhet pjesë e arritjeve të mëparshme në kuptim të nenit 54(2) (shiko pikën 32). Një shënim publikohet në faqen e parë të specifikimit të patentës për të njoftuar publikun se informacioni i dorëzuar pas depozitimit të aplikimit nuk është përfshirë në këtë specifikim (shiko pikën 170). *Udhëz. H-V, 2.3*

176. Ndryshimet në aplikimin për patentë Europiane bëhen në një nga mënyrat e mëposhtme:

Udhëz. H-III

- (a) Duke depozituar faqet zëvendësuese. Këtë metodë duhet ta përdorni vetëm nëse ndryshimet janë të gjera dhe të ndërlikuara. Nëse nuk është menjëherë e qartë se si apo pse duhet të bëhen ndryshimet, duhet të vini shënime shpjeguese në anë të faqeve zëvendësuese ose në fletë të veçanta. Ju duhet të respektoni dispozitat që rregullojnë prezantimin e dokumenteve të aplikimit (shiko pikën 70).
- (b) Duke shënuar kopjen e faqes(eve) përkatëse të aplikimit. Preferohet kjo metodë kur ndryshimet nuk janë të gjera, sepse kështu thjeshton kontrollin. Ndryshimet mund të jenë me shkrim dore ose të shtypura; ndryshimet me shkrim dore duhet të jenë qartësisht të lexueshme në mënyrë që të shmangen gabimet në shtypje. Korrigjimet duhet të evidentohen nëpërmjet funksioneve të programit të përdorur për shkrimin e tekstit për të treguar saktësisht fshirjet apo shtesat në tekst. Si alternativë, formulari i është një format i pranueshëm për kushtet e Rregulli 137 (4), duke patur si kusht që kopjet e pastra të dorëzuara të mos kenë shënime me shkrim dore.
- (c) Duke treguar ndryshimet në një letër. Kjo metodë preferohet nëse, për shembull, do të fshini faqe të tëra, paragrafë ose skica.

Rr. 49(8)
GZ 2013, 603

Kërkesat kombëtare për përkthimet e patentave Europiane

177. Çdo shtet kontraktues mund të bëjë mbrojtjen e parashikuar për patentën Europiane të dhënë (ose e ndryshuar ose e kufizuar), në një gjuhë që nuk është një nga gjuhët zyrtare të tij, kur paraqisni përkthimin në një nga gjuhët zyrtare të tij ose në gjuhën e preferuar zyrtare. Shteti në fjalë mund të kërkojë që të përballoni plotësisht ose pjesërisht shpenzimet e botimit të përkthimit. E njëjta gjë vlen edhe për shtetet joanëtare të KEP për shtrirjen e mbrojtjes.

Neni 65

Për më shumë detaje referohuni “Ligjit kombëtar lidhur me KEP” (Tabela IV) dhe pikat kryesore të **“Marrëveshjes së Londrës”** faqes së internetit të ZEP: <http://www.epo.org/law-practice/legal-texts/londonagreement.html>.

Neni 65(3)

Sigurohuni që të respektoni, veçanërisht afatet e depozitimit të përkthimeve, në mënyrë që të mos cenohet mbrojtja që jep patenta në shtete kontraktuese të përcaktuara.

Neni 99-105
Rr. 75-89
Udhëz. D
GZ 2001, 148

V. Procedura e kundërshtimit

Periudha e kundërshtimit

178. Brenda nëntë muajve nga publikimi i përmendjes së dhënies së patentës Europiane, çdo person mund të njoftojë Zyrën Europiane të Patentave për kundërshtimin e asaj patente, përveç zotëruesit, i cili nuk lejohet të kundërshtojë patentën e tij.

Neni. 99
GZ 1994, 891

Njoftimi i kundërshtimit konsiderohet i depozituar në momentin kur paguhet tarifa e kundërshtimit.

179. Kundërshtimi mund të paraqitet mbi këto bazat e mëposhtme:

- objekti i patentës Europiane nuk është i patentueshëm sipas neneve 52-57
- patenta Europiane nuk e deklaron shpikjen qartë dhe në masën e mjaftueshme që të zbatohet nga një specialist i fushës
- objekti i patentës Europiane e tejkalon përmbajtjen e aplikimit të depozituar.

Forma dhe përmbajtja e njoftimit të kundërshtimit

180. Njoftimi i kundërshtimit duhet të depozitohet në një kopje të vetme brenda afatit të kundërshtimit në një deklaratë të argumentuar. Kjo do të thotë se pala kundërshtuese duhet të paktën të paraqesë një bazë për kundërshtimin në bazë të nenit 100 dhe të tregojë faktet, provat dhe argumentet e paraqitura në mbështetje të bazave. Përndryshe, njoftimi i kundërshtimit refuzohet si i papranueshëm. Rekomandoheni të përdorni formularin e kundërshtimit të ZEP (Formulari 2300) që ju siguron të gjithë informacionin e nevojshëm që kundërshtimi të jetë i pranueshëm. Këtë formular e merrni falas nga ZEP ose zyrat qendrore të pronësisë industriale të shteteve kontraktuese, si dhe nëpërmjet faqes së internetit ZEP (www.epo.org).

Neni 99(1)
Rr. 76
Udhëz. D-III, 3
Udhëz. D-III, 6

Njoftim i kundërshtimit mund të depozitohet me faks ose në mënyrë elektronike nga softueri i depozitimit *online* CMS (shiko pikat 123-128).

Rr. 2
Udhëz. D-III, 3.2
GZ 2015, A91OJ
2014, A97, A98

Ekzaminimi i pranueshmërisë së njoftimit të kundërshtimit

181. Menjëherë pas merr njoftimin e kundërshtimit, ZEP ia komunikon zotëruesit dhe verifikon nëse është e pranueshme. Mangësitë e njoftimit i komunikohen palës kundërshtuese. Mangësitë që parashikon Rregulli 77(1) duhet të korrigjohen brenda periudhës së kundërshtimit. Mangësitë e tjera të korrigjueshme duhet të ndreqen brenda një afati që cakton ZEP (zakonisht dy muaj). Nëse mangësitë nuk ndreqen në afat, njoftimin i kundërshtimit refuzohet si i papranueshëm.

Rr. 77
Udhëz. D-IV, 1.2

Dokumentet e cituara në mbështetje të kundërshtimit apo si prova, duhet të dorëzohen bashkë me njoftimin e kundërshtimit. Nëse kjo nuk bëhet, Zyra fton palë kundërshtuese t'i depozitojë brenda afatit që ajo specifikon (zakonisht dy muaj). Nëse kjo pale e shkel afatin, sektori i kundërshtimit mund të vendosë të mos marrë parasysh argumentet që bazohen në këto dokumente.

Rr. 83
Udhëz. D-IV, 1.2.2.1

182. Sapo skadon afati i kundërshtimit apo afatit të caktuar për korrigjimin e mangësive apo paraqitjen e provave, zotëruesi i patentës ftohet të paraqesë vërejtjet dhe, kur është e përshtatshme, ndryshimet brenda një afati të caktuar nga ZEP (zakonisht katër muaj). Ndryshimet lejohen vetëm nëse burojnë nga baza për kundërshtim sipas nenit 100, përfshi bazat që nuk kërkohen nga pala kundërshtuese.

Rr. 79
Udhëz. D-IV, 5.2
Rr. 80
Udhëz. D-IV, 5.3

Ekzaminimi thelbësor i kundërshtimit

- 183.** Pas këtyre hapave paraprakë, sektori i kundërshtimit ekzaminon nëse bazat e kundërshtimit çenojnë mbajtjen e patentës Europiane. Nëse është e nevojshme, fton palët të depozitojnë vërejtjet në komunikimet e tij ose të palëve të tjera “brenda një afati të caktuar nga sektori.
- Pasi merr komunikimin në adrese të tij, zotëruesi mund të dorëzojë përshkrimin, pretendimet dhe skicat në formë të ndryshuar kur është e nevojshme. Ndryshimet e propozuara që depozitohen me vonesë, mund të mos merren parasysh.
- Nëse duhen organizuar procedime gojore me kërkesë të njëjës apo me nismë të ZEP kur e gjykon të nevojshme, thirrjet dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Në një shënim bashkëlidhur thirrjeve, sektori i kundërshtimit rendit dhe shpjegon pikat që sipas tij duhet të diskutohen në funksion të vendimit që duhet të marrë. Zakonisht shënimi përfshin edhe opinionin e përkohshëm dhe jodetyrues të sektorit të kundërshtimit mbi qëndrimet e palëve, dhe në veçanti edhe ndryshimet në patentën e depozituar nga zotëruesi i saj. Në të njëjtën kohë, sektori i kundërshtimit cakton një datë përfundimtare për depozitimin e materialeve me shkrim apo ndryshimeve në përgatitje të procedurave gojore. Faktet dhe provat e reja të paraqitura pas kësaj date mund të mos merren parasysh, përveç rasteve kur pranohen me argumentimin se ka ndryshuar objektin e procedimit.
- 184.** Nëse sektori i kundërshtimit konstaton se bazat e kundërshtimit çenojnë mbajtjen e patentës Europiane, revokon patentën. Nëse konstaton se bazat e kundërshtimit nuk çenojnë mbajtjen e patentës Europiane të dhënë, atëherë e rrëzon kundërshtimin.
- 185.** Nëse sektori i kundërshtimit konstaton se patenta mund të mbahet në formën e ndryshuar, ai jep një vendim të ndërmjetëm që pohon se me ndryshimet e bëra nga zotëruesi, patenta dhe shpikja së cilës ajo i përket plotësojnë kërkesat e KEP. Ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm lejohet depozitimi i një ankimi.
- 186.** Kur vendimi i ndërmjetëm sipas pikës 185 bëhet përfundimtar, zotëruesit i jepet tre muaj afat që të paguajë tarifën për publikimin e një specifikimi të ri dhe për depozitimin e përkthimit të çdo pretendimi të ndryshuar në dy gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha e procedimit.
- Që nga 1 Maj 2016, zotëruesi do të ketë mundësinë e depozitimit të korrigjimeve me shkrim gjatë procedimeve gojore. Në këtë rast ai do të ftohet të depozitojë tekstin e korrigjuar në formularin sipas Rrehulli 49(8) brenda afatit të sipër përmendur prej tre muajsh.
- 187.** Nëse këto veprime nuk kryhen në afat, ato mund të kryhen brenda dy muajve nga njoftimi i komunikimit për mosrespektimin e afatit kohor, me kusht që të paguhet një tarifë shtesë për këtë periudhë. Nëse ndonjë nga veprimet nuk kryhet brenda kësaj periudhe, patenta revokohet.

Neni 101
Rr. 81
Udhëz. D-V, VI

Rr. 81(3)
Udhëz. D-VI, 4.2
Udhëz. H-III
Udhëz. E-VII, 1.2

Neni 116(1)
Rr. 115
Udhëz. D-VI, 1

Rr. 116
Udhëz. D-VI, 3.2
Udhëz. E-II, 8.6

Neni. 101
Rr. 81
Udhëz. D-VIII

Neni 101(3)(a)
Rr. 49, 82
Udhëz. D-VI,
7.2
GZ 2013, 603

Rr. 82(2)
Udhëz. D-VI,
7.2.3

Rr. 82(2)
GZ EPO 2015,
A82

Rr. 82(3)
Neni 101(3)

- 188.** Për tekstin e ndryshuar, shtetet kontraktuese aplikojnë të njëjtat kërkesa për përkthimin ashtu si për specifikimin e patentës (shiko pikën 177 dhe Shtojcën V).

Neni 65

VI. Procedura e kufizimit dhe revokimit

- 189.** Si pronar patente ju mund të kërkonti revokimin ose kufizimin e patentës tuaj. Ju mund të depozitoni kërkesën në çdo kohë pas dhënies, pas procedurës së kundërshtimit apo edhe pas skadimit të patentës. Por, kërkesa për revokim ose kufizim e depozituar kur procedura e kundërshtimit në lidhje me patentën Europiane është në vijim, konsiderohet e padepozituar, pasi procedura e kundërshtimit ka përparësi. Nëse kundërshtimi depozitohet ndërkohë që procedura për kufizim është në vijim, atëherë mbyllet procedura e kufizimit dhe kthehet tarifa e kufizimit. Si pasojë, procedimet e Nenit 105a do të ndalohen. Nëse ka një kërkesë për refuzim është në vijim në momentin e dorëzimit të kthimit të përgjigjes, procedura e revokimit do të vazhdojë për arsye të efikasitetit procedural. Nëse procedurat e kufizimit janë në vijim në kohën e kthimit të përgjigjes atëherë procedurat e kufizimit ndalohen dhe tarifa rimbursohet. Procedurat e kundërshtimit do të vazhdojnë.

Neni 105a-105c
Rr. 90-96

Neni 105a(2)
Rr. 93
Udhëz. D-X, 2.1.

- 190.** Kërkesat duhet të depozitohen direkt te ZEP. Rregullat e zbatueshme janë dispozitat e përgjithshme për depozitimin e aplikimit për patentë Europiane (shiko Rregullat 35 e në vijim) dhe për nevojën e përfaqësimit profesional për zotëruesit jorezidentë të saj (shiko pikat 58-59). Për më tepër, kërkesa konsiderohet e depozituar vetëm kur paguhet tarifa për kufizim apo revokim.

Neni. 105a(1)
Rr. 35 ff
Neni. 2 Nr. 10a
Rr Tarifore

- 191.** Objekti i procedurës së kufizimit ose revokimit është patenta Europiane e dhënë ose ndryshuar në procedimin e kundërshtimit ose (më herët) kufizimit. Meqë kufizimi aktivizohet nga ndryshimi i pretendimeve, kërkesa duhet të përmbajë të gjitha pretendimet e ndryshuara (dhe përshkrimin dhe skicat nëse nevojitet). Nëse nuk zbatohen këto kërkesa apo kërkesat e përgjithshme për gjuhët dhe përfaqësimin (shiko pikat 42-45 dhe 58-66), Zyra ju fton të korrigjoni mangësitë brenda një periudhe që caktohet prej saj, zakonisht prej dy muajsh. Nëse nuk korrigjoni mangësitë brenda këtij afati, kërkesa refuzohet si e papranueshme. Megjithatë, ekziston mundësia e rifitimit të të drejtave. Vendimi për refuzimin e kërkesës është i ankimueshëm.

Rr. 90
Rr. 92(2)
Rr. 94
Udhëz. D-X, 2
Neni 122

- 192.** Nëse kërkesa është për **revokim** dhe e pranueshme, atëherë sektori i ekzaminat revokon patentën dhe ia komunikon këtë kërkuar.

Neni 105b(2)
Rr. 95(1)
Udhëz. D-X, 3
Neni 105b(3)

Vendimi hyn në fuqi në datën e publikimit në Buletinin e Patentave Europiane.

Kjo vlen *ab initio* për të gjitha shtetet kontraktuese për të cilat është dhënë patenta. Është e pamundur që patenta të revokohet për disa shtete kontraktuese dhe jo për të tjerët.

Neni 64
Neni 67

- 193.** Nëse kërkesa për **kufizim** është e pranueshme, sektori i ekzaminat procedon me ekzaminimin e kërkesës. Bazë për ekzaminin është patenta e dhënë ose e ndryshuar në procedurat e kundërshtimit apo kufizimit. Kur janë bërë si procedura e kundërshtimit ashtu dhe ajo e kufizimit, baza për ekzaminimin është patenta e ndryshuar nga procedura më e fundit. Sektori i ekzaminimit ekzaminon vetëm nëse pretendimet e ndryshuara përbëjnë

Rr. 90
Neni 84
Neni 123(2), (3)
Udhëz. D-X, 4

një kufizim në lidhje me pretendimet e dhëna ose të ndryshuara dhe nëse ato janë të qarta, të prera dhe të mbështetura nga përshkrimi, por nuk përmbajnë objekt që shtrihet përtej aplikimit të depozituar.

- 194.** Termi kufizim' nënkupton një reduktim në sferën e mbrojtjes së pretendimeve. Sqarimet apo ndryshimet e bëra thjesht për të mbrojtur çështje të ndryshme nuk konsiderohen kufizime. Nëse ka mangësi, ju ftoheni t'i korrigjoni brenda një afati zakonisht prej dy muajsh.

Neni 105b(1)
Rr. 95
Rr. 132(2)
Udhëz. D-X, 4.3- 5

- 195.** Nëse kërkesa për kufizimin është e lejueshme, ju viheni në dijeni dhe ftoheni të paguani tarifën përkatëse për specifikimin e ndryshuar dhe të depozitoni përkthimin e pretendimeve të ndryshuara në dy gjuhët e tjera zyrtare në një afat prej tre muajsh. Nëse është e nevojshme, përshkrimi dhe skicat duhet të përkthehen gjithashtu. Nëse këto veprime nuk bëhen në kohën e duhur ato mund të procedohen normalisht deri në dy muaj pas njoftimit i cili specifikon mos rrespektimin e afatit, duke konsideruar faktin që një që duhet paguar një tarifë shtesë brenda këtij afati.

Neni 105b(2)
Rr. 95(3), (4)
Rr. 82(3)
Neni. 2, No. 8 Rr
Tarifore
Udhëz. D-X, 5
Neni. 105c
Rr. 96, 74

Procedura në këtë rast është e njëjtë si procedura e kundërshtimit. Nëse paguani tarifat dhe depozitoni përkthimet në kohën e duhur, atëherë sektori i ekzaminimit e kufizon patentën. Nëse jo, kërkesa refuzohet. Specifikimi i patentës Europiane i kufizuar publikohet dhe ju lëshohet një çertifikatë e re.

- 196.** Vendimi për të kufizuar patentën Europiane hyn në fuqi në datën në të cilën është botuar në Buletin. Efekti i saj është të kufizojë patentën (ab initio) që nga fillimi.

Neni 105b(3)
Neni 68
Neni 21(3)(a)

VII. Procedura e ankimit

Neni 106-112
Rr. 99-103
Udhëz. E-X

Depozitimi i ankimit

- 197.** Ankim mund të bëhet kundër vendimeve të Sektorit të Pranimit, sektorit të ekzaminimit, sektorit të kundërshtimit dhe Drejtorisë Juridike. Ankimi ka efekt pezullues, që do të thotë se vendimi i kontestuar nuk është ende përfundimtar (*res judicata* jo formale) dhe efektet e tij pezullohen.
- 198.** Njoftimi i ankimit duhet të dorëzohet në formë të shkruar brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit të kontestuar. Ai konsiderohet i depozituar vetëm kur paguhet tarifa e ankimit. Brenda katër muajve nga njoftimi i vendimit, depozitohet një deklaratë me shkrim që pohon bazat e ankimit. Afatet kohore të mësipërme nuk mund të zgjaten. Përpunimi i mëtejshëm në bazë të nenit 121 nuk lejohet.
- 199.** Njoftimi i ankimit dhe pohimi i bazave të ankimit mund të depozitohen me fax, apo në mënyrë elektronike duke përdorur softuerin për depozitimin *online CMS*. Në të ardhmen, do të egzistojë mundësia që kjo të bëhet nëpërmjet shërbimit të dorëzimit online të formularit. Si rregull, Zyra e Regjistrimit e bordeve të ankimit kërkon konfirmim me shkrim vetëm nëse cilësia e dokumentit të depozituar është e mangët. Një nënshkrim elektronik mund të ketë formën e një faksimile, një përbërje numerike ose një nënshkrim elektronik (shiko pikën 125).

Neni. 106

Neni 108
Rr. 126
Neni 2, No. 11 Rr
Tarifore
Rr. 2

GZ 2003, 419
GZ 2015, A91
GZ 2014, A97,
A98

200. Njoftimi i ankimit duhet të përmbajë:

*Neni 107
Rr. 99, 100
Rr. 41(2)(c)*

- (a) emrin dhe adresën e ankimuesit
- (b) një tregues të vendimit të ankimuar, dhe
- (c) një kërkesë që përcakton objektin e ankimit.

201. Në deklaratën e bazave të ankimit, ankimuesi tregon arsyet pse vendimi duhet të anulohet, ose masën në të cilën duhet të ndryshohet. Po kështu, duhet të paraqiten faktet dhe provat mbi të cilat bazohet ankimi. Të gjitha argumentet duhet të paraqiten me shkrim dhe jo të ruhen për procedimin e mundshëm gojor.

Regjistri i jep çdo ankimi një numër reference që i duhet të përdoret përgjatë të gjithë procedurës së ankimit.

Rishikimi i ndërmjetëm

202. Nëse një departament vendimi i të cilit kundërshtohet, gjykon se ankimi është i pranueshëm dhe i argumentuar, duhet të korrigjojë vendimin e vet brenda tre muajve nga marrja e deklaratës së bazave të ankimit. Nëse ankimi nuk është i lejuar brenda kësaj periudhe, duhet të kthehet pa vonesë te bordi i ankimit.

*Neni 109
Udhëz. E-X, 7*

Rishikimi i ndërmjetëm nuk lejohet kur ankimuesi kundërshtohet nga një palë tjetër në procedurë (sidomos në procedurat e kundërshtimit).

Fazat e procedimit para bordeve të ankimit

203. Bordet vendosin për ankimet në fazën e dytë ose finale. Antarës e tyre janë të pavarur. Ata nuk varen tek asnjë rekomandim për vendimet që marrin, dhe ata duhet të vendosin vetëm në bazë të KEP. Procedurat përpara bordeve janë të specifikuar tek Rregullat dhe Procedurat, e publikuar në Buletinin Zyrtar.

*Neni 23(3)
Publikim
Suplementarm 1,
GZ 2016*

Bordet teknike të ankimit janë përgjegjës për ankimet kundër vendimeve të sektorëve të ekzaminimit lidhur me refuzimin e aplikimeve për patentë Europiane ose me dhënien e patentave Europiane, si dhe për ankimet kundër vendimeve të sektorëve të kundërshtimit.

Neni 21(3)(a), (4)

Bordet teknike normalisht përbëhen nga tre anëtarë (dy anëtarë të kualifikuar teknikë, një anëtar i kualifikuar ligjor). Ky numër rritet në pesë (tre anëtarë të kualifikuar teknikë dhe dy anëtarë të kualifikuar ligjorë) nëse një anëtar i kualifikuar ligjor është shtuar në departamentin e shkallës së parë, apo nëse bordi e gjykon të nevojshme nga natyra e ankimit (përbërje e zgjeruar - neni 21 (3) (a) dhe (b)).

Neni 21(3)(a), (b)

Kur bordet teknike të ankimit nuk kanë kompetencë procedimi - veçanërisht në rastin e ankimeve kundër vendimeve të Sektorit të Pranimi ose të Drejtorisë Juridike - këto procedime trajtohen nga një bord ligjor ankimi i përbërë nga tre anëtarë të kualifikuar ligjorë.

Neni 21(3)(c)

204. Për të siguruar zbatimin uniform të ligjit ose nëse ngrihet një çështje e rëndësishme e ligjit, ankimet mund të bëhen te Bordi i Zgjeruar i Ankimit. Gjatë procedimit të një çështje, ose me kërkesën e vet, apo nga kërkesa e një pale, një bord ankimi mund të referojë çdo çështje të Bordit i Zgjeruar

*Neni 22
Neni 112
GZ 2007, 303*

i Ankimit nëse gjykon se kërkohet një vendim për qëllimet e mësipërme. Vendimi i Bordit të Zgjeruar është detyrues për bordin e ankimit. Kryetari i ZEP mund t'ia referojë një çështje ligjore Bordit të Zgjeruar nëse dy borde të ankimit kanë dhënë vendime të ndryshme për një çështje.

- 205.** Dispozitat lidhur me procedimet para departamentit të cilit i është ankimuar vendimi, janë në thelb të zbatueshme *mutatis mutandis* për procedurën e ankimit dhe të kërkesës për rishikim. Në ekzaminimin e ankimit, bordi i ankimit fton palët të depozitojnë brenda një periudhe të caktuar vërejtjet ndaj komunikimeve që bordi ka nxjerrë vetë ose të nxjerra nga një palë tjetër.

Neni 110
Rr. 100

Procedimet gojore mund të mbahen me kërkesën e një pale ose kryesisht nga ZEP.

Neni 116

- 206.** Për të vendosur mbi ankimin, bordi ose mund të ushtrojë çdo pushtet brenda kompetencave të departamentit të cilit i është ankimuar vendimi, ose e kthen çështjen te ky departament për ndjekje të mëtejshme. Në këtë rast, departamenti është i detyruar nga *ratio decidendi* i bordit, nëse faktet mbeten të njëjta.

Neni 111

Kërkesa për rishikim

- 207.** Çdo palë në procedimin e ankimit e pakënaqur nga vendimi i bordit të ankimit, mund të depozitojë një kërkesë tek Bordit i Zgjeruar i Ankimit për rishikim të vendimit. Por, kërkesa të tilla mund të dorëzohen vetëm mbi baza që përbërja e bordit nuk ka qenë e duhur, ose është kryer një shkelje themelore apo ndonjë shkelje procedurale e të drejtës për t'u dëgjuar, ose një vepër penale ka pasur ndikim në vendim. Kundërshtimet duhet të jenë ngritur gjatë procedimit të ankimit.

Neni 112a
Rr. 104-107
Neni 113

Si rregull, kërkesa depozitohet brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit të bordit të ankimit. Kërkesa konsiderohet e depozituar që nga momenti kur paguhet tarifa përkatëse.

Neni 112a(4)
Neni 2 Nr. 11a
Rr Tarifor

Nëse kërkesa për rishikim është e pranueshme dhe e lejueshme, Bordi Zgjeruar i Ankimit e pezullon vendimin e bordit të ankimit dhe urdhëron rihapjen e procedimit para bordit përgjegjës të ankimit, si dhe rimbursimin e tarifës për kërkesën për rishikim.

Neni 112a(5)
Rr. 108
Rr. 110

VIII. Aplikimet e pjesshme

- 208.** Arsyeja e zakonshme për depozitimin e aplikimit të pjesshëm European është se kërkesa e mëparshme nuk përmbush kërkesat e unitetit të shpikjes (shiko pikën 69) dhe aplikanti nuk është i kënaqur me kufizimin.

Neni 82
Neni 76
Rr. 36
Udhëz. A-IV, 1
Udhëz. C-IX, 1

- 209.** Aplikimi i pjesshëm mund të depozitohet vetëm në lidhje me objektin që nuk del tej përmbajtjes së aplikimit të mëparshëm të depozituar. Nëse përmbush këtë dispozitë dhe kërkesat formale për akordimin e datës së depozitimit (shiko pikën 136 a në vijim). atëherë merr datën e depozitimit të aplikimit të mëparshëm dhe gëzon të drejtën e prioritetit..

Neni 76(1),
fjalë e 2-të
Neni 80
Udhëz. A-IV, 1.2
Udhëz. C-IX, 1.1

Të gjitha shtetet kontraktuese të caktuara në aplikimin e mëparshëm në kohën e depozitimit të aplikimit të pjesshëm, konsiderohen të përcaktuara në aplikimin e fundit.

Neni 76(2)
Udhëz. A-IV,
1.3.4

Megjithatë, emërtimet e shteteve kontraktuese që janë tërhequr apo konsiderohen të tërhequra në lidhje me aplikimin e mëparshëm në momentin e dorëzimit të aplikimit të pjesshëm, nuk janë të përcaktuara në lidhje me këtë të fundit. Të njëjtat kushte aplikohen për shtetet e shtrirjes apo ekzaminimit.

- 210.** Një aplikim i pjesshëm mund të depozitohet në lidhje me çdo aplikim të mëparshëm për patentë Europiane në pritje. Një aplikim është në pritje deri në (por pa përfshirë) datën në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend dhënien e patentës Europiane ose nga data kur aplikimi është refuzuar, tërhequr ose konsiderohet i tërhequr. Pasi një aplikim është refuzuar, një aplikim i pjesshëm mund të depozitohet deri në përfundim të periudhës së apelimit, pavarësisht nëse apelimi është dorëzuar si dokumentacion ose jo.

*Rr. 36(1)
Neni 82
Udhëz. A-IV,
1.1.1
GZ 2002, 112
GZ 2013, 501*

- 211.** Aplikimet e pjesshme duhet të depozitohen drejtpërdrejtë te ZEP në Mynih, në Hagë apo në Berlin. Ato mund të depozitohen gjithashtu duke përdorur softuerin e depozitimit *online* të ZEP(shiko pikën 106). Aplikimet e pjesshme duhet të dorëzohen në gjuhën e procedimit të aplikimit të mëparshëm. Nëse aplikimi i mëparshëm nuk është depozituar në gjuhën e procedimit, edhe aplikimi i pjesshëm mund të depozitohet në gjuhën e aplikimit të mëparshëm.

*Rr. 36(2)
Rr. 57(a)
Udhëz. A-IV,
1.3*

- 212.** Për tarifat që duhen paguar në lidhje me një aplikim të pjesshëm European, si dhe për afatet kohore për pagimin dhe pasojat juridike të mosrespektimit të afateve, shikoni pikat 119-122.

Neni 9 RFees

Tarifa e kërkitimit rimburohet plotësisht ose pjesërisht. Kjo varet se në çfare mase kërkitimi bazohet në raportin e kërkitimit për aplikimin e mëparshëm.

*Rr. 51(3)
Neni 86(1)*

Nëse aplikimi i pjesshëm është depozituar më shumë se dy vjet pas datës së depozitimit të aplikimit të mëparshëm, aplikanti duhet të paguajë tarifat e papaguara të rinovimit (shiko pikat 213-216) jo më vonë se katër muaj nga depozitimi i aplikimit të pjesshëm. Nëse këto tarifa nuk paguhen në afat, ato mund të paguhen brenda gjashtë muajve nga skadimi i afatit, me kusht që tarifa shtesë të paguhet brenda afatit (shiko pikën 215).

Pas depozitimit, çdo aplikim i pjesshëm trajtohet si aplikim i pavarur për patentë Europiane.

IX. Tarifat e rinovimit

- 213.** Ju kërkohet të paguani tarifat e rinovimit te ZEP në lidhje me aplikimin tuaj për patentë Europiane. Këto janë caktuar për vitin e tretë dhe çdo vit vijues, nga data e depozitimit.

*Neni 86
Neni 2 No. 4 Rr
Tarifore*

- 214.** Tarifat e rinovimit në lidhje me vitin e ardhshëm duhen paguar në ditën e fundit të të po të njëjtit muaj kur bëhet depozitimi. Për shumën e tarifave dhe mënyrat e pagesës shikoni pikat 121 dhe 122.

*Rr. 51
GZ 1984, 272
Rr. 51(1)*

- 215.** Pagesa mund të bëhet edhe brenda gjashtë muajve pas afatit, me kusht që brenda këtij afati të paguani një tarifë shtesë prej 50% për pagim të vonuar. ZEP normalisht ju dërgon një kujtesë, që është për kortezi dhe mosdërgimi i

*Rr. 51(2)
Neni 2 No.5 Rr
Tarifore
Udhëz A-X,
5.2.4*

saj nuk përbën bazë për ankim. Tarifat e rinovimit nuk mund të paguhen më herët se tre muaj nga data në të cilën ato duhet të paguhen.

- 216.** Nëse nuk paguani në afat tarifën e rinovimit dhe çdo tarifë shtesë, aplikimi konsiderohet i tërhequr. Nuk keni mundësinë e përpunimit të mëtejshëm në bazë të nenit 121, por mund të kërkonti rivendosjen e të drejtave në bazë të nenit 122 (shiko edhe pikën 226).

*Neni 86(1)
Rr. 135
Rr. 136*

- 217.** Tarifa e fundit e pagueshme për rinovimin në lidhje me një aplikim për patentë Europiane, i përket vitit të patentës në të cilin publikohet përmendja e dhënies së saj (shiko pikën 168 e në vijim).

Neni 86(2)

- 218.** Tarifat e rinovimit për vitet pasuese gjatë afatit të patentës Europiane (shiko pikën 5, paragrafi i fundit) paguhen në zyrat qendrore të pronësisë industriale të shteteve të caktuara. Për më shumë detaje referojuni “Ligjit kombëtar lidhur me KEP” (shiko pikën 4).

*Neni 63
Neni 141*

X. Dispozitat e përgjithshme për afatet

- 219.** Shtojca VI përmban grafikun e veprimeve që duhet të kryejnë aplikantët brenda periudhave të përcaktuara në KEP.

*Neni 120-122
Rr. 131-136
Udhëz. E-VII
Rr. 131
Udhëz. E-VII, 1.4*

Parimi është që afatet kohore llogariten që të nesërmen e datës në të cilën ndodh ngjarja përkatëse. Në rastin e njoftimit, ngjarja që merret parasysh është marrja e njoftimit, duke iu nënshtruar dispozitave për njoftimin. Procedura e aplikueshme për njoftimet është dhënë më poshtë. Skadimi i afateve përcaktohet në Rregullin 131 (3) - (5). Në raste të veçanta, afati mund të zgjatet në bazë të Rregullit 134.

Një dokument që arrin pas afatit konsiderohet se është marrë brenda afatit nëse është postuar ose dorëzuar te një shërbim dorëzimi i njohur Kryetari i Zyrës Europiane të Patentave (Chronopost, DHL, Federal Express, flexpress, TNT, SkyNet or UPS ose Transworld) të paktën pesë ditë kalendarike para datës kur skadon afati, përveçse kur dokumenti është marrë më vonë se tre muaj pas skadimit të afatit..

*Rr. 133
GZ 2015, A29*

- 220.** Një afat i vendosur nga ZEP mund të zgjatet me kusht që kërkesa për zgjatje afati të paraqitet para skadimit të afatit. Por vetëm në raste të veçanta lejohen kërkesa të tilla zgjatjeje që e çojnë shumën totale të afatit në mbi gjashtë muaj.

*Rr. 132(2)
Udhëz. E-VII, 1.6
GZ 1989, 180
GZ 1994, 229*

- 221.** Të gjitha vendimet, thirrjet, njoftimet dhe komunikimet që përdoren si referim për të llogaritur afate, dorëzohen në formën e njoftimeve.

*Neni 119
Rr. 125-129
Udhëz. E-I
Rr. 127*

Si rregull, njoftimi bëhet me letër rekomande, dhe llogaritet të mbërrijë në ditën e dhjetë pas postimit, përveçse kur nuk mbërrin te i adresuari ose mbërrin në një datë të mëvonshme.

Megjithatë, një njoftim mund të bëhet edhe elektronikisht. Në këtë rast dokumenti elektronik duhet të mbërrijë në ditën e dhjetë pas postimit, përveçse kur nuk mbërrin te i adresuari ose mbërrin në një datë të mëvonshme.

*GZ EPO 2015,
A36
GZ EPO 2015,
A28*

Shkelja e afateve

- 222.** Me shkeljen e një afati, merrni përsipër përgjegjësi juridike për **sanksione ligjore** të tilla si refuzimi i aplikimit, humbje totale ose e pjesshme e të të drejtave që hyjnë në fuqi automatikisht pa qenë nevoja e një vendimi të Zyrës. Ky rast përfshin humbjen e të drejtës për prioritet për shkak të depozitimit me vonesë të dokumentit të prioritetit, apo kur aplikimi konsiderohet i tërhequr për shkak se nuk i ktheni përgjigje një komunikimi të ZEP në kohën e duhur.

Udhëz. E-VII,
1.8

- 223.** Kur ZEP konstaton humbjen e të drejtave pa vendim, jua komunikon ju.

Nëse gjykoni se konstantimi i ZEP është i pasaktë, brenda dy muajve pas marrjes së komunikimit mund të aplikoni për një vendim mbi këtë çështje. Vendimi merret vetëm nëse ZEP qëndron në mendimin e vet dhe çdo vendim i marrë është i ankimeshëm. Nëse nuk merret vendim, ZEP do t'ju informojë se humbja e të drejtave anulohet.

Rr. 112(1)
Udhëz. E-VII,
1.9.1, 1.9.2
Rr. 112(2)
Udhëz. E-VII,
1.9.3

Plotësimi i një akti të munguar

- 224.** KEP parashikon dispozita për plotësimin e akteve të munguara, në varësi të natyrës së afatit të shkelur.

Udhëz. E-VII, 2

- 225.** Nëse shkelni një afat kundrejt ZEP, kaq mjafton zakonisht që të kërkonti ekzaminimin e mëtejshëm të aplikimit. Ekzaminimi i mëtejshëm duhet të kërkohej përmes pagesës së tarifës brenda dy muajve nga data e komunikimit lidhur me mosrespektimin e afatit ose e njoftimit për humbjen e të drejtave. Akti i munguar duhet të plotësohet brenda këtij afati. Nuk nevojiten argumente për

Neni 121
Rr. 135
Udhëz. E-VII,
2.1

kërkesën. Përpunimi i mëtejshëm nuk lejohet në lidhje me disa afate të renditura në nenin 121 dhe në Rregullin 135(2).

- 226.** Rivendosja e të drejtave (*restitutio in integrum*) lejohet për ato afate për të cilat përjashtohet përpunimi i mëtejshëm. Megjithatë, kjo mundësi do t'ju jepet vetëm nëse keni bërë të gjitha përpjekjet sipas rrethanave për ta respektuar afatin.

Neni 122
Rr. 136
Udhëz. E-VII,
2.2

Nëse veproni përmes një përfaqësuesi, aplikimi juaj për rivendosje do të miratohet vetëm nëse edhe përfaqësuesi ka bërë të gjitha përpjekjet që pretendohet prej aplikantit (Neni 122 (1)).

- 227.** Rivendosja e të drejtave përjashtohet në lidhje me çdo afat për të cilin po kryhet trajtim i mëtejshëm si dhe në lidhje me afatin e kërimit të rivendosjes së të drejtave. Por rivendosja lejohet në lidhje me afatin e kërimit të përpunimit të mëtejshëm. Përpunimi i mëtejshëm dhe rivendosja e të drejtave nuk janë të disponueshme në rast se nuk janë kryer pagesat e shtrirjes ose/dhe ekzaminimit, duke qënë se këto nuk janë afate kohore të vendosura nga KEP.

Neni. 122(4)
Rr. 136(3)
Udhëz. E-VII,
2.2.4

- 228.** Aplikimet për rivendosjen e të drejtave duhet të dorëzohen brenda dy muajve nga eliminimi i shkakut të mosrespektimit të afatit. Akti i munguar duhet të plotësohet brenda këtij afati. Aplikimet pranohen vetëm brenda vitit që pason vitin kur është shkelur afati. Por kërkesat për rivendosjen e të drejtave në lidhje me ndonjë nga afatet e specifikuar në nenin 87(1) dhe në nenin 112a(4) duhet të dorëzohen brenda dy muajve pas skadimit të këtyre afateve.

Rr. 136
Udhëz. E-VII,
2.2.5

Aplikimi duhet të përmbajë bazat mbi të cilat ngrihet, dhe duhet të tregojë faktet mbi të cilat mbështetet. Aplikimi konsiderohet i depozituar që nga momenti kur paguhet tarifa për rivendosjen e të drejtave.

Shtojca I

Tabelat që tregojnë procedurën për dhënien e patentës Europiane

Shpikje

Aplikimi i patentës Europiane (shih kapitullin C)

- Kërkesa (e detyrueshme), preferohet formulari i ZEP 1001
- Përshkrimi (i detyrueshëm)
- Pretendimet
- Vizatimet (nëse ka)
- Abstrakti

Zyrat e depozitimit

- ZEP Berlin -ZEP Mynih
- ZEP Hagë -Zyra Kombëtare e Patentave

Tarifat e Depozitimit (mundësisht duke përfshirë dhe tarifën e faqes së 36-të dhe në vijim)

Tarifat e Kërkimit

(Tarifat e pretendimeve të 16-të dhe në vijim)

Ekzaminimi i aplikimit deri në lidhje me kërkesat e mëparshme (shiko pikat 136-143)

Kërkimi në lidhje me hapin shpikës (shiko pikat 144-148)

Raporti i hetimit dhe opinioni jo i detyrueshëm i patentueshmërisë

Publikimi i Aplikimit (shiko pikat 149-154)

18 muaj pas datës së aplikimit ose data prioritare më e hershme

Mbrojtja e përkoshme e patentës mund të sigurohet në të gjitha vendet anëtare. Aplikimi mund të përmbajë dëshmipërblime të arsyeshme nga konkurrentët të cilët shkelin aplikimet e tyre nëpërmjet imitimeve.

Tarifat e Ekzaminimit

Pagesa për mbrojtje
Pagesa e Shtirjes/njohjes (ku aplikohet)
Kthimi përgjigje për opinionin mbi patentueshmërinë
Mundësi për të rregulluar pretendimet dhe përshkrimet

Shtetet anëtare të ZEP, shtetet për shtirje dhe për njohje



Ekzaminimi i aplikimit (shiko pikat 159-169)

Kërkimi në lidhje me hapin shpikës (shiko pikat 144-148)

Tarifat e rinovimit për vitin e tretë e në vijim

Përkthimi i pretendimeve në gjuhët zyrtare të ZEP dhe tarifën e dhënies dhe

Dhënia e patentës (shiko pikën 170) Publikimi i të dhënave mbi publikimin

Mbrojtja e plotë e patentës kundër shkeljeve (përdorimi i palicënsuar i shpikjes nga konkurrentët)
Vlefshmëria në vendet anëtare
Kundërshtimi nga palë të treta në periudhën prej 9 muajsh nga publikimi i lëshimit të patentës (shiko pikat 178-188)
Patentueshmëria mund të limitohet ose anulohet patentën (shiko pikat 189-196)

Çdo palë kundërshtuese e prekur nga vendimi mund të apelojë këtë vendim (shiko pikat 197-207)

Shtojca II

Botimi special Nr. 3, GZ 2007, F.1.

Njoftim i Zyrës Europiane të Patentave i datës 30 Nëntor 2015 në lidhje me programin për ndjekjen e përshpejtuar të aplikimeve për patentë Europiane - “PACE”

Zbatimi i Early Certainty from Search (ECfS) në korrik 2014 ka zbuluar një nevojë për të shqyrtuar dhe sqaruar kushtet që zbatohen për programin për ndjekje të përshpejtuar të aplikimeve për patentë Europiane (“PACE”).

Ky rishikim ka për qëllim të ndihmojë aplikantët të përdorin më mirë programin dhe të mundësojë Zyrën të përpunojë aplikimet për të cilat është kërkuar përshpejtim të menjëhershëm brenda mundësive. Në përgjithësi, rishikimi ka për qëllim për të përmirësuar programin duke rritur efektivitetin e saj.

Si në të kaluarën, PACE u mundëson kandidatëve përpunim të përshpejtuar të aplikimeve të tyre që të marrë raportin e kërkimit, raportin e parë të ekzaminit dhe çdo komunikim sipas Rregullit 71(3) të KEP brenda afateve të ngjeshura. Kjo vlen edhe për opinionin mbi patentueshmërinë (sipas Rregullit 62 1) të KEP), e cila i dërgohet aplikantit së bashku me raportin e kërkimit.

Më shumë detaje për programin PACE dhe për veçoritë e aplikimeve Euro-TPC, janë dhënë si më poshtë:

Informacion në lidhje me mënyra të tjera për të përshpejtuar procedurën e dhënies së patentës Europiane - të tilla si heqjen e ftesës sipas Rregullës 70 (2) KEP, heqjen e komunikimit nën Rregullat e 161 dhe 162 KEP, heqja dorë nga një komunikim i mëtejshëm sipas Rregullës 71 (3) KEP, hyrje e hershme në fazën Europiane, përpunimit të përshpejtuar të kundërshtimeve, ku janë krijuar shkelje ndaj procedurave dhe të përpunimit të përshpejtuar përpara bordeve të ankimit - është dhënë në njoftimin përkatës të publikuar në Buletinin Zyrtar KEP 2015 A94.

Një opsion tjetër është në dispozicion në kuadër të programit Patent Prosecution Highway (PPH) një program pilot, i cili

lejon për përshpejtimin e përpunimit të një aplikimi për patentë Europiane e pranueshme kur pretendimet e një aplikimi korrespondues janë përcaktuar të jenë të patentueshme / lejueshme nga një zyrë partnere PPH, ndërsa në të njëjtën kohë duke lejuar KEP të shfrytëzojë rezultatet në dispozicion.¹

A. Të përgjithshme

1. Ndjekja e përshpejtuar e aplikimeve për patentë Europiane normalisht bëhet pas një kërkesë me shkrim. Aplikantët duhet të përdorni formularin e dedikuar të kërkesës (Formulari KEP 1005), i cili duhet të dorëzohet online. KEP do të lëshojë një vërtetim të menjëhershëm të pranimit.² Nuk do të përpunohet asnjë kërkesë e dorëzuar joformalisht, d.m.th. pa përdorur formularin e dedikuar, dhe / ose në letër.

2. Një kërkesë për pjesëmarrje në programin PACE (kërkesë PACE) mund të paraqitet vetëm një herë gjatë çdo faze të procedurës, që do të thotë kërkim dhe ekzaminim, dhe për një aplikim në kohë.

¹ Shiko GZ ZEP 2014, A8; 2015, A6; 2015, A7; 2015, A8; 2015, A70.

² Në lidhje menjohjen e dokumentit të marrjes së dokumentave ju lutemi të konsultoheni me teknikalitetet e mjeteve për të aplikuar online.

Një kërkesë PACE paraqitur gjatë kërimit nuk do të nxis një fazë ekzaminimi të përshpejtuar. Kërkesa për Ekzaminim të përshpejtuar mund të paraqitet një herë sektori i ekzaminimit merr përsipër të ekzaminojë aplikimin për patentë Europiane³.

3. ZEP nuk publikon kërkesat për kërkim dhe/ose ekzaminim të përshpejtuar (kërkesat e PACE) dhe me vendim të Kryetarit të datës 12 korrik 2007⁴, ato janë përjashtuar nga e drejta e inspektimit publik

4. Një aplikimin do të hiqet nga programi PACE nëse

- Aplikimi PACE është tërhequr,
- Aplikanti ka kërkuar një zgjatje të afateve kohore,
- Aplikimi është refuzuar,
- Aplikimi është tërhequr,
- Aplikimi konsiderohet i tërhequr.

Kjo vlen pavarësisht nga mjetet juridike në dispozicion sipas KEP. Në raste të tilla nuk do të jetë e mundur për të rivendosur aplikimin në programin PACE, dmth një kërkesë të dytë për të njëjtin aplikim në të njëjtën fazë të procedurës nuk do të përpunohet.

5. Përveç kësaj, procedimi i përshpejtuar do të pezullohet në rast të dështimit për të paguar tarifat e rinovimit në datën e duhur përcaktuar në Rregullin 51 (1) KEP.

6. Procedimi i përshpejtuar në kuadër të programit PACE mund të sigurohet vetëm kur është praktikisht e realizueshme dhe në varësi të ngarkesës së punës së sektorit të kërimit dhe ekzaminimit. Në fusha të caktuara teknike mund të ketë kufizime për shkak të numrit të kërkesave hyrëse PACE. Aplikantët që kërkojnë ndjekjen e përshpejtuar për të gjitha ose shumicën e aplikimeve të tyre do t'u, si rregull, kërkohet nga Zyra për të kufizuar numrin e kërkesave PACE duke bërë një përzgjedhje.

7. Aplikantët mund të këshillohen me shërbimin e klientit ZEP për statusin e kërkesës për të cilat një kërkesë PACE është paraqitur.

B. Kërkimi

8. Për aplikimet për patentë Europiane të paraqitura më ose pas datës 1 Korrik 2014 (duke përfshirë aplikime PCT hyjnë në fazën evropiane ku EPO nuk ka vepruar si (S) ISA), Zyra nën ECfS përpaket të nxjerrë një raport të zgjeruar/ të pjesshëm të kërimit European brenda gjashtë muajsh nga data e depozitimit ose nga skadimit i afatit sipas Rregulli 161 (2) KEP. Për këtë arsye një kërkesë PACE nuk është e nevojshme.

9. Për aplikime për patentë Europiane (duke përfshirë aplikime PCT hyjnë në fazën evropiane ku EPO nuk ka vepruar si (S) ISA) të paraqitura para 1 korrikut 2014 dhe pretendojnë prioritet (dorëzimet e dyta), me marrjen e një kërkesë PACE Zyra bën çdo përpjekje për lëshimin e një raporti të zgjeruar/ të pjesshëm të kërimit European brenda gjashtë muajsh nga data e kërkesës.

³ Shiko Rregullin 10 KEP dhe Udhëzimet për Ekzaminimin tek ZEP, C-II, 1.

⁴ Shiko Edicioni Special Nr. 3, GZ ZEP 2007, J.3.

10. Aplikantët duhet të kenë parasysh që një kërkimi i përshpejtuar mund të fillojë vetëm

i. pas marrjes së përgjigjes së ankuesit për një komunikim në bazë të Rregullit 62A ose 63 KEP ose skadimit të afatit përkatës kohor;

ii. në të gjitha rastet: kur dokumentet e aplikimit në dosje janë të plotë mjaftueshëmrisht për përpilimin e një raporti të zgjeruar. Kjo do të thotë, në mënyrë të veçantë, të japsëh Zyrës në kohë pretendimet, përshkrimin, përkthimet e nevojshme dhe, kur është e zbatueshme, skicat dhe një sekuencë të renditur në përputhje me rregullat për përfaqësimin e standardizuar të sekuencave të nukleotideve ose amino acideve;

iii. për aplikimet PCT hyrja në fazën Europiane ku ZEP nuk ka vepruar si (S) ISA: pas skadimit të periudhës gjashtë mujore sipas Rregullit 161 (2) KEP, edhe në qoftë se përshpejtimi është kërkuar në kuadrin e programit PACE. Në mënyrë që kërkimi shtesë Europian të fillojë menjëherë, me hyrjen në fazën Europiane, aplikanti duhet të heqë dorë totalisht nga e drejta e komunikimit në pajtim me Rregulloren 161 (2) dhe 162 (2) KEP dhe të paguajë për tarifën e duhura për këtë arsye (shih njoftimin nga ZEP të datës 30 nëntor 2015, GZ ZEP 2015 A94).

11. Nëse ZEP ka ftuar aplikuesin për të paguar tarifën(a) shtesë për kërkimin sipas Rregullit 64 (1), fjalia e dytë, ose 164 (1) (b) KEP, ajo nuk mund të fillojë hartimin e raportit përfundimtar sipas Rregullit 64 (1), fjalia e fundit, ose 164 (1) (c) KEP derisa ajo të ketë marrë përgjigjen e aplikantit, ose deri sa afati i caktuar dy muaj të ketë skaduar.

C. Ekzaminimi

12. Ekzaminimi i përshpejtuar, në princip, mund të kërkohet në çdo kohë pasi përgjegjësia e aplikimit ti ketë kaluar sektorit të Ekzaminimit.⁵

13. Për aplikimet PCT hyrja në fazën Europiane ku ZEP nuk ka vepruar si (S) ISA ekzaminimi i përshpejtuar, në princip, mund të kërkohet në çdo kohë, për shembull:

- Sapo të jetë konfirmuar hyrja në fazën Europiane përpara ZEP⁶ ose
- Së bashku me një përgjigje ndaj WO-ISA, IPER, SISR e detyrueshme sipas Rregullit 161(1)

14. Kur kërkohet ekzaminimi i përshpejtuar, Zyra bën çdo përpjekje për të nxjerrë komunikimin e parë të ekzaminimit brenda tre muajve nga data e pranimit nga ana e sektorit të ekzaminimit ose aplikimit ose kërkesës për ekzaminim të përshpejtuar sipas Rregullit 70a ose 161(1) KEP.

15. Zyra synon të prodhojë të gjitha komunikimet pasuese të ekzaminimit brenda tre muajve nga marrja e përgjigjes prej aplikantit, me kusht që aplikimi është ende nën procesimin e programit PACE. (shiko paragrafin 4 me sipër)

D. Hyrja në Fuqi

16. Programi i rishikuar PACE do të hyjë në fuqi më 1 janar 2016, dhe kushtet e tij do të zbatohen për kërkesat PACE të paraqitura më ose pas kësaj date.

17. Pavarësisht nga paragrafi 16, kushtet e paragrafëve 4 dhe 5 më lart në lidhje respektivisht me largimin e një kërkesë nga programi PACE dhe pezullimin e ndjekjes së saj të përshpejtuar do të zbatohet për kërkesat e pezulluara nga hyrja në fuqi e programit të rishikuar.

⁵ Shih Rregulla 10 KEP dhe Udhëzimet për shqyrtim në ZEP, C-II, 1.

⁶ Me aplikimet Euro-PCT, aplikanti mund të përshpejtojë hyrjen në fazën Europiane duke kërkuar shprehimisht në përpunim të përshpejtuar sipas nenit 23 (2) ose 40 (2) PCT, GZ ZEP 2015 A94. Megjithatë, shqyrtimi i përshpejtuar në fazën Europiane nuk do të kryhet nëse nuk kërkohet më vete në kuadrin e programit PACE.

Njoftim i Zyrës Europiane të Patentave i datës 30 Nëntor 2015 në lidhje me mënyra të ndryshme për të përshpejtuar procedurën Europiane të Dhënies.

Njoftimi⁷ përmban informacion në lidhje me mënyrat për të shpejtuar procedurën Europiane të Dhënies përveç programit për ekzaminim të përshpejtuar të aplikimeve për patentë Europiane ("PACE").⁸

Një opsion tjetër është në dispozicion në kuadër të programit pilot Patent Prosecution Highway (PPH) , e cila lejon për përpunimin e përshpejtuar të një aplikimi për patentë Europiane të pranueshme kur pretendimet e një kërkesë korresponduese janë përcaktuar të jenë të patentueshme / lejueshme nga një zyrë partnere PPH, ndërsa në të njëjtën kohë duke lejuar ZEP të shfrytëzojë rezultatet të mëparshme në dispozicion.⁹

I. Mënyra për të përshpejtuar procedurën Europiane të dhënies përveç programit PACE

A. Heqja dorë nga ftesa sipas Rregullit 70 (2) KEP

1. Para se aplikanti të marrë raportin e kërimit, ai mund të heqë dorë nga ftesa sipas Rregullit 70 (2) KEP dhe të kërkojë ekzaminimin të pakushtëzuar, pavarësisht nga rezultatet e kërimit. Në këtë rast, sipas rregullit 62 KEP raporti i kërimit European lëshohet së bashku me një komunikim të parë të ekzaminimit në bazë të Nenit 94 (3) dhe Rregulla 71 (1) KEP në vend të opinionit mbi patentueshmërinë nën Rregullin 62 KEP. Një përgjigje e shpejtë dhe e plotë nga aplikanti, siguron që procedura të vazhdojë sa më shpejt.

B. Heqja e komunikimit nën Rregullat 161 dhe 162 KEP

2. Në rastin e aplikimeve Euro-PCT, aplikanti është i informuar në momentin e hyrjes në fazën Europiane se ai mund të ndryshojë aplikimin brenda gjashtë muajve pas njoftimit të komunikimit. Komunikimi më tej informon atë se tarifat për çdo pretendim duhet të paguhet brenda të njëjtit afat kohor.

3. Aplikanti mund të heqë dorë nga e drejta e tij e komunikimit në bazë të Rregullave 161 (1) ose (2) dhe 162 KEP. Për arsye të efikasitetit dhe për të siguruar që heqja dorë është konsideruar mjaftueshëm, aplikanti rekomandohet që të kontrollojë kutinë në seksionin 6.4 të Formularit 1200. Nëse heqja dorë është dorëzuar në një dokument të veçantë ajo mund të, për shembull, të formulohet si vijon: "Kërkuesi heq dorë nga e drejta e tij e komunikimit në bazë të Rregullave 161 (1) ose (2) dhe 162 KEP. "

4. ZEP nuk do të lëshojë një komunikim sipas Rregullave 161 (1) ose (2) dhe 162 EPC vetëm nëse, si shtesë e heqjes dorë, në momentin e hyrjes në fazën Europiane aplikanti ka plotësuar edhe të gjitha kërkesat e Rregullave 161 dhe 162 EPC (pagesën e tarifës për çdo pretendim, kur është e nevojshme, paraqitja e një përgjigjeje sipas Rregullit 161 (1) KEP) në mënyrë që aplikim të procedojë drejtpërsëdrejti me kërkimin European shtesë apo të ekzaminimit. Ku nuk është hequr dorë nga e drejta e komunikimit sipas Rregullave 161 (1) ose (2) dhe 162 KEP, komunikimi do të lëshohet dhe aplikimi do të shqyrtohet vetëm pas skadimit të periudhës gjashtëmujore parashikuar në këto rregulla, edhe në qoftë se një kërkesë në kuadrin e programit PACE është paraqitur.

⁷ Versioni i rishikuar i Njoftimit nga ZEP i Prill 2011 lidhur me Formularin 1200 (hyrja në fazën Europiane) dhe mundësia për të hequr dorë nga e drejta e komunikimit sipas Rregullit 161(1) ose (2) dhe 162 KEP, GZ ZEP 2011, 354.

⁸ Shiko GZ ZEP 2015, A93.

⁹ Shiko GZ ZEP 2014, A8; 2015, A6; 2015, A7; 2015, A8; 2015, A70.

5. Kur komunikimi në bazë të Rregullave 161 (1) ose (2) dhe 162 KEP është lëshuar, aplikanti ka të drejtë në periudhën e plotë prej gjashtë muajsh të paraqesë ndryshime. Kërkimi Europian shtesë ose ekzaminimi do të bazohet në dokumentat e aplikimit sipas ndryshimeve të fundit deri në skadimin e periudhës gjashtëmujore. Nëse një aplikant nuk dëshiron të përdorë të gjithë periudhën gjashtëmujore, ai mund të kërkojë fillimin e menjëhershëm të kontrollit ose ekzaminimit. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ndryshimet. Ajo nuk ka një formë të veçantë dhe mund të, për shembull, formulohet si vijon: “Aplikanti kërkon fillimin e menjëhershëm të përpunimit dhe të heq dorë nga e drejta e tij për të përdorur pjesën e mbetur të periudhës gjashtë mujore në bazë të Rregullores 161 (1) ose (2) dhe 162 EPC “. Kërkesa është efektive vetëm nëse kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat e Rregullave 161 dhe 162 EPC të përcaktuara më sipër.

6. Aplikantët duhet të kenë parasysh se heqja dorë dhe kërkesa e PACE janë dy gjëra thelbësisht të ndryshme dhe prandaj duhet që të dorëzohen veçmas.

C. Heqja dorë nga komunikimet e mëtejshme sipas Rregullit 71(3) KEP

7. Aplikantët mund të heqin dorë shprehimisht nga marrja e komunikimeve të mëtejshme sipas Rregullit 71(3) KEP kur kërkojnë korrigjime apo ndryshime nga sektori i ekzaminimit të tekstit të përmendur në një komunikim të mëparshëm sipas Rregulli 71 (3). Me kusht që të plotësohen kërkesat specifike formale dhe sektori i ekzaminimit nuk ka kundërshtime ndaj ndryshimeve ose korrigjimeve, Zyra nuk do të dërgojë një komunikim të mëtejshëm sipas Rregullës 71 (3) EPC dhe do të vazhdojë të nxjerrë vendimin mbi dhënien e patentës Europiane. Për detaje të mëtejshme referohuni Njoftimit të bërë nga Zyra e Patentave Europiane i datës 8 qershor 2015 në lidhje me mundësinë për të hequr dorë nga e drejta për një komunikim të mëtejshëm sipas Rregulli 71 (3) KEP, GZ ZEP 2015, A52.

D. Hyrja e hershme në fazën Europiane

8. ZEP si Zyra e caktuar / zgjedhur nuk do të përpunojë një kërkesë ndërkombëtare para skadimit të afatit 31-mujor nga data e depozitimit ose, nëse pretendohet përparësia, nga data e prioritetit (nenet 22 (3) / 39 (1) (b) PCT, Rregulli 159 (1) KEP). Aplikanti mund të kërkojë fillimin e përpunimit para skadimit të këtij afati kohor duke paraqitur një kërkesë të qartë për përpunimin e hershëm (Nenet 23 (2) / 40 (2) PCT). Që kërkesa të jetë efektive, aplikanti duhet të pajtohet me kërkesat e Rregullit 159 (1) KEP njëllor sikur afati kohor 31-mujor të kishte skaduar në datën e kërkesës së përpunimit të hershëm (pagesa e tarifave, paraqitja e përkthimeve, etj). Kërkesa PACE nuk ndikon në fillimin e përpunimit. Nga ana tjetër, një kërkesë për përpunimin e hershëm nuk njihet si një kërkesë PACE. Të dyja duhet të kërkojnë veçmas. Informacion i detajuar është dhënë në njoftimin nga ZEP i datës 21 Shkurt 2013 në lidhje me kërkesën për procesim të hershëm.¹⁰

II. Përpunim i përshpejtuar i kundërshtimeve, ku janë vënë re shkelje, dhe përpunim i përshpejtuar përpara bordit të apelit

9. Së fundmi, i referohemi njoftimit nga Zyra Europiane e Patentave i datës 17 Mars 2008 lidhur me përpunimin e përshpejtuar të kundërshtimeve, ku është vënë re shkeljeve ndaj procedurave¹¹ dhe ndaj njoftimit të Nënkrjetarit të Drejtorisë së Përgjithshme 3 i datës 17 mars 2008 në lidhje me përpunimin e përshpejtuar përpara bordit të apelit.¹²

4 GZ ZEP 2013 156; shih gjithashtu Udhëzimet për shqyrtim në Zyrën Europiane të Patentave, E-VIII, 2.9; Guida Euro-PCT (edicioni i 8-të, 2015), pikat 427 e në vazhdim.

5 GZ ZEP 2008 221; Udhëzime për shqyrtim në Zyrën Europiane të Patentave, E-VII, 4.

6 Publikimi plotësues 1, GZ ZEP 2015, 60; Udhëzime për shqyrtim në Zyrën Europiane të Patentave, E-VII, 5.

10 GZ ZEP 2013, 156; shiko gjithashtu Këshillat për Ekzaminimin në ZEP, E-VIII, 2.9; Guida Euro-PCT (Edicioni i 8-të, 2015), pika 427 e në vazhdim.

11 GZ ZEP 2008, Këshillat për Ekzaminimin në ZEP, E-VII,4

12 Publikim Suplementar 1, GZ ZEP 2015, 60; Këshillat për Ekzaminimin në ZEP, E-VII,5

Shtojca III

Shembuj të aplikimeve për patentë Europiane

Ky seksion përmban tre shembuj aplikimesh për patentë Europiane (përshkrimi, pretendimet, skicat dhe abstrakti), një për secilën nga fushat e mëposhtme teknike:

- Kimia
- Mekanika
- Kompjuterat.

Këto shembuj pajtohen me dispozitat për aplikimet për patentë Europiane. Megjithatë, për shkak të nevojës për të përfshirë shënimet shpjeguese, kufijtë nuk mund të liheshin bosh (shiko pikën 71). Për kërkesat në lidhje me zbulimin e shpikjes, shikoni pikat 67 dhe 68. Përmbajtja e këtyre shembujve nuk është domosdoshmërisht e patentueshme.

Kimia

Neni. 78, 83 Rr.
42 Përshkrimi i
shpikjes

Titulli i shpikjes
(përcaktimi në
Kërkesën për
Dhenie mjafton)

5 Metoda për sintezën kimike të oligonukleotideve

Fusha e shpikjes

Kjo shpikje ka të bëjë me metodën e sintezës

- 10** kimike të oligonukleotideve. Në veçanti,
shpikja lidhet me një metodë të re të aftë për
sintetizimin kimik të një vargu të gjatë ADN ose
një fragmenti të lehtë ARN që varet nga një bazë
pjesërisht e pambrojtur fosforoamiditi nukleotidi
- 15** si njësi, si edhe komponimi i përdorur në këtë
metodë.


Rr. 42(1)(a)
Fusha teknike
të cilës i përket
shpikja

Historiku i shpikjes


- 20** Metoda fosforoamidite përdoret sot gjerësisht
si një metodë e sintetizimit kimik të
oligonukleotideve të tilla si fragmentet e ADN e
ARN (Kërkimi mbi Acidet Nukleike, 17:7059-7071,
1989). Në përgjithësi, kjo metodë fosforoamidite
- 25** përdor një reaksion kondensimi mes një
phosphoroamiditi nukleosid dhe një nukleosidi si
një reaksion bazë duke përdorur tetrazolin si
përsheptues. Për shkak të zhvillimit konkurrues
të këtij reaksioni si në grupin hidroksil në një
mase sheqeri dhe në grupin amin me një bazë
- 30** nukleosidi, vetëm reaksioni i përzgjedhur në
grupin hidroksil në një mase sheqeri kërkohet 25
për të sintetizuar nukleotidin e dëshiruar. Në
përputhje me rrethanat, efekti anësor mbi
- 35** grupin amin u parandalua në gjendjen e mëparshme,
siç ilustron në skemën e reaksionit vijues:

Rr. 42(1)(b)
Arritja e
mëparshme
përkatëse

5




10



- 15 Megjithatë, grupi i mbrojtur duhet të zhvendoset kur sinteza ka përfunduar, dhe reaksionet e ndërlikuara në veprim si dhe një masë e madhe e reagentëve të shtrenjtë dhe të dëmshëm kërkohen për të prezantuar dhe zhvendosur grupin mbrojtës të përmendur, i cili ne kuadrin e përdorimit praktik,
- 20 efektivitetit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit etj., është një problem i madh në realizimin e kësaj metode të mëparshme. Në përputhje me rrethanat, ka një kërkesë për metodën e sintetizimit kimik të një oligonukleotidi nga një grup amin i pambrojtur i
- 25 fosfmoroamiditit nucleosid si një njësi, dhe metodës së Letsinger et al., sic tregohet në skemën e reaksionit të mëposhtëm, e njohur si metodë novatore (Kërkimi mbi Acidet Nukleide, 20:1879-1882, 1992):

Vlerësimi i arritjes së mëparshme

30



Megjithatë, metoda e Letsinger et al. është jopraktike, jouniversale dhe nuk përdoret në praktikë sepse ekzistojnë disavantazhet e mëposhtme:

- 5 (1) norma e kondensimit në secilin hap është e ulët (rreth 97%: norma 99% kërkohet së paku për sintetizimin e 50- mereve ose një vargu më të gjatë oligonukleotidesh) dhe një sintetizues automatik ADN nuk mund të përdoret për këtë metodë, kështu që
- 10 vargu i gjatë oligonukleotidi që përmban 50 deri 100 nukleotide të kërkuara përgjithësisht në sintezën kimike të ADN etj. nuk mund të sintetizohen; (2) mund të përdoren vetëm fosforoamiditet nukleodite specifike tepër reaktive,
- 15 kështu që metoda ka fushë aplikimi të kufizuar dhe është jopraktike; dhe (3) hidrokloridi piridinë i përdorur si përshpejtues, është një komponim jo i qëndrueshëm me nivel të lartë lagështie, gjë që
- 20 vështirëson mbajtjen e tij.

Përmbledhja e shpikjes


- Kjo shpikje është bërë në kuadrin
- 25 e arritjes së mëparshme të përshkruar më sipër, dhe qëllimi i shpikjes prezente është të sigurojë një metodë praktike të sintetizimit kimik të 100-mereve ose të një vargu më të gjatë oligonukleotidesh, në mënyrë të lehtë dhe të sigurt, si edhe një komponim të ri të përdorur në metodën e sipërpërmendur.
- 30 Për të zgjidhur problemin, shpikja prezente ofron një metodë për sintezën kimike të një oligonukleotidi përmes metodës fosforoamidite, e cila përfshin përgatitjen e një baze pjesërisht të pambrojtur fosforoamiditi nukleosidi nga një një baze pjesërisht të pambrojtur nukleosidi përmes përdorimit të një

*Rr. 42
Problemi teknik*

*Rr. 42(1)(c)
Zbulimi i shpikjes
Rr. 42(1)(c)
Efektet
avantazhuese të
shpikjes*

trifluoromethanesulfonate imidazole përfaqësuar përmes formulës kimike të mëposhtme, dhe çiftëzimit të bazës pjesërisht të pambrojtur të sipërpërmendur të fosforoamiditit nukleosid

- 5 në një renditje të çrregullt të prezencës së trifluoromethanesulfonate imidazole të lartpërmendur për sintetizimin kimik të një oligonukleotidi me përmbajtje të një sekuence



specifike nukleotidi. Në një model të preferueshëm të metodës së kësaj shpikjeje, baza pjesërisht e pambrojtur e çiftëzuar fosforoamidite nukleoside trajtohet me një

- 15 tretësirë trifluoromethanesulfonate benzimidazole. Kështu, shpikësit prezentë zbuluan se një bazë pjesërisht e pambrojtur fosforoamidite nukleosid përgatitet nga përdorimi i komponimit,
- 20 trifluoromethanesulfonate imidazole (referuar në vijim si triflate imidazolium) në vend të tetrazolit të përdorur tradicionalisht si një
- 25 përshpejtues për reaksionin e kondensimit mes fosforoamiditeve nukleoside dhe nukleotideve i çliruar nga veprimi anësor
- 30 mbi grupin amin në pjesë të bazës së nukleotideve, dhe si rezultat, ata zbuluan se nuk janë të nevojshme procedurat e komplikuar të tilla si paraqitja dhe zhvendosja e një grupi mbrojtës, dhe gjithashtu sinteza mund të realizohet përmes një
- 35 sintetizuesi komercial, duke plotësuar shpikjen. Për më tepër, shpikësit prezentë gjetën që efekti anësor mbi grupin amin në një pjesë të bazës mund të ndalohet tërësisht nëpërmjet trajtimit të bazës së çiftuar pjesërisht të pambrojtur të fosforoamidite nukleoside, të lartpërmendur me tretësirën e

trifluoromethanesulfonate benzimidazole (referuar në vijim si triflate benzimidazolium) ku një oligonukleotide tepër perfekt është

R. 42(1)(d)
Brief description of drawings

5 sintetizuar, gjë që e kompletton shpikjen.

Përshkrim i shkurtër i skicave

Fig. 1 është një skicë e çdo hapi të reaksionit

10 në metodën e kësaj shpikje. Fig. 2 është një skicë e çdo hapi të reaksionit në metodën e shpikjes prezente ku është kryer trajtimi i amoniumit. Fig. 3 nje profil HPLC e fragmenteve të ADN të sintetizuara me metodën e kësaj shpikje.

15 Përshkrim i detajuar i shpikjes Sa më poshtë,

mënyra më e mirë për realizimin e shpikjes

20 prezente është përshkrimi në detaje.

Triflate imidazolium i shpikjes prezente mund të përgatitet përmes përzierjes së imidazoles me acidin trifluoromethanesulfonik në raportin 1:1

R. 42(1)(e)
Description of at least one way of carrying out the invention with reference to drawings

25 me diklorometanin, siç paraqitet më poshtë në preparatin e marrë shembull në Shembullin 1.

Triflate imidazolium i përfituar nuk absorbon lagështinë siç edhe tregohet në Shembullin 1 dhe

30 është shumë i qëndrueshëm nën kushte të zakonshme për përdorim, kështu që lehtëson mbajtjen e saj.


Në metodën sintetike kimike të shpikjes, baza pjesërisht e pambrojtur fosforoamidite nucleoside

përgatitet nga një bazë pjesërisht e pambrojtur nukleotide përmes përdorimit të triflate imidazolium siç përshkruhet më sipër, dhe kjo bazë pjesërisht e pambrojtur fosforoamidite

- 5 nukleoside perdoret si një njësi dhe çdo fosforoamidite nukleoside çiftëzohet në një menyrë të paracaktuar duke sintetizuar kimikisht një oligonukleotide të përbërë nga një sekuenca nukleotide specifike.
- 10 Baza pjesërisht e pambrojtur fosforoamidite nukleoside mund të përgatitet përmes veprimit të bazës pjesërisht e pambrojtur fosforoamidite nukleoside me cianoetil-bis-amidite në prezencë të triflate imidazolium si një kataliator siç paraqitet më poshtë p.sh. në Shembull 2. Në këtë rast, reaksioni ndodh në mënyrë
- 15 selektive mbi grupin hidroksid në një masë sheqeri të nukleosideve, kështu katër tipet N-të pambrojtura të fosforoamiditeve nukleoside të përdorura në sistezën e ADN, pra, deoksiadenosine, deoksithymidine, deoksiguanosine and fosforoamidites timidine mund të
- 20 përftohen në sasi. Kështu të katër tipet e përftuar të fosforoamidites nukleoside N- të pambrojtura përdoren si njësi për të sintetizuar një oligonukleotide që përbëhet nga një sekuenca e
- 25 dëshiruar nukleotide përmes metodës sintetike me fazë solide etj. të njohur nga arritjet e mëparshme. Për më tepër, ky reaksion sintetik mund të përcillet në një sintetizues komercial ADN përmes një metode sipas protokollit të tyre.
- 30 Në metodën e kësaj shpikje, çdo fosforoamidite nukleoside i çiftëzuar N-i pambrojtur nënshtrohet pas çdo çifti të trajtuar me një tretësirë (p.sh. një tretësirë etanoli) të triflate benzimidazolium.


Nga ky trajtim, efekti anësor mbi grupin amin në një pjesë të bazës ndalohej tërësisht, dhe kështu sintetizohet një oligonukleotide më perfekt.

- 5 Triflate benzimidazolium mund të sintetizohet në reaksionin sipas skemës së mëposhtme:



Shembuj

- 15 Në vijim, shpikja prezente përshkruhet më e detajuar dhe në mënyrë specifike lidhur me Shembujt të cilët nuk kanë për qëllim të kufizojnë shpikjen prezente.
- 20 Shembulli 1: Përgatitja e triflate imidazolium Imidazole dhe acidi trifluoromethanesulfonik u përzien në raportin 1:1 në diklorometane dhe hynë në reaksion në 25° C për 10 minuta siç tregohet
- 25 në skemën më poshtë, më anë të së cilës është përgatitur triflate imidazolium.



Si rezultat i analizës me metoda konvencionale, triflate imidazolium i përftuar kishte karakteristikat e treguara në Tabelën 1.

Tabela 1

Kristale pa ngjyrë

Pika e Shkrirjes : 197 - 198 0C

Analiza elementare


Teoria: C₄H₅F₃N₂O₃S: C, 22.02; H, 2.31; N, 12.84

Gjetja: C, 21.96; H, 2.30; N, 12.74

Asnjë dëshmi lagështie

Shembulli 2: Përgatitja e bazës pjesërisht të pambrojtur të fosforoamidite nucleoside.

- 10 Triflate imidazolium i përfutur në Shembullin 1 u përdor si katalizator, në mënyrë që një bazë pjesërisht e pambrojtur nukleoside të vepronte me cianoetil-bis-amidite, siç tregohet në skemën e reaksionit:



- 20 Nga ky reaksion, katër tipet e fosforoamiditeve nukleoside N-te pambrojtura tregohen në Tabelën 2; pra, u përgatitën përkatësisht fosforoamidite deoksiadenosine, deoksitimidine, deoksiguanosine dhe
- 25 timidine. Siç tregohet në Tabelën 2, fosforoamiditet nucleoside respektive janë fituar pothuajse në sasi.

Table 2

30

B:				
yield, %:	96	98	97	99
purity, %:	>98	>98	>96	>99
³¹ P NMR, ppm:	149.0, 149.1	149.2, 149.3	149.1, 149.2	149.0, 149.1

Shembulli 3: Sinteza e fragmentit të ADN

- 5** Nga 4 tipet e fosforoamiditeve nukleoside N-të pambrojtura të përftuara në Shembullin 2, një fragment ADN 60-mer i përbërë nga një sekuencë nukleotide e SEQ ID NO:1 është sintetizuar nga një metodë sintetike në fazë duke përdorur një
- 10** sintetizues komercial ADN. Cikli i reaksionit tregohet në Tabelën 3.

Hapi	Veprimtaria	Reagenti(tët)	Koha, minuta
15	1 larje	CH ₃ CN	0.50
	2 ditritilim	3%CCl ₃ COOH/CH ₂ CH ₂	1.0x3
	3 larje	CH ₃ CN	2.3
	4 çiftëzim	0.1 Mamidite/CH ₃ CN +0.1 MIMT/CH ₃ CN	0.25
	5 Pritje		1.0
	6 coptimi N-P	0.3 M BIT/CH ₃ CN	0.50
	7 pritje		2.0
	8 larje	CH ₃ CN	0.50
	9 oksidim	1Mt-C4H9))h/CH ₂ Cl ₂	0.25
	10 pritje		1.0
BIT = benzimidazolium triflate; IMT imidazolium triflate			

- 20** Në këtë reaksion sintetik, çdo hap (reaksioni i kondesimit) në zgjatjen e vargut treguar në Tabelën 1 procedon me normë pothuajse 100%, dhe një oligonukleotide fosfati 60-mer pjesërisht i pambrojtur zakonisht përfitohet
- 25** me normë 100%. 10 Kjo normë është tepër e lartë duke patur parasysh që norma e një oligonukleotidi 60-mer të realizuar përgjithësisht me metoda konvencionale është 20 deri 40%.
- 30** Për më tepër, siç tregohet në Fig. 2, u krye zbulimi e eliminimi përmes trajtimit me tretësirë amoniumi 25° C, 60 minuta), kështu që u përftua një ADN 60-mer në normë sasiore.

Analiza e ADN 60-mer të pambrojtur e të papërpunuar nga performance e lartë e kromatografise likuide sipas kushteve të treguara në Tabelën 4 tregon se pastërtia e saj është 95% ose më shumë siç tregohet në Fig. 3.

Kushtet Analitike	
5	
Shtylla Shkalla e prurjes	DEAE- 2.5~ (250 mm)
Temperatura	0.5 mL/min
Eluenti: A	25 0C 20 mM Tris-HCl (pH 9.0)
B	A + 1 M NaCl A :
Gradienti	B (100 : 0) à (50 : 50) linear gradient

10

Siç përshkruhet më sipër me hollësi, metoda e sintetizimit të oligonukleotideve përmes 5 përdorimit të këtij triflate imidazolium ka avantazhet e mëposhtme:

- 15 (1) norma e kondensimit në secilin hap shkon deri në 100%, dhe metoda prezente mund të aplikohet edhe te një sintetizues 10 automatik thjesht duke ndryshuar një program për sintezën dhe reagentët e përdorur, kështu sinteza e një oligonukleotide me
- 20 varg të gjatë të përbërë nga 50 deri 100 nukleotide 15 përgjithsisht e kërkuar në sintezën kimike të ADN etc. është e realizueshme me 1/10 ose më pak të kostove krahasuar me ato të metodave konvencionale;
- 25 2) meqë mund të përdoren fosforoamidite 20 nukleotide të paspecifikuara, metoda prezente ka fushë më të gjerë aplikimi dhe është praktike; dhe
- (3) triflate imidazolium i kësaj shpikje i përdorur
- 30 si përshpejtues, është komponim i 25 qëndrueshëm që nuk absorbon lagështinë, kështu që trajtimi nën kushte të zakonshme për përdorim është shumë i lehtë.

LISTIMI I SEKUENCËS 30 SEQ ID NO: 1

GJATËSIA: 60 BAZA

TIPI: acid nukleik

5 FIJE: teke

TOPOLOGJIA: lineare

TIPI MOLEKULAR:

ADN sintetike

SEKUENCA:

TATGGGCCTT TTGATAGGAT GCTCACCGAG CAAAACCAAG AACAACCAGG AGATTTTATT 60


Pretendimet

1. Metoda për sintezën kimike të një oligonukleotidi përmes metodës fosforoamidite,

Rr. 43(1)(a)
Pretendim i pavarur

- 5 e cila përfshin përgatitjen e një baze pjesërisht të pambrojtur fosforoamiditi nukleosidi nga një bazë pjesërisht e pambrojtur nukleosidi përmes përdorimit të një trifluoromethanesulfonate imidazole e paraqitur nga formula kimike e mëposhtme, dhe çiftëzimit të bazës pjesërisht të pambrojtur
- 10 të sipërpërmendur të fosforoamiditit nukleosid në një renditje të çrregullt të prezencës së trifluoromethanesulfonate imidazole të lartpërmendur për sintetizimin kimik të një oligonukleotidi me përmbajtje të një sekuence specifike nukleotidi.

15



- 20 2. Metoda sipas pretendimit 1, ku baza 25 pjesërisht e pambrojtur e çiftëzuar fosforoamidite nukleosome trajtohet me një tretësirë trifluoromethanesulfonate benzimidazole.

Rr. 43(3), (4)
Pretendim i varur

Abstrakti


Art. 85

Metoda për sintezën kimike të oligonukleotideve

R. 47(1)
Title of invention

Kjo shpikje siguron një metodë praktike të aftë të sintetizojë kimikisht oligonukleotide 100-mer ose të një vargu më të gjatë, në mënyrë të lehtë dhe të sigurt, si edhe një komponim të ri të përdorur në metodën e sipërpërmendur. Shpikja prezente lidhet me një metodë për sintezën kimike të një oligonukleotide përmes metodës fosforoamidite, e cila përfshin përgatitjen e një baze pjesërisht të pambrojtur fosforoamiditi nukleosidi nga një bazë pjesërisht e pambrojtur nukleosidi përmes përdorimit të një trifluoromethanesulfonate imidazole e paraqitur me formulën kimike më poshtë, dhe çiftëzimit të bazës pjesërisht të pambrojtur të sipërpërmendur të fosforoamiditit nukleosid në një renditje të çrregullt të prezencës së trifluoromethanesulfonate imidazole të lartpërmendur për sintetizimin kimik të një oligonukleotidi me përmbajtje të një sekuence specifike nukleotidi po ashtu edhe trifluoromethanesulfonate imidazole të përfaqësuar nga formula kimike.

R. 47(2), (3), (5)
Content of
abstract



Mekanika

Neni 78, 83
Rr. 42
Përshkrimi i
shpikjes

Paisje pedalimi për biçikleta

Titulli i shpikjes
(përcaktimi në
Kërkesën për
Dhënie mjafton)

- 5 Shpikja e prezantuar këtu ka të bëjë me një pajisje pedalimi dhe, më specifikisht, për një pajisje pedalimi për një biçikletë.
- 10 Një pajisje pedalimi konvencionale për një biçikletë në përputhje me njohuritë e mëparshme e treguar në Fig. 10 përbëhet nga një manivelë 60, dy pedale 61, një mekanizëm rrotullues 62, dhe një zinxhir 64.
- 15 Kështu, kur manivela 60 shtyhet nga pedalet 61, mekanizmi rrotullues me dhëmbëza 62 rrotullohet nga manivela 60 për të lëvizur zinxhirin 64 në mënyrë që të lëvizë biçikleta. Megjithatë forca e krahut e përcaktuar midis mesit të mekanizmit rrotullues me dhëmbëza 62 dhe secila prej pedaleve 6 ka një gjatësi më të vogël, kështu që individit që nget biçikletën duhet të ushtrojë një forcë më të madhe shtytëse me pedale 61 në mënyrë që biçikleta të lëvizë, duke harxhuar maksimalisht energjinë dhe punën manuale të individit.

Rr. 42(1)(a)
Fusha teknike
të
c ilës i përket
shpikja

R. 42(1)(b)
Treguesi i
shpikjeve
së mëparshme

Objektivi i shpikjes është të sigurojë një pajisje pedaluese, dhe specifikisht një paisje

- 25 pedaluese për biçikleta, në mënyrë që pedaluesi të kursejë energji gjatë pedalimit.

Rr. 42(1)(c)
Problemi teknik
për t'u zgjidhur

Në përputhje me shpikjen, është prezantuar një paisje pedaluese, e cila përbëhet nga

- 30 aksi mbështetës, një bosht rrotullullimi i montuar në pjesën e parme të aksit mbështetës, një mekanizëm rrotullues i yinxhirit i siguar dhe i rrotulluar nga boshti rrotullimit, 2 mekanizma rrotullues të

Rr. 42(1)(c)
Zbulimi i
shpikjes

dhëmbëzuar të montuar në boshtin rrotullues për të kryer rrotullimin e boshtit, dy akse pedalimi ku skaji ballor i secilit formohet nga një fole për të vendosur mekanizmin rrotullues të dhëmbëzuar

- 5 në mënyrë që të rrotullohet secili mekanizëm në drejtimin e tij dhe skaji fundor ka një shinë, një manivelë të montuar horizontalisht në skajin fundor të aksit mbështetës
- 10 dy boshte kundërta pedales të siguruar në dy anët e kundërta të manivelës për të rrotulluar manivelën, dy pedale secili i montuar në një bosht rrotullues, dhe dy fole për shinat në anët të kundërta secila e montuar horizontalisht në boshtet respektive pedalese për të lëvizur me to dhe secili i montuar shinën përkatëse të boshtit përkatës pedales.

15

Aspekt avantazhues është se akset e pedalaleve kanë një forcë më të fortë lëvizëse midis manivelës dhe mekanizmit rrotullues për rritjen e forcës pedalese, duke kursyer energji dhe punën manuale.

20

Përfitime të mëtejshme dhe avantazhet e kësaj shpikjeje do të bëhen të qartë pas një leximi të kujdesshëm të përshkrimit të detajuar me referencat adekuate mbi skicat korresponduese.

25

Skicat:

*Rr. 42(1)(d)
Përshkrim i
shkurtër
i skicave*

30

Fig. 1 është një pamje në perspektivë e një paisje pedales në përputhje me përfytyrimin e preferuar të kësaj shpikjeje.

Fig. 2 është një perspektivë e imtësishme e çdo pjese të paisjes pedalese siç tregohet në Fig. 1.

Fig. 3 është një perspektive planore e pajisjes pedalese për një biçikletë siç tregohet në Fig. 1.

Fig. 4 është një prerje e tërthortë e paisjes pedaluese siç tregohet në Fig. 1.

Fig. 5 është është një prerje e tërthortë e paisjes pedaluese siç tregohet në Fig. 1.

5 Fig. 6 ë është një prerje e tërthortë e paisjes pedaluese në veprim e sipër e paisjes pedaluese siç është paraqitur në Fig. 1.

Fig. 7 është një pamje e zgjeruar lokalisht e paisjes pedaluese siç është paraqitur në Fig. 6

10 Fig. 8 është një pamje skematike operacionale e paisjes pedaluese siç është paraqitur në Fig. 6

Fik. 9 është një pamje skematike operacionale e paisjes pedaluese siç është paraqitur në Fig. 7

Fik. 10 është një pamje në perspektivë e një paisjeje pedaluese për një biçikletë në

15 përputhje me shpikjet e mëparshme.

Duke iu referuar vizatimeve dhe fillimisht Fig.1-7, një pajisje pedaluese 20 për një biçikletë 10, në përputhje me përftytyrimin e preferuar të kësaj

20 shpikjeje përbëhet nga aksi mbështetës 13, një boshti i rrotullimit 111 i montuar në pjesën e parme të aksit mbështetës 13, një mekanizëm rrotullues i zinxhirit 11 i montuar mbi dhe i rrotulluar nga

25 boshti i rrotullimit 111, 2 mekanizma rrotullues të dhëmbëzuara 40 të montuar në boshtin e rrotullimit 111 për të kryer rrotullimin e boshtit 111, 2 akse pedalimi 30 ku skaji ballor i secilit formohet nga një fole për të vendosur mekanizmin rrotullues të dhëmbëzuar 40 në mënyrë që të rrotullohet secili mekanizëm në drejtimin e tij dhe skaji fundor ka një

30 shinë 35, një manivelë 12 të montuar horizontalisht në skajin fundor të aksit mbështetës 13 dy boshtet e kundërta pedalues 141 të siguruar në dy anët e kundërta të manivelës 12 për të rrotulluarmanivelën 12, dy pedale 14 secili i montuar në njërin nga

*Rr. 42(1)(e)
Përshkrimi i së
paku
nje menyre të
realizimit të
shpikjes*

boshtet e pedalit 141, dhe dy fole 50 për shinat në anët të kundërta secila e montuar horizontalisht në boshtet respektive pedalues 141 për të lëvizur me to dhe secili i montuar në shinën 35 përkatëse të boshtit përkatës pedalues

5 30.

Skajet e boshtit të rrotullimit 111 fiksohen me bulona heksagonale 112 dhe vidë të dhembëzuar 113.

10

Secili prej manivelave 40 përfshin një pjesë të brendshme 45 heksagonale 42 e siguruar me bulona heksagonale 112 për të rrotulluar boshtin rrotullues 111, një pjesë të jashtme 43

- 15** e montuar në mënyrë të rrotullueshme në pjesën e brendshme, 45 me një manivelë të jashtme lëvizëse, 41 një manivelë të brendshme me disa kanale mbyllëse 430, disa frena 44 të gjitha të kapura në mënyrë
- 20** boshtore në pjesën e brendshme 45 dhe pjesa e pasme e angazhuar për të frenuar 43.

Foleja e manivelës 31 e secilit mekanizmi pedalues 30 ka një mur të brendshëm me një marsh 41 pedalues 311

- 25** i cili ingranohet me rrotën përkatëse 40 për të rrotulluar mekanizmin rrotullues. Foleja e manivelës 31 e secilës prej mekanizmave pedalues 30 kombinohet me manivelën rrespektive 40 dy unaza vulosëse të cilat
- 30** ndodhen në anë të kundërta të folesë së manivelës 31 së secilit prej mekanizmave pedalues 30 të cilat mbylLEN me disa përçina 33.

Pajisja pedaluese 20 permban edhe dy rondere 37 secila e montuar mbi një bulon 113 i cili i përket boshtit rrotullues 111 dhe secila e mbështetur në mekanizëm rrotullues të dhëmbëzuar 40, dhe dy vida 34 secila e lidhur me një bulon të veçantë 113 të boshtit rrotullues 111 dhe të fiksuara me rondelen rrespektive 37.

5

Në skajin fundor të aksit mbështetës 13 ndodhet një

10 fole horizontale 131. Manivela 12 montohet brënda kësaj foleje 131 të aksit mbështetës 13. Secila prej të dyja anëve të manivelës 12 fiksohet me një vidë 121.

15 Secili prej dy boshteve të pedalit 141 fiksohet me manivelëm 12 me anë të një vide 121.

Secila prej foleve to shinave 50 fiksohen nga njëri skaj me dy kushineta 51 të montuara në shinat 35

20 përkatëse të akseve të pedaleve 30 dhe skajin tjetër të pajisur me një fole 52 për montimin e dy kushinetave shtesë 53 të cilat janë montuar horizontalisht mbi aksin e pedalit 141. Kushineta e parë 51 e secilës prej dy foleve të shinave 50

25 janë të fiksuara në shinën përkatëse 35 të aksit të pedalit 30 me anë të një kapaku 36 i montuar në skajin e hapur të shinës 35 për të ndaluar kushinetat e para 51 të çmontohen nga aksi i

30 pedalit përkatës. 30

Gjatë lëvizjes, duke iu referuar fig. 1-9, kur pedalet 14 janë në lëvizje, manivela 12 rrotullohet për të lëvizur dy foletë e shinave 50 të cilat

lëvizin lart dhe poshtë për të ndihmuar akset e pedaleve 30 të kthehen poshtë ose lartë siç është paraqitur në Fig. 6, në mënyrë që foleja e dhëmbëzuar 31 e secilit prej akseve të pedaleve 30 të rrotullohet për të rrotulluar mekanizmat rrotullues të dhëmbëzuar 40.

5

Siç është paraqitur edhe në Fig. 7, kur njëri nga akset e pedalit 30 lëviz poshtë, mekanizmi respektiv rrotullues i dhëmbëzuar 40 rrotullohet në sens orar për të lëvizur pjesën e jashtme 43 në këtë moment pengesat një anëshe 44 të secilës prej mekanizmave

10

rrotullues të dhëmbëzuar 40 hynë në kanalet bllokuese 430 të pjesës së jashtme 43, në mënyrë që pjesa e brendshme 45 të ngitet dhe duke u rrotulluar ngap pjesa e jashtmen 43 të rrotullojë folenë fiksuese 42 e cila rrotullon bulonin fiksues 112 të boshtit të rrotullueshëm 111 në mënyrë që të rrotullojë

15

boshtin e rrotullimit 111. Si pasojë, kur mekanizmi i rrotullueshëm i dhëmbëzuar 40 rrotullohet në sens orar, boshti i rrotullimit 111 rrotullon mekanizmin e zinxhirit 11 për të vënë në lëvizje biçikletën.

Nga ana tjetër, kur një nga akset e pedalit 30

20

rrotullohet lart siç tregohet në Fig. 8, mekanizmi respektiv rrotullues i dhëmbëzuar 40 rrotullohet në sens kundërorar për të lëvizur pjesën e jashtme 43 siç tregohet në Fig. 9. Në këtë moment, pengesat një anëshe 44 të secilës prej mekanizmave rrotullues të dhëmbëzuar 40 hynë në kanalet bllokuese 430

20

të pjesës së jashtme 43, në këtë mënyrë pjesa e jashtme 43 kryen një rrotullim në vend. Si pasojë, kur mekanizmi rrespektiv i dhëmbëzuar 40 rrotullohet në sens kundërorar, boshti i rrotullimit 111 ndalon së rrotulluari, në mënyrë që mekanizmi me zinxhir të

30

ndalojë së rrotulluari.

Nga ana tjetër, kur një nga akset e pedalit 30 rrotullohet lart siç tregohet në Fig. 8, aski tjetër 30 ulet poshtë siç tregohet në

Fig. 6, në mënyrë që mekanizmi i zinxhirit 11 të mundësojë lëvizjen e biçikletës me sukses.

Në përputhje me sa u tha më lartë, akset e pedaleve 30 kanë një forcë më të madhe

- 5** shtytëse midis manivelës 12 dhe mekanizmit të zinxhirit 11 në mënyrë që të rrisin momentin e forcës së paisjes pedalue 20 që individit të lëvizë pedalet 14 në një mënyrë sa më efektive përsa i përket energjisë së harxhuar për pedalim, duke kursyer kështu energjinë dhe mundin e individit që nget biçikletën.

10

Edhe pse shpikja është shpjeguar në lidhje me përfytyrimin e preferuar të përmendur sa më lartë, duhet të kuptohet se kësaj shpikjeje mund ti bëhen shumë modifikime dhe

- 15** ndryshime pa u larguar nga fusha e shpikjes në fjalë. Është, pra, e parashikuar se pretendimi apo pretendimet e bashkëngjitura do të mbulojnë ndryshime dhe variacione të tilla që bien në fushëveprimin e vërtetë të kësaj shpikjeje.

1. Një paisje pedaluese, që perfshin:
një aks mbështetës (13),
- 5 një bosht rrotullimi (111) i montuar në pjesën e parme të aksit mbështetës (13), një mekanizëm për zinxhirin (11) i montuar mbi dhe i rrotulluar nga boshti i rrotullimit (111), 2 mekanizma rrotullues të dhëmbëzuar (40) të montuar
- 10 në boshtin rrotullues (111) për të kryer rrotullimin e boshtit (111), 2 akse pedalesh (30) ku skaji ballor i secilit formohet nga një fole për të vendosur mekanizmin rrotullues të dhëmbëzuar (40) në mënyrë që të
- 15 rrotullohet secili mekanizëm në drejtimin e tij dhe skaji fundor ka një shinë (35) ,
një manivelë (12) të montuar horizontalisht në skajin fundor të aksit mbështetës (13)
- 20 dy boshte të kundërta pedaluese (141) të siguruar në dy anët e kundërta të manivelës (12) për të rrotulluar manivelën (12),
dy pedale (14) secili i montuar në një boshti i rrotullimit (141),
- 25 dhe dy fole për shinat (50) në anët të kundërta secila e montuar horizontalisht në boshtet respektive pedaluese (141) për të lëvizur me to dhe secili i montuar në shinën (35) përkatëse të boshtit përkatës pedalues (30)

2. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 1, ku:

*Rr. 43 (3), (4)
Pretendim i varur*

Skajet e boshtit të rrotullimit (111) fiksohen me bulona heksagonale (112) dhe vidë

- 5** të dhëmbëzuar (113). Secili prej manivelave (40) përfshin një pjesë të brendshme (45) heksagonale (42) e siguruar me bulona heksagonale (112) për të rrotulluar boshtin
- 10** e rrotullimit (111), një pjesë të jashtme (43) e montuar në mënyrë të rrotullueshme në pjesën e brendshme, (45) me një manivelë të jashtme lëvizëse, (41) foleja e manivelës (31) e secilit mekanizmi pedalues (30) ka një mur të brendshëm me një marsh (41) pedalues (311) i cili ingranohet me
- 15** rrotën përkatëse (40) për të rrotulluar mekanizmin rrotullues. (40)

3. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 2,

- 20** përfshin më tej dy rrodet (37) secila e montuar në bulonin përkatës (113) të boshtit të rrotullimit (111) dhe secila e vendosur në një mekanizëm të rrotullueshëm të dhëmbëzuar (40) dhe dy unaza shtrënguese (34) secila e montuar në bulonin përkatës (113) të boshtit të rrotullimit
- 25** (111) dhe secila e mbyllur me rondelen respektive (37).

4. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 2, ku foleja e dhëmbëzuar (31) e secilit prej akseve të pedaleve (30) është e kombinuar me mekanizmin rrotullues

- 30** të dhëmbëzuar (40) me dy unazat guarnicioni të kundërta (32).

5. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 4, ku unazat e guarnicionit (32) janë vendosur në të dy anët e kundërta të folesë së dhëmbëzuar (31) të

secilit prej akseve të pedalve (30) të lidhur nga një mori thumbash (33).

6. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 1,
5 Secila prej foleve to shinave (50) fiksohet nga njëri skaj me dy kushineta (51) Të montuar në shinat (35) përkatëse të akseve të pedaleve (30) dhe skajin tjetër të pajisur me një fole (52) për montimin e dy kushinetave
10 shtesë (53) të cilat janë montuar horizontalisht mbi aksin e pedalit (141).

7. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 6,
Kushineta e parë (51) e secilës prej dy foleve
15 të shinave (50) janë të fiksuara në shinën përkatëse (35) të aksit të pedalit (30) me anë të një kapaku (36) të montuar në skajin e hapur të shinës (35) për të ndaluar kushinetat e para (51) të çmontohen nga
20 aksi i pedalit përkatës. (30)

8. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 1,
Skaji fundor i boshtit të rrotullimit (13) formohet nga një fole në qendër (131), dhe manivela (12)
25 është montuar horizontalisht me folenë në qendër (131) të boshtit të rrotullimit (13).

9. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 1,
Secila prej të dyja anëve të manivelës (12) fiksohet
30 me një vidë (121). Secili prej dy boshteve të pedalit (141) fiksohet me manivelën (12) me anë të një vide (121).

10. Paisja pedaluese në përputhje me pretendimin 1, Secila prej foleve të dhëmbëzuara (40) ka një manivelë të brendshme me disa

- 5** kanale bllokuese (430), dhe secila nga foletë e dhëmbëzuara ka disa frena (44) të gjitha të kapura në mënyrë boshtore me kanalet mbyllëse (45) të pjesës së pasme (43) ku pjesa e jashtme e secilit prej mekanizmave rrotullues të dhëmbëzuar (40) ka një mur të brendshëm formuar me një mori brazdash bllokuese (430), për bllokimin e pjesës së jashtme.

Abstrakt


Neni 85

Paisje pedaluese për biçikleta

Rr. 47(1)
Titulli i
shpikjes

një aks mbështetës (13), një bosht rrotullimi (111),
një mekanizëm për zinxhirin (11), 2 mekanizma
rrotullues të dhëmbëzuar (40), 2 akse pedalesh
(30), një manivelë (12), dy pedale (14), 2 boshte
pedaluese të kundërta (141), dhe dy fole për shinat
(50) Prandaj akset e pedalaleve kanë një forcë më
të fortë lëvizëse midis manivelës dhe mekanizmit
rrotullues për rritjen e forcës pedaluese, duke
kursyer energji dhe punën manuale.

Rr. 47(2),
(3), (5)
Përmba-
jtja e
abstraktit






FIG. 1




FIG. 4




FIG. 3




FIG. 5




FIG. 6




FIG. 7




FIG. 8




FIG. 9




FIG. 10
PRIOR ART

Informatika

Neni 78, 83
Rr. 42
Përshkrimi i
shpikjes

Metoda dhe aparati për të ndryshuar faqet në ekranët me teknologjinë me prekje të paisjeve elektronike

Titulli i shpikjes
(përcaktimi në
Kërkesën për
Dhënie
mjafton)

5 HISTORIKU I SHPIKJES

Fusha e shpikjes

Shpikja në fjalë ka të bëjë me një ekran me teknologjinë me prekje, dhe

Rr. 42(1)(a)
Fusha teknike
të
c ilës i përket
shpikja

- 10 më veçanërisht me një metode dhe një aparat për kalimi nga një faqe tek tjetra me ekran me teknologjinë me prekje të paisjeve elektronike.

Përshkrimi shpikjeve të mëparshme

15

Një ndërfaqe operationale të dhënash është një pjesë elektronike e nevojshme për një paisje elektronike. Ka numra, karaktere, simbole fonetike, rrënjë për metodat e të dhënave, dhe modele të ndryshme funksionale të regjistruara

R. 42(1)(b)
Treguesi i
shpikjeve
së mëparshme

- 20 në ndërfaqen operationale të të dhënave. Për këtë arsye, përdoruesit mund të hedhin të dhëna, të përdorin shumë funksione të paisjes elektronike duke përdorur ndërfaqen operationale të të dhënave.

- 25 Në të kaluarën, shumica e ndërfaqeve operationale të të dhënave të paisjeve elektronike funksiononin sipas strukturës butoni - me prekje. Aktualisht, në mënyrë që të zmadhojmë sipërfaqen e lundrimit të ekranit me kristale të lëngshme, një pjesë e butonave janë zëvendësuar me

- 30 panel me prekje i cili është instaluar në ekranin me kristale të lëngshme.

Prandaj përdoren njëkohësisht ndërfaqja me butona touch dhe ndërfaqja me panelin touch.

Megjithatë, përdoruesit zakonisht kanë nevojë për të përdorur më shumë se një buton ose të

*Rr. 42(1)(c)
Problemi teknik
për t'u zgjidhur*

- 5 prekin panelin touch disa herë të kalojnë nga njëara faqe në tjetrën. Një veprim i cili këron disa hapa nuk është i volitshëm për përdoruesin, sidomos për ata që janë duke ngarë makinën

10 PËRMBLEDHJE E SHPIKJES

Në përputhje me rrethanat, qëllimi kryesor i shpikjes në fjalë është që të sigurojë një panel me prekje që është instaluar në një ekran me kristale të lëngshme dhe një sipërfaqe

*Rr. 42(1)(c)
Zbulimi i
shpikjes*

- 15 e panelit me prekje është më e madhe se ajo e ekranit me kristale të lëngshme. Një sipërfaqe kryesore me prekje është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje dhe ekranit me kristale të lëngshme, ndërsa një sipërfaqe e dytë me prekje është përcaktuar si një pjesë jo-e mbivendosur e panelit
- 20 me prekje dhe ekranit me kristale të lëngshme. Për më shumë, një veprim për ndërrimin e faqes është përcaktuar si një veprim ``prek dhe tërhiq`` nga pika A në pikën B të një sipërfaqeje me prekje ose si një veprim ``prek dhe tërhiq`` nga pika B në pikën A të një
- 25 sipërfaqeje me prekje. Për këtë arsye, veprim i ndërrimit të faqeve mund të operohet me shpejtësi nga përdoruesit.

Për të arritur objektivin e përmendur më lart,

- 30 shpikja në fjalë ofron një mënyrë për të ndryshuar faqet në ekranët me teknologjinë me prekje të paisjeve elektronike. Kjo paisje përmban një ekran me kristale të lëngshme dhe një panel me prekje. Një sipërfaqe kryesore me prekje është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje

dhe ekranit me kristale të lëngshme, ndërsa një sipërfaqe e dytë me prekje është përcaktuar si një pjesë jo-e mbivendosur e panelit me prekje dhe

5 ekranit me kristale të lëngshme.

Për të arritur objektivin e përmendur më lart, shpikja në fjalë mundëson një metodë për ndërrimin e faqeve në një ekran me prekje të një aparature elektronike.

10 Metoda e ndërrimit të ekraneve përfshin: së pari, metoda përcakton nëse fillimisht ka ndodhur një veprim 'prek dhe tërhiq' duke tërhequr gishtin nga zona primare ose sekondare e ekranit me prekje. Më pas, metoda ekzekuton një ndërrim faqesh kur veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht

15 duke tërhequr gishtin nga zona primare me prekje dhe veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin nga zona primare tek zona sekondare me prekje. Në fund, metoda krijon mundësinë

20 për tu kthyer tek faqja e mëparshme duke rrëshqitur gishtin nga zona sekondare tek zona primare me prekje. Prandaj, veprimi për ndërrimin e faqes është i lehtë për përdoruesin.

25

Duhet të kuptohet se të gjitha shpjegimet e deritanishme dhe shpjegimet më të detajuara që do të pasojnë janë shprehimisht rezultatet e dëshiruara të pritshme, dhe se qëllimi i tyre është të japin sa më shumë shpjegime të shpikjes në fjalë sipas

30 pretendimeve. Avantazhe apo funksione të tjera të kësaj shpikjeje do të dalin në pah nga përshkrimi, skicat dhe pretendimet.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I VIZATIMEVE

*Rr. 42(1)(d)
Përshkrim i
shkurtër
i skicave*

- Tiparet e shpikjes të cilat besohet të jenë risi janë të përcaktuara me detaje në pretendimet e ngritura më poshtë. Vetë shpikja, mund të kuptohet më mirë duke iu referuar dhe duke lexuar pretendimet e përshkruara në mënyrë të detajuar, e cila përshkruan shprehimisht rezultatin e dëshiruar të pritshëm duke marrë gjithashtu në konsideratë dhe figurat, të cilat tregojnë:
- 5** Fig. 1A është një pamje skematike e një aparati elektronik sipas shpikjes në fjalë;
Fig. 1B dhe Fig. 1C janë pikëpamjet skematike të ndërrimit të faqeve të
- 10** aparatit elektronik
Fig. 2 është një skemë e një paneli me prekje të aparatit elektronik në fjalë
Fig. 3 është një pamje skematike e ekzekutimit të një veprimi me gisht 'prek dhe tërhiq' në
- 15** panelin me prekje
Fig. 4 është një tjetër pamje skematike e ekzekutimit të një veprimi me gisht 'prek dhe tërhiq' në panelin me prekje
Fig. 5 është një pamje skematike e koordinatave të panelit me prekje
- 20** Fig. 6 është një pamje skematike e disa koordinatave të drejtuara në distancë; dhe
Fig. 7 është një pamje skematike e veprimit të tërheqies së gishtit nga një koordinatë fillestare në një
- 25** koordinatë përfundimtare
- 30**

PËRSHKRIMI I DETAJUAR I SHPIKJES

*Rr. 42(1)(e)
Përshkrimi i së
paku
nje menyre të
realizimit të
shpikjes*

- Së bashku me vizatimet bashkangjitur, përmbajtja teknike dhe përshkrimi i detajuar i shpikjes
- 5** në fjalë shpjegohen si më poshtë në lidhje me rezultatin e dëshiruar të pritshëm, por nuk duhen përdorur për të limituar qëllimin ekzekutiv të shpikjes. Çdo ndryshim dhe modifikim i barazvlefshëm, i bërë sipas pretendimeve për këtë shpikje, është i përfshirë tek pretendimet e bëra
- 10** për shpikjen në fjalë.

Në mënyrë që të përshkruajmë shpikjen në fjalë në detaje do përdorim si referencë figurat e prezantuara më poshtë.

- 15** Fig. 1A e cila është një pamje skematike e një aparati elektronik në përputhje me
- Shpikjen në fjalë. Aparati ka një ekran me kristale të lëngshme të pranishëm 2 dhe nje panel me prekje 3. Një sipërfaqe e panelit me prekje 3 është më e
- 20** madhe se ajo e ekranit me kristale të lëngshme 2. Një sipërfaqe kryesore me prekje 31 është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje 3 dhe ekranit me kristale të lëngshme 2, ndërsa një sipërfaqe e dytë me prekje 32 është përcaktuar si një pjesë jo-mbivendosur e e panelit me prekje 3 dhe
- 25** ekranit me kristale të lëngshme 2. Sipërfaqja kryesore me prekje 31 është e ndarë nga sipërfaqja dytësore me prekje 32 nga një vijë anësore dhe kjo vijë anësore kryhen funksionin e një kufiri 311 midis të dy këtyre sipërfaqeve. Sipërfaqja me prekje 32
- 30** përbëhet nga zona 1 me prekje 321, zona 2 me prekje 322, zona 3 me prekje 323 dhe zona 4 me prekje 324 dhe këto katër zona me prekje (321, 322, 323, 324) janë të rrethuara nga zona kryesore me prekje, rrespektivisht zona 1 me prekje 321, zona 2 me prekje 322, zona 3 me prekje 323 dhe zona 4 me

prekje 324 janë të vendosura rrespektivisht në anët e sipërfaqes dytësore me prekje 32 (sipër, poshtë, majtas dhe djathtas). Veprimi i ndërrimit të faqes

- 5 kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin nga zona primare me prekje 31 dhe veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin nga zona primare 31 tek zona sekondare me prekje 32. Prandaj, veprimi për ndërrimin e faqes është i
- 10 lehtë për përdoruesin.

Fig. 1B dhe Fig. 1C janë pikëpamjet skematike të ndërrimit të faqeve të aparatit elektronik. Për shembull, Faqja A shfaqet

- 15 në ekranin me kristale të lëngshme (treguar në Fig. 1B). Faqja A do të ndërrohet me Faqen B (treguar në Fig. 1C) kur të ndodhë veprimi 'prek dhe tërhiq' duke rrëshqitur gishtin nga sipërfaqja kryesore me prekje 31 tek zona 2 me prekje 322 të sipërfaqes
- 20 dytësore me prekje 32. Faqja B mund të ndërrohet në Faqjen A kur të ndodhë veprimi 'prek dhe tërhiq' duke rrëshqitur gishtin nga zona 2 me prekje 322 të sipërfaqes dytësore me prekje 32 tek sipërfaqja kryesore me prekje 31. Në rezultatin e dëshiruar të
- 25 shpikjes, këto faqe mund të jenë direktori të disa shtresave, faqe interneti apo materiale grafike.

Fig. 2 deri në Fig. 4 të cilat janë rrespektivisht një skemë e një paneli me prekje të aparatit

- 30 elektronik në fjalë, një pamje skematike e ekzekutimit të një veprimi me gisht 'prek dhe tërhiq' në panelin me prekje dhe një tjetër pamje skematike e ekzekutimit të një veprimi me gisht 'prek dhe tërhiq' në panelin me prekje. Fillimisht, metoda përcakton nëse fillimisht ka ndodhur një

veprim 'prek dhe tërhiq' duke tërhequr gishtin 4 nga zona primare ose sekondare e ekranit me prekje 3 (100). Më pas, metoda përcakton nëse zona kryesore me prekje 31 ose zona dytësore

5 me prekje 32 (secila nga 4 nën zonat e saj) janë prekur kur gishti 4 bën kontakt me panelin me prekje 3. Pas hapit 102, zona kryesore me prekje 31 preket (104). Më pas, metoda përcakton nëse ka ndodhur një veprim 'prek dhe tërhiq' ka ndodhur duke e rrëshqitur

10 gishtin nga zona kryesore me prekje 31 tek zona dytësore me prekje 32 (106). Më pas, metoda ekzekuton një ndërrim faqesh (108) kur veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin nga zona primare me prekje 31 tek zona sekondare

15 me prekje 32. Më pas, metoda përcakton nëse ka ndodhur një veprim 'prek dhe tërhiq' ka ndodhur duke e rrëshqitur gishtin nga zona kryesore me prekje 31 tek zona dytësore me prekje 32 (108). Më pas, metoda ekzekuton një ndërrim faqesh (108) kur veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin nga zona primare

20 me prekje 31 tek zona sekondare me prekje 32. Më pas, metoda përcakton nëse veprimi 'prek dhe tërhiq' është kryer nga zona sekondare me prekje 32 për të shkuar prapa tek zona kryesore me prekje 31. Nëse jo, faqja kthehet pas tek faqja e mëparshme (112) kur veprimi 'prek dhe tërhiq' vjen nga zona sekondare 32 tek

25 zona primare me prekje 31. Për më tepër, një veprim vetëm prekje ndodh (114) nga zona primare me prekje 31 tek zona sekondare me prekje 32.

30 Gjithashtu, zona sekondare me prekje 31 preket (116) pas hapit (102). Me pas, metoda përcakton nëse veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke tërhequr

gishtin nga zona sekondare me prekje 32 tek zona primare me prekje 31 (118). Më pas, ndodh ndërrimi i fageve kur veprimi 'prek dhe tërhiq' vjen nga zona sekondare 32 tek zona primare me prekje 31 (120). Më pas, metoda përcakton nëse ka ndodhur

- 5 një veprim 'prek dhe tërhiq' duke e rrëshqitur gishtin nga zona kryesore me prekje 31 për ty kthyer tek zona dytësore me prekje 32 (122). Hapi (120) ekzekutohet përsëri kur veprimi nuk ndodh duke rrëshqitur gishtin nga zona kryesore me prekje 31 për ty kthyer
- 10 tek zona dytësore me prekje 32. Nëse jo, faqja kthehet pas tek faqja e mëparshme (124) kur veprimi 'prek dhe tërhiq' vjen nga zona kryesore 31 për ty kthyer tek zona sekondare me prekje 32.

15

Fig. 5 është një pamje skematike e koordinatave të panelit me prekje. Në këtë shembull, një ekran me kristale të lëngshme 2 me $240 * 320$ pixel dhe një panel me prekje 3 me $280 * 360$ pixel janë ilustruar

- 20 për të demonstruar më tej shpikjen në fjalë. Paneli me prekej 3 është i instaluar në ekranin me kristale të lëngshme 2. Një sipërfaqe kryesore me prekje 31 është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje 3 dhe ekranit me kristale të lëngshme 2, ndërsa një sipërfaqe e dytë

- 25 me prekje 32 është përcaktuar si një pjesë jo-e mbivendosur e panelit me prekje 3 dhe ekranit me kristale të lëngshme 2. Sipërfaqja me prekje 32 përbëhet nga zona 1 me prekje 321, zona 2 me prekje 322, zona 3 me prekje 323 dhe zona 4 me prekje 324 dhe këto katër zona me prekje (321, 322, 323, 324) janë të rrethuara nga zona kryesore me prekje, rrespektivisht zona 1 me prekje 321, zona 2 me prekje 322, zona 3 me prekje 323 dhe zona 4 me prekje 324 janë të vendosura rrespektivisht në
- 30 anët e sipërfaqes dytësore me prekje 32 (sipër, poshtë, majtas dhe djathtas) dhe ka një gjerësi prej 20 pixela. Për më tepër, koordinatat e zonës

dytësore me prekje 32 janë $(-20, -20)$, $(260, -20)$, $(-20, 340)$, dhe $(260, 340)$ përkatësisht, dhe katër koordinatat të zonëskryesore me prekje janë $(0, 0)$, $(240, 0)$, $(0, 320)$, dhe $(240, 320)$, përkatësisht.

5 Fig. 6 është një pamje skematike e disa koordinatave të drejtuara në distancë. Një pikë prekje gjenerohet kur gishti i përdoruesit prek panelin me prekje 3, dhe pika e prekjes 30 përfaqësohet nga koordinatat (X, Y) .

10

Pika e prekjes 30 përcaktohet se është në zonën kryesore me prekje 31 kur $(0 \leq X \leq 240$ dhe $0 \leq Y \leq 320)$. Për shembull, $(X, Y) = (1, 1)$ është përcaktuar për të qenë në zonën kryesore me prekje 31, për shkak të $0 \leq (X = 1) \leq 240$ dhe

15 $0 \leq (Y = 1) \leq 320$.

Pika e prekjes përcaktohet në zonën 3 me prekje 323 e zonës dytësore me prekje 32 kur $(0 < X$ dhe $0 \leq Y \leq 320)$. Për shembull, $(X, Y) = (-5, 5)$

20 është përcaktuar të jetë në zonën 3 me prekje 323, për shkak të $0 < (X = -5)$ dhe $0 \leq (Y = 5) \leq 320$.

Pika e prekjes 30 përcaktohet në zonën 4 me prekje 324 e zonës dytësore me prekje 32 kur

20 $(X > 240$ dhe $0 \leq Y \leq 320)$. Për shembull, $(X, Y) = (250, 5)$ është përcaktuar të jetë në zonën 4 me prekje 324, për shkak të $(X = 250) > 240$ dhe $0 \leq (Y = 5) \leq 320$.

Pika e prekjes 30 përcaktohet të jetë në zonën 1 me prekje 321 të zonës dytësore me prekje 32 kur $(Y < 0)$. Për shembull, $(X, Y) = (120, -5)$ është përcaktuar të jetë në zonën 1 me prekje 321, për shkak të $(Y = -5) < 0$.

25

Pika e prekjes 30 përcaktohet të jetë në zonën 2 me prekje 322 të zonës dytësore me prekje 32, kur $(Y > 320)$. Për shembull, $(X, Y) = (120, 325)$ është përcaktuar të jetë në zonën 2 me prekje 322, për
5 shkak të $(Y = 325) > 320$.

Fig. 7 është një pamje skematike e veprimit të tërheqies së gishtit nga një koordinatë fillestare një një koordinatë përfundimtare. Për shembull,

10 koordinata fillestare përcaktohet në fillim në zonën 2 me prekje 322 të zonës dytësore me prekje 32 kur gishti 4 i përdoruesit prek si fillim koordinatat pikën $(X, Y) = (120, 330)$. Për më tepër, koordinata fillestare regjistrohet

25 gjithashtu. Një pikë koordinate $(X, Y) = (120, 325)$ e pikë prekjes 30 përcaktohet dhe rikthehet kur gishti 4 lëviz në drejtim për lart dhe nëse prek koordinatën $(X, Y) = (120, 325)$. Çdo veprim ndërrimi faqeje nuk është ekzekutuar për shkak se koordinatat $(X, Y) =$

20 $(120, 325)$ është ende e përcaktuar në zonën 2 me prekje.

Koordinatat $(X, Y) = (120, 319)$ e pikë prekjes 30 përcaktohet dhe rikthehet kur gishti 4 lëviz

25 vazhdimisht dhe prek koordinatat $(x, y) = (120, 319)$. Një koordinatë fundore $(X, Y) = (120, 319)$ është e regjistruar kur gishti 4 ndalon lëvizjen dhe largon gishtin nga paneli 3. Me pas, një veprim 'prek dhe tërhiq' përcaktohet se ka ndodhur

30 nga zona sekondare me prekje 32 për të shkuar prapa tek zona kryesore me prekje 31 sipas koordintës fillestare. Si pasojë ndodh veprimi i ndërrimit të faqes.

Rr. 43 (13), (a)
Pretendimet
mbi egzistencën
eshpikjeve të
mëparshme
ku është e
përshtatshme

1. Një metodë për të ndërruar ekranet me prekje të
5. një aparature elektornike (1) dhe aparati elektronik (1) ka një panel me prekje (3) dhe një ekran me kristale të lëngshme (2), një sipërfaqe e panelit me prekje (3) është më e madhe se ajo e ekranit me kristale të lëngshme (2), një sipërfaqe kryesore me prekje katrore
- 10 (31) është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme, ndërsa njësipëraqe e dytë me prekje (32) është përcaktuar si një pjesë jo- e mbivendosur e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme (2)
- 15 Metodë për ndërrimin e faqeve në ekran e cila:
- a. metoda përcakton nëse fillimisht ka ndodhur një veprim 'prek dhe tërhiq' duke tërhequr gishtin nga zona primare (31) ose sekondare (32) e ekranit me prekje.
- 20 b. veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin (4) nga zona primare me prekje (31) dhe veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin (4) nga zona primare (31) tek
- 25 zona sekondare (32) me prekje.
- c. Ekzekuton një ndërrim faqesh ku veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin (4) nga zona primare (31) tek zona sekondare (32) me prekje dhe më pas veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur
- 30 gishtin (4) nga zona sekondare (32) tek zona primare (31) me prekje
2. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 1, gjithashtu përfshin mundësinë për tu kthyer tek

faqja e mëparshme duke rrëshqitur gishtin (4) nga zona sekondare (32) tek zona primare (31) me prekje. pas hapit b.

5

3. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 1, gjithashtu përfshin mundësinë për tu kthyer tek faqja e mëparshme duke rrëshqitur gishtin (4) nga zona primare (31) tek zona sekondare (32) me prekje. pas hapit c.

10

4. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 1, gjithashtu përfshin ekzekutimin e një veprimi me prekje duke rrëshqitur gishtin (4) tek zona primare (31) gjatë hapit b.

15

5. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 1, ku sipërfaqja me prekje (32) përbëhet nga zona 1 me prekje (321), zona 2 me prekje (322), zona 3 me prekje (323) dhe zona 4 me prekje (324).

20

6. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 5 Zonat me prekje 1, 2, 3, dhe 4 (321, 322, 323, 324) janë të rrethuara nga zona kryesore me prekje,

25

7. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 6 më tej përcakton koordinatat e zonës 1 me prekje (321), zonës 2 me prekje (322), zonës 3 me prekje (323) dhe zonës 4 me prekje (324)

30

8. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 7, ku një veprim 'prek dhe tërhiq' është përcaktuar si prekja e cila fillon në panelin me prekje (3) dhe tërhiqet vazhdimisht nga koordinata fillestare në koordinatën përfundimtare të panelit me prekje (3)
9. Metoda e ndërrimit sipas pretendimit 7, veprimi 'prek dhe tërhiq' quhet i përfunduar në bazë të koordinatës fillestare dhe koordinatës fundore.
10. Një aparat për ndërrimin e ekranit të një paisjeje elektronike 1, ku aparati ka si pjesë përbërëse një ekran me kristale të lëngshme të pranishëm (2) dhe një panel me prekje (3). Një sipërfaqe e panelit me prekje (3) është më e madhe se ajo e ekranit me kristale të lëngshme (2). Një sipërfaqe kryesore me prekje 31 është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme (2), ndërsa një sipërfaqe e dytë me prekje (32) është përcaktuar si një pjesë jo-e mbivendosur e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme (2).
- Veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin (4) nga zona primare me prekje (31) dhe veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin nga zona primare (31) tek zona sekondare me prekje (32).
11. Aparatura e ndërrimit sipas pretendimit 10, zona kryesore me prekje (31) është e ndarë nga sipërfaqja dytësore me prekje (32) nga një vijë anësore dhe kjo

vijë anësore kryhen funksionin e një kufiri (311) midis të dy këtyre sipërfaqeve.

5. 12. Aparatura e ndërrimit sipas pretendimit 10 Zona krzesore me prekje (31) dhe zona dytësore me prekje 32 janë të dyja pjesë e panelit me prekje (3).

13. Aparatura e ndërrimit sipas pretendimit 10

- 10 Sipërfaqja me prekje (32) përbëhet nga zona 1 me prekje (321), zona 2 me prekje (322), zona 3 me prekje (323) dhe zona 4 me prekje (324)

Abstrakt

Neni 85

Rr. 47(1)
Titulli i
shpikjes

Metoda dhe aparati për të ndryshuar faqet në ekranët me teknologjinë me prekje të paisjeve elektronike

Rr. 47(2), (3),
(5)
Përmbajtja e
abstraktit

Metoda dhe aparati për të ndryshuar faqet në ekranët me teknologjinë me prekje të paisjeve elektronike (1) ka si përbërës të saj një panel me prekje (3) i instaluar në një ekran me kristale të lëngshme të pranishëm (2). Një sipërfaqe e panelit me prekje (3) është më e madhe se ajo e ekranit me kristale të lëngshme (2). Një sipërfaqe kryesore me prekje (31) është përcaktuar si një pjesë përbërëse e përkime e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme (2), ndërsa një sipërfaqe e dytë me prekje (32) është përcaktuar si një pjesë jo- e mbivendosur e panelit me prekje (3) dhe ekranit me kristale të lëngshme (2). Veprimi i ndërrimit të faqes kryhet fillimisht duke tërhequr gishtin nga zona primare me prekje dhe veprimi 'prek dhe tërhiq' kryhet duke rrëshqitur gishtin nga zona primare tek zona sekondare me prekje. Prandaj, veprimi për ndërrimin e faqes është i lehtë për përdoruesin.




FIG.1A




FIG. 1B





FIG. 1C






FIG.3




FIG.4




FIG. 5




FIG. 6




FIG. 7

Shtojca IV

Autoritetet ku mund të depozitohen aplikimet për patentë Europiane

I. Zyra Europiane e Patentave

(a) Zyra qendrore në Mynih

Bob-van-Bentham-Platz 1
(formerly Erhardtstrasse 27)
80469 Munich
Germany
Tel.: +49 (0)89 2399-4500
Fax: +49 (0)89 2399-4465

Postal address:
European Patent Office
80298 Munich
Germany

(b) Hagë

European Patent Office
Branch at The Hague
Patentlaan 2
2288 EE Rijswijk
Netherlands
Tel.: +31 (0)70 340-4500
Fax: +31 (0)70 340-3016

Postal address:
European Patent Office
Postfach 5818
2280 HV Rijswijk
Netherlands

(C) Berlin

European Patent Office
Gitschiner Strasse 103
10969 Berlin
Germany
Tel.: +49 (0)30 25901-4500
Fax: +49 (0)30 25901-840

Postal address:
European Patent Office
10958 Berlin
Germany

II. Autoritet kombëtare

Për një përmbledhje të dispozitave kryesore kombëtare të shteteve kontraktuese që rregullojnë depozitimin e detyrueshëm dhe fakultativ të aplikimeve për patentë në zyrat qendrore të pronësisë industriale, shikoni Tabelen II të “Ligji i brendshëm lidhur me KEP” (shiko pikën 4). Kjo tabelë përmban edhe adresat e zyrave qendrore të pronësisë industriale.

Shënim: Aplikimet e ndara Europiane duhet të paraqiten te ZEP (shiko pikën 208).

Shtojca V

Kërkesat e shteteve kontraktuese në lidhje me përkthimet e specifikimeve të patentës Europiane

I. Neni 65 i KEP

Sipas nenit 65(1) të ZEP, çdo shtet kontraktues mund të përshkruajë se nëse teksti - për të cilin Zyra Europiane e Patentave synon dhënien, kufizimin ose mbajtjen e patentës Europiane të ndryshuar për një shtet - nuk është hartuar në një nga gjuhët e saj zyrtare, aplikanti ose zotëruesi i patentës duhet të dorëzojë një përkthim të tekstit te zyra qendrore e pronësise industriale në një nga gjuhët zyrtare të shtetit që zgjidhet prej tij, ose në gjuhën zyrtare të shtetit kur ky i fundit ka vetëm një gjuhë zyrtare.

II. Kërkesat e shteteve kontraktuese

Pozicioni juridik në shtetet kontraktuese jepet në "Ligji kombëtar lidhur me KEP", Tabela IV (shiko pikën 4).

Shënim: Të gjitha ato shtete te cilat kërkojnë një përkthim të specifikimit të patentës Europiane kanë përcaktuar se, në rast mosrespektimi të dispozitave kombëtare përkatëse, patentat Europiane do të konsiderohet nul që në fillim.

Shtojca VI

Afatet kohore

Tabelat që tregojnë afatet kohore që duhet të ndiqen nga aplikantët

KEP parashikon 3 tipe të afateve kohore:

1. Afate kohore të llogaritura nga data aktuale ose e menduar e depozitimit ose data e prioritetit.
2. Afate kohore të kohëzgjatjes të përcaktuar në KEP që llogariten që nga një ngjarje e ndryshme nga data e depozitimit ose kërkesës për prioritet
3. Afate kohore që KEP i përcakton përgjatë procedurës së dhënies

KEP kujton aplikantët për të gjitha afatet kohore të tipeve të lartpërmendura 2 dhe 3, përveç atyre për përpunim të mëtejshëm (shiko pikën 225) dhe ri-vendosjen e të drejtave (shiko pikat 226-227).

Tabelat e mëposhtme janë konceptuar veçanërisht për të ndihmuar aplikantët të ndjekin afatet kohore të tipit 1.


Grafiku 1 lidhet me një aplikim për patentë Europiane që është aplikim i parë.

Grafiku 2 lidhet me një aplikim për patentë e cila pretendon prioritetin e një aplikimi të mëparshëm dhe supozohet që është depozituar 10 muaj pas aplikimit të mëparshëm.

Tabelat nuk paraqesin afate kohore të veçanta që zbatohen për kërkesa të ndara dhe aplikime të reja për patente Europiane të depozituara sipas nenit 61(1) (b) (shiko Rregullat 16(2), 51 (6) dhe 60(2)).


Grafiku A

Limitet kohore të rëndësishme të përcaktuara nga KEP
kur nuk është pretenduar për **asnjë prioritet** në aplikimin për patentë Europiane*



Grafiku B

Limitet kohore të rëndësishme të përcaktuara nga KEP
kur është pretenduar për **prioritet në aplikimin** për patentë Europiane*



0 Depozitimi i aplikimit për Patentë Europiane

0 Depozitimi i një dosjeje të mëparshme

* Por shiko Rr. 131 dhe 57(1)

** Limiti kohor i logarit nga data e depozitimit, mundësisht jo më vonë se data në të cilën aplikimi ka ardhur (shiko Neni 80. Rr. 55 dhe 56)

*** Nëse pretendimet janë depozituar bashke me pretendimet

Shtojca VII

Tarifat

I. Tarifat e përcaktuara nga KEP

Udhëzuesi për pagesën e tarifave publikohet periodikisht në Gazetën Zyrtare për t'ju informuar në çdo kohë se cilat janë rregullat e aplikushme për tarifrat dhe nëse ka ndryshuar ndonjë informacion i këtij Udhëzimi që nga data e publikimit të tij. Ju këshillojmë të kontrolloni shumat aktuale të tarifave që gjenden në tabelën e tarifave, kostove dhe çmimeve të cilën mund ta gjeni në (www.epo.org) ose në zyrat e informacionit të ZEP.

II. Formulari për pagimin e tarifave dhe kostove

Formulari për pagimin e tarifave dhe kostove (Formulari 1010) mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e ZEP.

III. Informacion i mëtejshëm për tarifrat

Në faqen e internetit të ZEP gjeni të publikuar informacion të mëtejshëm për tarifrat, si tabela e tarifave, kostove dhe çmimeve të ZEP si dhe për listën e llogarive bankare të Organizatës Europiane të Patentave.

IV. Marrëveshjet për llogaritë e depozitave

Marrëveshjet për llogaritë e depozitimit dhe shtojcat janë publikuar si botim plotësues të Fletores Zyrtare ZEP-së. Ato përmbajnë informacion të detajuar në lidhje me të gjitha pyetjet dhe ndër të tjera me hapjen, debitimin dhe rimbushjen e llogarive të depozitimit, si dhe debitimin automatik të taksave dhe Pagesa Online e Tarifave nëpërmjet shërbimeve online.

*Publikim
Suplementar 3,
GZ 2015*

Shtojca VIII

Shërbimet e informacionit për patentën

Informimi rreth dosjeve të publikuara

1. Dosjet e aplikimeve për patentë Europiane dhe dosjet e patentave, që janë të botuara, janë të disponueshme në internet. Dosjet mund t'i studiONI në internet në adresën e faqes zyrtare të ZEP (www.epo.org) në rubrikën "European Patent Registers".

*Neni 128(4)
Rr. 145
Udhëz. A-XI
GZ 2009,598*

Kopje të dosjeve mund të vihen në dispozicionin tuaj kundrejt një pagese

Regjistri dhe buletini i patentave Europiane

2. ZEP ofron akses në Rregjistrin e Patentave Europiane në internet. Përdoruesit e sistemit të patentës Europiane mund të klikojnë www.epo.org për të parë të dhënat procedurale për aplikimet për patentat dhe aplikimet për patenta Europiane.

*Neni 127
Rr. 143
GZ 2001, 249
GZ 2003, 23, 69
GZ 2009,598*

Regjistri online siguron të dhëna bibliografike së bashku me të dhënat procedurale nga data e publikimit deri në dhënien e patentës, plus

të dhëna për procedimet e kundërshtimit dhe ankimit.

Akcesi në Rregjistrin online është falas

3. Të dhënat në Rregjistrin Europian të Patentave publikohen çdo javë në Buletinin e Patentave Europiane, ku të dhënat bibliografike të lidhura me aplikimet e botuara të patentës Europiane dhe patentave të dhëna sistemohen sipas disa kriterëve referuese që përfshijnë:

Neni 129(a)

- a. Klasifikimin ndërkombëtar të patentës,
- b. Numrat e publikimit Europian,
- c. Emrat e aplikantëve/zotëruesëve.

Buletini i patentave Europiane afishohet në internet në www.epo.org.

Dokumentet e patentës

4. ZEP publikon gjithashtu:
 - aplikimet për patentë Europiane (dokumentet A) në internet dhe në DVD-ROM
 - specifikimet e patentës Europiane (dokumentet B) në internet dhe në DVD-ROM.

*Neni 93
Neni 98, 103
GZ 2007,
Botimi special
Nr. 3
D.2, D.3, D.4*

Dokumentet e publikuara janë disponibël përmes serverit në <https://data.epo.org/publication-server/?hp=stages>

Informacioni mbi produktet e tjera CD-ROM të ZEP mund të shkarkohen nga faqja e internetit <http://www.epo.org/searching/subscription.html>

Gazeta Zyrtare dhe Udhëzimet për ekzaminimin

5. Publikimet e tjera standarte të ZEP përfshijnë

Neni 129(b)

Neni 10(2)(a)

- Gazetën Zyrtare (GZ), e cila përfshin në veçanti aktet e Këshillit Administrativ të Organizatës, vendimet dhe njoftimet e Kryetarit të ZEP, informacion rreth tarifave dhe kostove, dhe vendime të përzgjedhura të bordeve të ankimit, dhe
- - Udhëzimet për Ekzaminim në Zyrën Europiane të Patentave.

Këto publikime janë gjithashtu disponibël online në faqen e internetit të (www.epo.org/law-practice/legal-texts.html).

Termat dhe kushtet

6. Zyra tjetër e ZEP në Vjenë është përgjegjëse për të gjitha shërbimet e informimit për patentat (dërgimi i dokumenteve, akses online, etj.).

Vienna sub-office Postfach 90 1031 Vienna Austria
Tel.: +43 (0)1 521 26 4500
Fax: +43 (0)1 521 26 3591

Pyetje?

Informacione të mëtejshme në lidhje me Zyrën Europiane të Patentave dhe Procedurat e përfshira në aplikimin për patentë Europiane gjenden në faqen e internetit EPO në www.epo.org:

- Aplikimi për një patentë në www.epo.org/guide
- Kërkimi për Patentën në www.epo.org/espacenet
- Regjistri European i Patentave në www.epo.org/register
- Shërbime Online për dprëzimin në www.epo.org/online-services
- vende të lira pune në www.epo.org/about-us/jobs.html
- Akses të shpejtë në FAQs, publikime, formularë dhe mjetet të tjera në www.epo.org/service-support
- Të mësuarit dhe ngjarjet në www.epo.org/learning-events~~pobj

Na kontaktoni

Vizitoni www.epo.org/contact për të pasur akses në:

- formularin tonë të kontaktit
- Udhëzime për si të arrish në ZEP
- adresat tona postare
- Numrat tonë të Centralit
- Numrat tonë të Shërbimit me Klientët

Na ndiqni në

- www.facebook.com/europeanpatentoffice
- twitter.com/EPOorg
- www.youtube.com/EPOfilms
- www.linkedin.com/company/european-patent-office

Publikuar nga

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri

E-mail: mailinf@alpto.gov.al; Tel: +355(0)42236288

©DPPM 2016

Përgjegjës për përmbajtjen

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Dizajn

AAG Publicity

Përkthyer nga:

AAG Publicity

Përkthim i edituar nga:

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Printim

AAG Publicity

Botimet mund të shkarkohen pa pagesë nga faqja e internetit e EPO-s në adresën: www.epo.org

"E Drejta e Autorit dhe Lirimi nga Përgjegjësia: Ky material është krijuar, përkthyer apo adaptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (**DPPM**) me mbështetjen e Zyrës Europiane të Patentave (**EPO**).

EPO nuk garanton që materiali nuk përmban gabime apo mungesa në të dhe zhvishet nga çdo përgjegjësi që lidhet me besueshmërinë e saj apo me pazotësinë e saj në përdorime dhe dëmtime të tjera të mundshme të kësaj natyre, humbje të informacionit, fitime apo të ardhura.

Versioni origjinal është i disponueshëm në:

<http://www.epo.org/applying/european/Guide-for-applicants/html/e/index.html>



www.epo.org
info@epo.org



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark",
Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +335(0)42236288
Email: info@dppm.gov.al